



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

10/2019

Krimet e Rënda në Kosovë, ligji VS praktika

(Analizë e politikës së ndjekjes dhe dënimeve në rastet e trajtuara në Departamentet e Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës, analizë e veçantë e trajtimit të rasteve të veprave penale të terrorizmit)



Prishtinë, shtator 2019

Autorët: Sabina Pergega dhe Valentina Shahini Grajçevci

Ekipi i Redaktorëve: Ehat Miftaraj, Betim Musliu, Yll Zekaj dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Shtator 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Metodologjia	6
3. Mandati ligjor i prokurorive dhe gjykatave në Departamentin e Krimeve të Rënda (DKR)	7
4. Ngarkesa e Gjykatave dhe Prokurorive me lëndë në DKR.....	9
5. Ngarkesa totale me lëndë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës	9
5.1. Ngarkesa më lëndë në DKR të GTh gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019..	10
5.2. Ngarkesa më lëndë në DKR të GTh sipas kategorive të veprave penale	13
6. Ngarkesa totale me lëndë e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës	20
6.1. Ngarkesa me lëndë në DKR të PTH gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019 .	20
6.2. Ngarkesa më lëndë në DKR të PTh sipas kategorive të veprave penale.....	25
7. Performanca e individuale e Gjykatësve dhe Prokurorëve në DKR	27
7.1. Performanca e gjykatësve në DKR	27
7.2. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në DKR të Gjykatave Themelore gjatë vitit 2018	30
8. Performanca e prokurorëve në DKR.....	31
8.1. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga DKR-të e Prokurorive Themelore.....	33
9. Gjetjet e IKD-së në trajtimin e rasteve në Krime të Rënda.....	36
10. Trajtimi i rasteve të terrorizmit nga Republika e Kosovës.....	38
11. Gjetjet kryesore të IKD-së në trajtimin e rasteve të terrorizmit.....	43
12. Anex 1: Analizë e detajuar e rasteve të terrorizmit të aktgjykimve të formës së prerë.....	51
13. Anex II: Trajtimi i detajuar i rasteve të terrorizmit të kthyer në rigjykim	77
14. Anex III: Trajtimi i detajuar i rasteve të terrorizmit të përfunduara në shkallë të parë, të cilat gjenden për herë të parë në proces gjyqësor	88
15. Rekomandime	92

1. Përmbledhje ekzekutive

Kosova ende përballlet me probleme serioze në sundimin e ligjit, ku korrupsioni, pastrimi i parave dhe terrorizmi po ndikojnë në mos-funksionimin dhe zhvillimin e vendit. Mungesa e rezultateve në luftën kundër krimeve serioze është bërë pengesë e pa kapërcyeshme në procesin e integritetit evropian. Edhe pse korniza ligjore dhe politikat për luftimin e korrupsionit në vend, vlerësohen ndër më të avancuarat në letër, mungon zbatimi i tyre në praktikë.

Kosova nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 ka ndërmarr reforma si në aspektin institucional ashtu edhe atë ligjor, mirëpo sundimi i ligjit mbetet një ndër sfidat më të mëdha që po përballlet vendi, pasi gjyqësori edhe më tej mbetet i ekspozuar ndaj ndikimit politik. Sipas raporteve të caktuara ndërkombëtare, Kosova tani cilësohet si shtet i kapur, derisa sistemi i drejtësisë cilësohet si *“lehtë i ndikueshëm nga politika”*.

Të dhënat tregojnë se vit pas viti, Departamentet e Krimeve të Rënda (DKR) kanë ulur efikasitetin e tyre në zgjidhjen e lëndëve në punë. Në këtë raport, IKD gjenë se ndonëse që nga viti 2016 e deri në vitin 2018, numri i Gjyqtarëve në DKR është rritur për 19%, efekti i kësaj ka qenë 334 lëndë më pak të zgjidhura.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se ky është një shembull tipik se mungesa e resurseve humane nuk është problemi kryesor i sistemit gjyqësor në kuptim të numrit të madh të lëndëve. Kjo për arsye se përkundër faktit se kemi një ngritje të numrit të gjyqtarëve për 19% (8 gjyqtarë), kjo rritje nuk ka reflektuar fare në ngritjen e efikasitetit. Përkundrazi, numri i rasteve të zgjidhura tanimë është më i vogël.

Sa i përket Prokurorit të Shtetit, nga të dhënat e siguruara nga raportet zyrtarë të këtij institucioni, është e pamundur që të shihet trendi i efikasitetit të Prokurorit të Shtetit ndër vite. Kjo për arsye se mungesa e qartësisë dhe përputhshmërisë së statistikave të këtij institucioni, nuk japin një pasqyrë reale dhe të kuptueshme të punës së sistemit prokurorial vit pas viti. Fakti që ky sistem nuk i kushton rëndësi kësaj fushe, tregon edhe një fakt të ri në kuptim të mungesës së transparencës së institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Në anën tjetër, KGJK gjatë vitit 2018 ka bërë një hap para në kuptim të transparencës së sistemit gjyqësor, në atë mënyrë që ka publikuar raportin statistikor për punën e gjyqtarëve për vitin 2018, ku sipas këtyre statistikave, ka diferencë të madhe të numrit të lëndëve të kryera mes gjyqtarëve në Departamentin e Krimeve të Rënda. Në këtë drejtim, në mesin e gjyqtarëve të DKR-ve ka gjyqtarë që gjatë vitit 2018 ka kryer 82 lëndë, derisa ka edhe të tjerë që gjatë tërë vitit 2018 kanë përfunduar vetëm 18 lëndë.

Sipas raportit vjetor të Prokurorit të Shtetit, prokurorët e DKR-ve të Prokurorive Themelore gjatë vitit 2018 kanë zgjidhur mesatarisht nga 59.13 lëndë, përkatësisht 6.87 nën normën vjetore. Sipas këtij raporti, Departamenti për Krime të Rënda më efikas ka qenë ai i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ku prokurorët kanë zgjidhur mesatarisht nga 133.6 kallëzime penale, apo 67.6 kallëzime penale mbi normën vjetore. Mbi normën vjetore lëndë

kanë zgjidhur edhe DKR e PTh në Ferizaj (96.6 kallëzime penale) dhe në Gjilan (79.75 kallëzime penale)¹.

Ndërsa, prokuroritë më jo efikase, të cilat kanë punuar nën normën vjetore janë DKR i PTh-së në Prizren ku secili prokuror ka zgjidhur mesatarisht 61.75 lëndë në vit, DKR i PTh-së në Gjakovë me mesatarisht 61 kallëzime penale në vit për prokurorë dhe DKR i PTh-së në Prishtinë me mesatarisht 40.93 kallëzime penale në vit për prokurorë. Sipas këtij raporti, kampion në mos efikasitet është DKR i PTh-së në Pejë, ku gjatë vitit 2018, prokurorët kanë kryer mesatarisht 32.6 kallëzime penale. Në norma mujore, kjo nënkupton se prokurorët e DKR në PTh të Pejës kanë kryer më pak se nga 3 lëndë në muaj. Ndonëse nga DKR-të e 7 Prokurorive Themelore, vetëm 3 prej tyre e kanë arritur normën vjetore për prokurorë, Prokurori i Shtetit në raportin e vet vjetor për vitin 2018 e paraqet këtë fakt vetëm në mënyrë përshkruese, duke mos dhënë asnjë detaj nëse vetë Prokurori i Shtetit apo KPK ka marrë ndonjë masë lidhur me këtë mos efikasitet të prokurorëve. Në anën tjetër, përpos këtij fakti, Prokurori i Shtetit dhe as KPK nuk kanë dhënë asnjë përgjigje lidhur me atë se pse ka ardhur deri tek ky fakt, ku 4 prej 7 DKR-ve të PTh-ve nuk kanë arritur normën vjetore.

Në këtë raport, subjekt i hulumtimit dhe analizës janë rastet e Krimeve të Rënda të monitoruara gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të vitit 2019 nga hulumtuesit e IKD-së, të cilët gjatë kësaj periudhe kanë monitoruar **3,385** seanca gjyqësore, ku përfshihen **1,116** raste me **2,631** persona të akuzuar.

Po ashtu, IKD gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmuajorit të parë 2019, ka monitoruar 18 raste të terrorizmit, prej të cilave 47 persona janë të akuzuar, ndërsa ndaj 3 personave që kanë qenë pjesë e këtyre aktakuzave, është veçuar procedura. Në këtë raport, ipet një analizë e detajuar e këtyre rasteve.

Sa i përket afateve ligjore, IKD ka gjetur se edhe në rastet e terrorizmit, këto afate në shumicën e rasteve nuk janë respektuar. Mesatarja e kohëzgjatjes nga ngritja e aktakuzës e deri në caktimin e shqyrtimit fillestar në rastet e monitoruara nga IKD është 133 ditë derisa Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurës penale nga ngritja e aktakuzës e deri në aktgjykimin e formës së prerë në rastet e monitoruara nga IKD është 678 Ditë.

Po ashtu, nga të gjeturat e IKD-së rezulton se gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, në sistemin gjyqësor janë parashkruar gjithsej 67 lëndë, 12 prej të cilave korrupsion.

¹ “Raporti i punës 2018 – Prokurori i Shtetit”. Prokurori i Shtetit. Shkurt 2019. f.62. (Shih linkun <http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202018%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit.pdf>). (Qasur së fundi më 16 gusht 2019).

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve në Departamentin e Krimeve të Rënda nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare (legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme zyrtare të KGJK-së, raporte të ndryshme zyrtare të KPK-së si dhe të dhëna të tjera të siguruara nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike). Sa i përket të dhënave statistikore të sistemit prokurorial, të njëjtat janë të paqarta dhe nuk përputhen me periudha të ndryshme raportuese, çfarë ndikon në paqartësinë e trandit të efikasitetit në sistemin prokurorial.

Përpos këtyre dokumenteve, draftimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve në Departamentin e Krimeve të Rënda. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD tanimë ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor.

Ky raport përfshin monitorimin e rasteve të Departamentin të Krimeve të Rënda në shtatë Prokuroritë Themelore dhe shtatë Gjykatat Themelore, për periudhën kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë rasteve të terrorizmit të cilat janë monitoruar nga IKD.

Sa i përket DKR-ve të Gjykatave dhe Prokurorive Themelore të Republikës së Kosovës, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë të këtyre departamenteve, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancës individuale të Prokurorëve dhe Gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport jep edhe vlerësimet dhe rekomandimet.

Sa i përket rasteve të terrorizmit, IKD këtyre rasteve u bënë një trajtim më të detajuar, nga të gjeturat e IKD-së në procesin e monitorimit. IKD ka analizuar trajtimin e këtyre rasteve nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshi fazën prej ngritjes së kallëzimit penal e deri në shpallje të aktgjykimit nga gjykatat e shkallës së parë, duke analizuar bazën ligjore. Në këtë raport, fillimisht trajtohen të gjeturat kryesore për këto raste, derisa në anëxin 1 të këtij raporti, trajtohen të gjeturat për secilin rast veç e veç.

3. Mandati ligjor i prokurorive dhe gjykatave në Departamentin e Krimeve të Rënda (DKR)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës afirmon standardet më të larta ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Në këtë kuptim, përpos të drejtave kushtetuese të përcaktuara në kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ky akt në nenin 22 ka përcaktuar edhe tetë (8) konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat zbatohen drejt për së drejti në sistemin juridik të Republikës së Kosovës si dhe në rast konflikti, kanë epërsi ndaj akteve të tjera të brendshme².

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndërtohet mbi parimin e ndarjes së pushteteve. Në lidhje me pushtetin gjyqësor, Kushtetuta përcakton se “Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat”³ dhe se “Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”.⁴

Në lidhje me Gjykatat, Kushtetuta e Republikës së Kosovës organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e lë në rregullim të ligjit. Në këtë kuptim, Kushtetuta përcakton se “Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj”⁵.

Në kuptim të zbatimit të këtij obligimi kushtetues, Kosova ka miratuar Ligjin për Gjykatat. Më 1 janar 2013 kishte hyrë në fuqi Ligji i ri për Gjykatat, i cili kishte ndryshuar edhe strukturën e sistemit gjyqësor që ishte në të kaluarën. Ky ligj ka pësuar ndryshe jothelbësore me miratimin e Ligjit të ri për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019.

Sipas Ligjit për Gjykatat, sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Secila prej shtatë (7) Gjykatave Themelore kanë edhe degët e tyre. Po ashtu, ky ligj përcakton edhe strukturën e brendshme për secilën gjykatë. Sipas këtij ligji, secila Gjykatë Themelore, përfshi edhe degën e saj, ka Departamentin e Përgjithshëm, derisa në secilën seli të Gjykatës Themelore veprojnë Departamenti i Krimeve të Rënda, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti i Përgjithshëm. Për dallim nga gjashtë (6) Gjykatat e tjera Themelore, në Gjykatën Themelore

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 22. “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Më të Rënda, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”.

³ Po aty. Neni 102.1.

⁴ Po aty. Neni 102.2.

⁵ Po aty. Neni 103.1.

të Prishtinës funksion edhe Departamenti Special për Lëndët e PSRK-së, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike.

Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale të dënueshme mbi dhjetë (10) vite, si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha çështjet në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.

Deri më 28 qershor 2019, Departamenti për Krimet e Rënda në Gjykatat Themelore ka gjykuar lëndët më të rënda. Ky departament i ka gjykuar lëndët e Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorive Themelore si dhe lëndët që hynë në kompetencë të PSRK-së.

Me ligjin e ri për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019, është paraparë edhe krijimi i Departamentit Special për Lëndët në Kompetencë të PSRK-së, i cili funksionon në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e lëndëve tanimë është larguar nga Departamenti i Krimeve të Rënda, dhe ka kaluar në departamentin e ri.

Nga 28 qershori 2019 është funksionalizuar Departamenti Special në Gjykatën e Apelit dhe atë Themelore të Prishtinës. Ky departament merret me trajtimin e lëndëve që ngritën nga Prokuroria Speciale. Drejtues të institucioneve të drejtësisë kishin deklaruar se krijimi i këtyre departamenteve do të jep rezultate pozitive në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilit të lartë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në takimin e mbajtur më 23 prill 2019, kishte miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionalizimin e Departamentit Special si dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe stafit.

Aktualisht, Departamenti për Krime të Rënda, i cili vepron në kuadër të Gjykatave Themelore në vend ka gjithsej 51 gjyqtarë.

Në anën tjetër, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.⁶ Sikurse në rastin e sistemit gjyqësor, edhe për Prokurorin e Shtetit, Kushtetuta ka përcaktuar se organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit përcaktohen me ligj.

Për të zbatuar këtë obligim kushtetues, Republika e Kosovës ka miratuar Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Sipas këtij ligji, sikurse në rastin e Gjykatave, në sistemin prokurorial funksionojnë shtatë (7) Prokurori Themelore, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKSH). Përpos këtyre prokurorive, me Ligjin për Prokurorinë Special të

⁶ Po aty. Neni 109.1.

Republikës së Kosovës është themeluar edhe PSRK si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit.⁷

Po ashtu, Kushtetuta ka përcaktuar edhe institucionet që për detyrë kanë administrimin e drejtësisë. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka themeluar si institucione Kushtetuese KGJK-në dhe KPK-në. Për të dy këto institucione, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligje të veçanta.

4. Ngarkesa e Gjykatave dhe Prokurorive me lëndë në DKR

IKD me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të punës ndër vite të gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Kosovës, me fokus në Departamentet për Krime të Rënda, ka analizuar ngarkesën me lëndë që nga viti 2016 deri më 30 qershor 2019. Në vazhdim do të gjeni analizën e detajuar për gjykatat dhe prokuroritë.

5. Ngarkesa totale me lëndë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës

Me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të punës ndër vite të gjykatave të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë Departamentit për Krime të Rënda, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë që nga viti 2016 deri më 30 qershor 2019.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK publikon çdo vit kalendarik, Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë gjithsej 831,376 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 465,800 apo 56% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 365,505 lëndë apo 44% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, Gjykatat Themelore kanë pasur gjithsej në punë 569,373 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 295,358 apo 52 % të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 273,888 apo 48% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, Gjykatat Themelore kanë pasur në punë 375,136 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 163,978 ose 44% ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 211,049 ose 56%.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Gjykatat Themelore kanë pasur në punë 255118 lëndë, prej të cilave gjatë kësaj periudhe i kanë zgjidhur 66753 apo 26%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 188260 apo 74% e lëndëve.

Sipas këtyre statistikave, vërehet se Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës në vitin 2016 kanë zgjidhur 56% të lëndëve, në vitin 2017, 52% ndërsa në vitin 2018, 44% të lëndëve, që sipas këtyre përqindjeve vërehet se gjykatat themelore çdo vit ulin numrin e lëndëve të zgjidhura.

⁷ Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Neni 1.1.

5.1. Ngarkesa më lëndë në DKR të GTh gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019


Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatave Themelore në Republikës e Kosovës, gjatë vitit 2016, ka trashëguar 5598 lëndë nga viti paraprak, i ka pranuar 2144 lëndë, derisa ka pasur në punë gjithsej 7737 lëndë, prej të cilave i ka zgjidhur 2841, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 4840, ndërsa në kompetencë ka dërguar 56 lëndë.⁸ Pra, gjatë vitit 2016, DKR-të e Gjykatave Themelore kanë zgjidhur 37% të lëndëve në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 63% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, DKR e të gjitha Gjykatave Themelore nga viti paraprak kanë trashëguar 4726 lëndë, kanë pranuar 1405, gjithsej në punë kanë pasur 6131, prej të cilave i kanë zgjidhur 1930, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 4091 lëndë, ndërsa kanë dërguar në kompetencë 110 lëndë. Në përqindje del se nga numri i lëndëve që kanë pasur në punë, DKR-të gjatë vitit 2017 kanë zgjidhur 31 % të lëndëve, derisa kanë mbetur të pazgjidhura 69 % të lëndëve në punë.

Gjatë vitit 2018, DKR-të kanë pasur në punë 5431, i kanë zgjidhur 1810 lëndë, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 3532 lëndë, kanë trashëguar 4091 lëndë, kanë pranuar 1340 lëndë, ndërsa kanë dërguar në kompetencë 89 lëndë. Në përqindje del se nga numri i lëndëve që kanë pasur në punë, DKR-të gjatë vitit 2018 kanë zgjidhur 33 % të lëndëve, derisa kanë mbetur të pazgjidhura 67 % të lëndëve në punë.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Departamentet e Krimeve të Rënda kanë pasur në punë 4102 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 893 apo 22%, kanë mbetur të pazgjidhura 3114 apo 78% të lëndëve, kanë trashëguar 3532 lëndë, kanë pranuar në punë 570, ndërsa kanë dërguar në kompetencë 95 lëndë.

⁸ Shënim: Këto të dhëna janë marrë nga raportet statistikore zyrtare të KGJK-së.



Grafika 1 – Lëndët e zgjidhura dhe të pazgjidhura në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë viteve 2016, 2017, 2018.

Sipas kësaj, Departamentet e Krimeve të Rënda gjatë vitit 2016, kanë pasur përqindjen më të lartë të zgjidhjes së lëndëve, në vitin 2017 është zvogëluar numri i lëndëve të zgjidhura më 31%, ndërsa në vitin 2018, është rritur numri i lëndëve të zgjidhura për vetëm 2%, përkatësisht në 33%.

Pra, të dhënat tregojnë se vit pas viti, DKR-të kanë ulur efikasitetin e tyre në zgjidhjen e lëndëve në punë. Ndonëse që nga viti 2016 numri i lëndëve të pranuar në DKR-të e Gjykatave Themelore ka rënë, përqindja e lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit është rritur. Për më tepër, ulja e numrit të lëndëve të zgjidhura ka shkuar paralelisht me ngritjen e numrit të gjyqtarëve. Pra, përderisa ideja e ngritjes së numrit të gjyqtarëve është rritja e efikasitetit në kuptim të numrit të lëndëve të zgjidhura, kjo nuk ka ndodhur në DKR-të e Gjykatave të Republikës së Kosovës. Në vitin 2016, numri i gjyqtarëve ka qenë 42, derisa numri i lëndëve të zgjidhura ka qenë 2841. Në vitin 2017, numri i Gjyqtarëve në DKR është ngritur për 2 gjyqtarë, derisa janë zgjidhur 214 lëndë më pak. Në vitin 2018, numri i gjyqtarëve në DKR-të e Gjykatave është ngritur edhe për 6 gjyqtarë, derisa numri i lëndëve të zgjidhura ka rënë edhe për 120 lëndë të tjera. Pra, përforcimi i këtij departamenti me 8 gjyqtarë të rinjë, ka ndikuar që të kemi 334 lëndë më pak të zgjidhura për 2 vite (2017 dhe 2018).

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se ky është një shembull tipik si mungesa e resurseve humane nuk është problemi kryesor i sistemit gjyqësor në kuptim të numrit të madh të lëndëve. Kjo për arsye se përkundër faktit se kemi një ngritje të numrit të gjyqtarëve për 19% (8 gjyqtarë), kjo rritje nuk ka reflektuar fare në ngritjen e efikasitetit. Përkundrazi, numri i rasteve të zgjidhura tanimë është më i vogël.

Përpos numrit të lëndëve të DKR-ve në të gjitha Gjykatat Themelore, IKD në tabelën më poshtë ka analizuar edhe ngarkesën e secilit DKR në 7 Gjykatat Themelore.

	2018	Në punë	Të zgjidhura	Përqindja %	Të pazgjidhura	Përqindja %	Gjashtëmujori 2019	Në punë	Të zgjidhura	Përqindja %	Të pazgjidhura %	Përqindja %
Prishtinë		2163	629	29%	1534	71%		1611	304	19%	1216	81%
Mitrovicë		1568	298	19%	1270	81%		1353	188	14%	1165	86%
Gjilan		566	314	55%	252	45%		354	133	38%	221	62%
Ferizaj		476	205	43%	271	57%		361	112	31%	246	69%
Pejë		256	139	54%	117	46%		161	57	35%	104	65%
Prizren		241	134	56%	107	44%		153	68	44%	85	56%
Gjakovë		161	91	57%	70	43%		109	31	28%	77	72%

Tabela 1 – Numri i rasteve në Departamentet e Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit 2019.

Duke u bazuar në raportin vjetor 2018, Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka numrin më të madh të lëndëve me 2163, Mitrovica me 1568, Gjilani 566, Ferizaj 476, Peja 256, Prizreni 241 dhe Gjakova me 161 lëndë, ndërsa në gjashtëmujorin 2019, Prishtina është e ngarkuar me më së shumti lëndë me gjithsej 1611, Mitrovica 1353, Ferizaj me 361, Gjilani 354, Peja 161, Prizreni me 153 dhe Gjakova me 109 lëndë në punë.

Siç shihet edhe në tabelë, nëse llogaritet ngarkesa e lëndëve më numër të lëndëve të kryera, del se Gjykata Themelore në Gjakovë, e cila ka numrin më të vogël të lëndëve, ka edhe përqindjen më të lartë të lëndëve të zgjidhura me 57%. Pas saj radhitet Gjykata Themelore në

Prizren me 56%, Gjlani me 55%, Peja me 54%, Ferizaj me 43% , Prishtina me 29%, ndërsa Mitrovica me 19% ka përqindjen më të ulët të lëndëve të zgjidhura në krahasim me totalin e lëndëve të ngarkuara.

5.2. Ngarkesa më lëndë në DKR të GTh sipas kategorive të veprave penale

DKR-të e 7 Gjykata Themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019 më së shumti kanë qenë të ngarkuara me lëndë nga kategoria e “Veprave penale kundër jetës dhe trupit”⁹, pasuar “Veprat penale të armëve” dhe “Veprat penale të narkotikëve”.

Nga të gjitha veprat penale sipas kategorive, gjatë vitit 2018 më së shumti lëndë janë zgjidhur sa i përket veprave penale nga kapitulli i armëve (444 lëndë të zgjidhura), pasura me veprat penale nga kapitulli i narkotikëve (293 lëndë të zgjidhura) dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit (226 lëndë të zgjidhura).

⁹ *Sqarim*: Në kategorinë e veprave penale kundër jetës së trupit hyjnë llojet e vrasjeve, shtytja dhe ndihma në vetëvrasje, ndërprerja e palejuar e shtatzënisë, kanosja, ngacmimi, sulmi, lëndimet e lehta dhe të rënda trupore, pjesëmarrja në rrahje, mosdhënia e ndihmës dhe braktisja e personave të paafët.

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lëndët në kompetencë brenda gjykatë
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	688	261	949	226	717	6
Veprat penale të armëve	511	255	766	444	271	51
Veprat penale të narkotikëve	450	277	727	293	429	5
Veprat penale kundër pasurisë	399	110	509	137	366	6
Veprat penale të korrupsionit	305	165	470	202	263	5
Veprat penale kundër ekonomisë	255	68	323	114	206	3
Veprat penale kundër integritetit seksual	196	73	269	72	196	1
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	204	22	226	105	121	0
Veprat penale kundër njerëzimit	187	29	216	46	168	2
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	144	8	152	16	136	0
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	79	10	89	12	77	0
Krim i organizuar	57	11	68	6	62	0
Veprat penale kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	21	15	36	11	25	0
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	28	8	36	13	17	6
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	22	8	30	12	0	18
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë	20	9	29	10	19	0
Veprat penale kundër rendit publik	24	2	26	7	19	0
Veprat penale kundër shëndetit publik	14	3	17	5	12	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	6	0	6	0	0	6
Veprat penale kundër mjedisit	6	0	6	0	6	0
Veprat penale kundër shërbimeve komunale	0	1	1	0	0	1
Totali	3616	1335	4951	1731	3110	110

Tabela 2 – Numri i lëndëve sipas kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për vitin 2018.¹⁰

¹⁰ Sqarim: Veprat penale nga kategoritë e evidentuara me një numër shumë të vogël të rasteve janë vepra penale të cilat parimisht gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, por që për shkaqe procedural, ka edhe raste përjashtuese kur një vepër e tillë gjykohet edhe në DKR.

Sa i përket dënimeve të shqiptuara në DKR-të e 7 Gjykatave Themelore, prinë dënimi me burgim efektiv, i shqiptuar në gjithsej 483 raste, pasuar me dënimin me kusht me gjithsej 407 raste dhe dënimin me gjobë në 327 raste.

Përpos aktgjykimeve dënuese, DKR-të e Gjykatave Themelore kanë shqiptuar edhe 152 aktgjykime liruese dhe 150 aktgjykime refuzuese.

Por, sa i përket vitit 2018, shqetësuese mbetet dukuria e parashkrimit, e cila vazhdon të jetë dukuri e pa adresuar nga ana e akterëve të sistemit gjyqësor.

Sipas statistikave zyrtare të KGJK-së, gjatë vitit 2018 janë parashkruar gjithsej 52 raste në DKR-të e 7 Gjykatave Themelore. Prej tyre 46 kanë arritur parashkrimin absolut, dhe 6 kanë arritur parashkrimin relativ.

Ky numër i lëndëve të parashkruara, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me vepra penale të gjykuara në Departamentet e Krimeve të Rënda, ku parimisht dënimet janë më të larta, rrjedhimisht edhe afatet e parashkrimit, duhet të shërbejë si alarm për sistemin gjyqësor.

Mbi këto të dhëna, KGJK duhet të adresojë këtë problem, duke mbajtur përgjegjës akterët relevant lidhur me këtë dukuri. Për më tepër, në të kaluara ka pasur akuza nga vetë KGJK se çështja e parashkrimit është një “patate e nxehtë” që sistemi prokurorial i’a “lë në dorë” sistemit gjyqësor¹¹.

Për këtë arsye, KGJK duhet të dalë me një raport detajues mbi të cilin duhet të zgjedhë një nga dy alternativat: pohimin se për këtë dukuri fajtor është sistemi prokurorial apo vënien në funksion të mekanizmave të brendshëm të kontrollit për ti thirrur në përgjithësi të gjithë akterët e përfshirë në këtë rast.

Ndonëse parashkrimi i veprave penale është mesazh i keq tek qytetarët në secilin rast, ky fakt rëndohet jashtëzakonisht shumë kur kemi prezentë dukurinë e parashkrimit në veprat penale, kompetente për gjykimin e të cilave është Departamenti për Krime të Rënda.

Për më tepër, ndonëse sistemi gjyqësor ka proklamuar vazhdimisht trajnimin me prioritet absolut të lëndëve të korrupsionit, vetëm gjatë vitit 2018, në DKR-të e Gjykatave Themelore janë parashkruar gjithsej 8 lëndë të korrupsionit, të gjitha me parashkrim absolut.

Sa i përket parashkrimit sipas kategorisë konkrete, prinë kategoria e veprave penale kundër ekonomisë me gjithsej 22 lëndë të parashkruara për një vit (20 me parashkrim absolut dhe 2 relativ). Në këtë rast, është plotësisht e pa arsyeshme parashkrimi i një veprave penale, dënueshmëria e së cilës është 1 deri në 10 vjet.

¹¹ "Kryesuesi i KGJK-së: Prokurorët po na e lënë në dorë “patatën e nxehtë”". Betimi për Drejtësi. 1 mars 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/kryesuesi-i-kgjk-se-prokuroret-po-na-e-lene-ne-dore-patatën-e-nxehte/>). (Qasur për herë të fundit më 17 shtator 2019).

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Dënim me burgim	Dënim me gjobë	Dënim me kusht	Dënime tjera	Aktgjyqi me Liruese	Aktgjyqi me Refuzuese	Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Parashkrim absolut	Parashkrim relativ
Veprat penale kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	6	2	0	0	3	0	0	0	0
Veprat penale të korrupsionit	22	37	37	0	61	21	16	8	0
Krim i organizuar	4	0	0	0	0	0	2	0	0
Veprat penale kundër njerëzimit	16	7	7	1	8	2	5	1	0
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	151	13	20	2	11	12	15	2	0
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	7	0	1	0	1	3	0	0	0
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	0	1	65	0	6	18	14	0	1
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	15	7	14	1	10	11	12	1	1
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	3	1	6	0	1	0	0	1	0
Veprat penale kundër shëndetit publik	2	0	1	0	0	0	2	0	0
Veprat penale të narkotikëve	147	49	51	0	10	20	8	8	0
Veprat penale kundër ekonomisë	15	12	21	0	6	29	9	20	2
Veprat penale kundër shërbimeve komunale	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër pasurisë	64	9	19	0	18	13	12	1	1
Veprat penale kundër mjedisit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	4	2	4	0	0	0	1	2	0
Veprat penale të armëve	21	186	156	3	17	19	41	1	0
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	1	0	1	0	0	1	13	0	0
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë	2	1	3	0	0	0	2	1	1
Veprat penale kundër rendit publik	3	0	1	1	0	1	1	0	0
Totali	483	327	407	8	152	150	153	46	6

Tabela 3 – Dënimet e shqiptuara sipas kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Sa i përket lëndëve në punë sipas kategorisë së veprave penale, edhe në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019 prinë kategoria e veprave kundër jetës dhe trupit (820 lëndë në punë), pasuar nga veprat penale të narkotikëve (560 lëndë në punë) dhe veprave penale kundër pasurisë (421 lëndë në punë).

Nga të gjitha veprat penale sipas kategorive, gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019 më së shumti lëndë janë zgjidhur sa i përket veprave penale nga kapitulli i armëve (166 lëndë të zgjidhura), pasura me veprat penale nga kapitulli i narkotikëve (155 lëndë të zgjidhura) dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit (139 lëndë të zgjidhura).

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lendet në kompetencë brenda gjykatë
Veprat penale kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	23	0	23	7	16	0
Veprat penale të korrupsionit	263	81	344	79	265	0
Krim i organizuar	57	2	59	4	54	1
Veprat penale kundër njerëzimit	167	26	193	29	164	0
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	717	103	820	139	673	8
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	78	4	82	4	77	1
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	121	9	130	25	105	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	6	0	6	3	3	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	195	26	221	47	171	3
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	18	7	25	3	22	0
Veprat penale kundër shëndetit publik	13	1	14	0	13	1
Veprat penale të narkotikëve	435	125	560	155	402	3
Veprat penale kundër ekonomisë	206	28	234	63	169	2
Veprat penale kundër shërbimeve komunale	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër pasurisë	365	56	421	89	317	15
Veprat penale kundër mjedisit	6	1	7	0	7	0
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	17	6	23	6	16	1
Veprat penale të armëve	272	87	359	166	142	51
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	136	2	138	8	130	0
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë	19	2	21	3	18	0
Veprat penale kundër rendit publik	19	0	19	3	14	2
Totali	3133	566	3699	833	2778	88

Tabela 4 – Numri i lëndëve sipas kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e parë 2019.

Sa i përket dënimeve të shqiptuara në DKR-të e 7 Gjykatave Themelore, prinë dënimi me burgim efektiv, i shqiptuar në gjithsej 284 raste, pasuar me dënimin me gjobë në 152 raste dhe dënimin me kusht në 133 raste.

Përpos aktgjykimeve dënuese, DKR-të e Gjykatave Themelore kanë shqiptuar edhe 71 aktgjykime liruese dhe 105 aktgjykime refuzuese.

Dukuria e parashkrimit është e shprehur edhe në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, ku sipas statistikave zyrtare të KGJK-së, janë parashkruar gjithsej 15 raste, 8 prej tyre me parashkrim absolut dhe 7 me parashkrim relativ.

Sikurse në vitin 2018, edhe në këtë periudhë shqetësuese është parashkrimi i lëndëve të korrupsionit, ku për gjashtë (6) muaj janë evidentuar gjithsej 4 lëndë të parashkruara.

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Dënim me burgim	Dënim me gjobë	Dënim me kusht	Dëni me tjera	Aktgjykim e Liruese	Aktgjykim e Refuzuese	Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Parash krim absolut	Paras hkrim relati v
VP kundër sigurisë së Republikës së Kosovës	3	0	1	0	2	0	1	0	0
VP të korrupsionit	18	15	8	1	16	12	5	4	0
VP Krim i organizuar	1	1	0	0	0	1	1	0	0
VP kundër njerëzimit	13	2	3	0	4	3	4	0	0
VP kundër jetës dhe trupit	83	5	11	3	8	13	16	0	0
VP kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	1	0	0	1	0	1	1	0	0
VP kundër të drejtave të votimit	0	2	13	0	1	8	1	0	0
VP kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	0	0	1	0	2	0	0	0	0
VP kundër integritetit seksual	17	3	5	1	6	10	3	1	1
VP kundër martesës dhe familjes	0	0	2	0	1	0	0	0	0
VP kundër shëndetit publik	0	0	0	0	0	0	0	0	0
VP të narkotikëve	73	28	26	0	9	11	5	1	2
VP kundër ekonomisë	8	12	11	3	4	18	4	0	3
VP kundër shërbimeve komunale	0	0	0	0	0	0	0	0	0
VP kundër pasurisë	41	3	6	2	13	14	8	2	0
VP kundër mjedisit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
VP kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	3	0	1	0	1	0	1	0	0
VP të armëve	19	80	43	5	4	7	7	0	1
VP kundër sigurisë së trafikut publik	3	0	1	0	0	4	0	0	0
VP kundër administrimit të drejtësisë	0	0	1	0	0	2	0	0	0
VP kundër rendit publik	1	1	0	0	0	1	0	0	0
Totali	284	152	133	16	71	105	57	8	7

Tabela 5 – Dënimet e shqiptuara sipas kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e parë 2019.

6. Ngarkesa totale me lëndë e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë 191,755 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 136.414 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 55.641 ose 33.35 % lëndë janë pranuar në punë gjatë vitit 2016. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 63.055 lëndë apo 33 %, ndërsa 128.700 ose 67 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2017 kanë pasur në punë 185.772 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 129.531 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 56.241 ose 33.35 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2017. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 71.230 lëndë apo 38 %, ndërsa 114.542 ose 62 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2018 kanë pasur në punë 179,242 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 119.454 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 59.788 ose 33.35 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2018. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 74.031 lëndë apo 41.31 %, ndërsa 105.211 ose 58.69 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Ndërkaq, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, nga gjithsej 133.657 lëndë në punë, janë trashëguar 106.229 lëndë, janë pranuar 27.428, janë zgjidhur 30.329 apo 23% e lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 103.328 lëndë apo 77% e tyre.

Nga raportet vjetore zyrtare të Prokurorit të Shtetit, vërehet se në raport me numrin e lëndëve të kryera, përqindja e numrit të lëndëve të zgjidhura në Prokurorin e Shtetit ka rënë vazhdimisht në mënyrë rapide, derisa numri i lëndëve të pranuar ka qenë jo edhe shumë i lartë, përkatësisht Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2016 ka pranuar 55.641, gjatë vitit 2017 ka pranuar 56.241 lëndë dhe gjatë vitit 2018 ka pranuar 59.788 lëndë.

6.1. Ngarkesa me lëndë në DKR të PTH gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019

DKR-të e Prokurorive Themelore në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2016, kanë trashëguar nga viti paraprak 2.208 lëndë, i kanë pranuar 1.910 lëndë të reja, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 4.118 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2.188 apo 53% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 1,930 apo 47% e tyre.

DKR-të e Prokurorive Themelore në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2017, kanë trashëguar nga viti paraprak 2.974 lëndë, i kanë pranuar 1.834 lëndë të reja, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 4.808 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2.620 apo 54% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 2,188 apo 46% e tyre.

Ndërsa, DKR-të e Prokurorive Themelore në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2018, kanë trashëguar nga viti paraprak 11.003 lëndë, i kanë pranuar 4.578 lëndë të reja, ndërsa gjithsej

kanë pasur në punë 15.581 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 5.252 apo 34% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 10,329 apo 66% e tyre.

Sipas të dhënave zyrtare të Prokurorit të Shtetit, në gjashtëmujorin e parë 2019, DKR-të e Prokurorive Themelore nga viti 2018 kanë trashëguar 10.329, kanë pranuar 2.221 lëndë të reja, ndërsa gjithsej numri i lëndëve të ngarkuara është 12550, prej të cilave i kanë zgjidhur 2835 apo 23%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 9715 lëndë apo 77% e lëndëve.

Numri i lëndëve 2018 – 6 mujori 2019	Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë		Të zgjidhura		Të pazgjidhura	
Vitet	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019	2018	6 mujori 2019
Prishtinë	1,003	4666	567	658	1,570	5324	655	1172	915	4152
Gjilan	24	143	322	288	346	431	319	229	27	202
Prizren	107	560	235	298	342	858	247	228	95	630
Pejë	54	392	180	223	234	615	163	314	71	301
Ferizaj	198	1016	248	247	446	1263	281	252	165	1011
Gjakovë	107	567	112	163	219	730	122	288	97	442
Mitrovicë	715	2985	246	344	961	3329	401	352	560	2977
Gjithsej	2,208	10329	1910	2221	4118	12550	2188	2835	1930	9715

Tabela 6 – Numri i lëndëve në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokuroritë Themelore.


Nga 1,910 lëndë të pranuar gjatë vitit 2018, DKR-të e Prokurorive Themelore kanë arritur të zgjidhin 2,188 lëndë, respektivisht 278 lëndë më shumë se sa numri i lëndëve të pranuar, që në përqindje i bie të jetë 114.5%

Ndërkaq, në gjashtëmujorin e parë 2019, DKR-të e Prokurorive Themelore kanë pranuar gjithsej 2,221 lëndë, derisa kanë zgjidhur 2.835 lëndë, përkatësisht 614 lëndën më shumë se sa numri i lëndëve të pranuar, që në përqindje i bie të jetë 127% të lëndëve.

Nga këto të dhëna shihet se ndonëse prokurorët kanë arritur që gjatë vitit 2018 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2019 të zgjidhin lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, shqetësuese vazhdojnë të mbeten numri i lëndëve që trashëgohen vit pas viti në DKR-të e Prokurorive Themelore, dhe qasja e sistemit prokurorial përkritazi me këto lëndë.


Gjatë vitit 2018, numri i lëndëve të trashëguara në këtë departament ka zbritur për 278 lëndë. Në fund të këtij viti, në DKR-të e Prokurorive Themelore kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 1930 lëndë. Nëse vazhdohet me këtë trend, kjo nënkupton se DKR-ve të Prokurorive Themelore për të përfunduar të gjitha lëndët të cilat barten vit pas viti i duhen edhe afërsisht 7 vite.

Ndërsa, nga gjithsej numri i lëndëve që DKR-të e Prokurorive Themelore kanë pasur në punë gjatë vitit 2018, del se në përqindje më së shumti lëndë ka zgjidhur DKR i Prokurorisë Themelore në Gjilan me 81%, ndërsa me numrin më të vogël të lëndëve të zgjidhura në këtë departament është DKR i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.



Grafika 2 – Përqindja e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë në Departamentet e Krimeve të Rënda në Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2018.

Në gjashtëmujorin e parë 2019, DKR i Prokurorisë Themelore në Gjilan përsëri ka përqindjen më të madhe të lëndëve të zgjidhura ku nga gjithsej 431 lëndë, ka zgjidhur 229 apo 53% të lëndëve të ngarkuara në gjashtëmujorin e parë, ndërsa më së paku lëndë të zgjidhura ka DKR i PTh në Mitrovicë ku nga gjithsej 3329 lëndë, në gjashtëmujorin e parë 2019, ka arritur të zgjidhë vetëm 352 lëndë apo 11%.



Grafika 3 – Përqindja e lëndëve të zgjidhura në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokuroritë Themelore në gjashtëmujorin e parë 2019.

Mirëpo, nëse llogarisim numrin e lëndëve të pranuar me numrin e lëndëve të përfunduara dalin rezultate tjera si më poshtë:

DKR-të e Prokurorisë Themelore	Numri i lëndëve të pranuar		Numri i lëndëve të zgjidhura		Diferenca		% e efikasitetit	
	2018	Janar - Qershor 2019	2018	Janar - Qershor 2019	2018	Janar - Qershor 2019	2018	Janar - Qershor 2019
Prishtinë	567	658	655	1172	+88	+514	115.5%	178.1%
Gjilan	322	288	319	229	-3	-59	99%	79.5 %
Prizren	235	298	247	228	+12	+91	105%	76.51%
Pejë	180	223	163	314	-17	+91	90.5%	140.8%
Ferizaj	248	247	281	252	+33	+5	113.3%	102 %
Gjakovë	112	163	122	288	+10	+125	108.9%	176.6%
Mitrovicë	246	344	401	352	+155	+8	163%	102.3%
Total	1910	2,221	2188	2835	+278	+614	114.5%	127.6%

Tabela 2: Përqindja e numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar në DKR-të e Prokurorisë Themelore.

Nga të dhënat e kësaj tablele vërehet se gjatë vitit 2018, përjashtimisht Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe asaj në Pejë, të gjitha prokuroritë e tjera kanë zgjidhur lëndë më shumë se sa që kanë pranuar. Gjatë vitit 2018, në përqindjen e numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me

numrin e lëndëve të pranuar, përqindjen më të lartë e ka Prokuroria Themelore në Mitrovicë, derisa përqindjen më të ulët e ka Prokuroria Themelore në Pejë.

Sa i përket periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, përpos Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe asaj në Prizren, të gjitha Prokuroritë Themelore kanë zgjidhur lëndë më shumë se sa që kanë pranuar. Gjatë kësaj periudhe kohore, përqindjen më të lartë të numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar e ka Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe ajo në Gjakovë, derisa përqindjen më të ulët e ka Prokuroria Themelore në Prizren.

Këto të dhëna, IKD i ka marrë nga raportet zyrtare të Prokurorit të Shtetit, të prezantuara dhe të miratuar nga KPK. Në bazë të këtyre të dhënave, IKD vlerëson se është e pamundur të vihet deri tek vlerësimet lidhur me trendin e efikasitetit të Prokurorit të Shtetit, për shkak të paqartësive numerike në këtë raport. Logjika e raporteve statistikore është që fundi i një periudhe duhet ke të korrespondojë me fillimin e periudhës tjetër, gjë që nuk ndodhë në raportet statistikore të Prokurorit të Shtetit. Shembull për këtë mund të marrim lëndët e mbetura të pazgjidhura dhe lëndët e pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese. Sipas raportit të vitit 2016, të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 1,930 lëndë, derisa raporti i vitit 2017 thotë se nga viti 2016 janë trashëguar 2,974 lëndë. Diferenca në këtë rast është hiç më pak se 1,044 lëndë. Ndërsa, raporti i Prokurorit të Shtetit për vitin 2017 thotë tregon se në fund të periudhës raportuese (31 dhjetor 2017) kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 2,188 lëndë, derisa raporti i Prokurorit të Shtetit për vitin 2018 tregon hotë se të trashëguara nga viti 2017 janë gjithsej 2,208 lëndë. Në këtë rast, diferenca është 20 lëndë. Lidhur me këtë mos përputhje, Raportet e Prokurorit të Shtetit nuk japin asnjë sqarim. Në anën tjetër, Prokurori i Shtetit nuk ka publikuar raport mbi punën e Prokurorit të Shtetit në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019. Këto të dhëna, IKD i ka siguruar nga KPK. Por, edhe këto të dhëna nuk përputhen në asnjë mënyrë me të dhënat në raportet zyrtare të Prokurorit të Shtetit. Në këtë drejtim, përderisa në fund të vitit 2018 raporti i Prokurorit të Shtetit tregojnhotë se kanë mbetur të pazgjidhura edhe 1930 lëndë, të dhënat e KPK-së thonë tregojnë se në fillim të vitit 2019 kanë qenë të trashëguara nga viti 2018 plotë 10,329 lëndë.

IKD vlerëson se është e papranueshme kjo qasje e Prokurorit të Shtetit në raportet e saja vjetore. Prokurori i Shtetit duhet të jetë i vetëdijshëm se Raporti Vjetor i këtij institucioni është dokumenti më i rëndësishëm lidhur me punën gjatë një viti. Për këtë arsye, nuk është e thënë që ky raport të ndërtohet mbi shabllone të caktuara, nga të cilat më së paku kupton publiku, mediat dhe shoqëria civile. Për këtë arsye, sikurse në raportet periodike të IKD-së mbi punën e sistemit prokurorial, IKD vlerëson se këto raporte duhet të jenë raporte analitike dhe të qarta, e mbi të gjitha, të sakta¹².

¹² Shënim: Përpos këtij rasti, IKD vazhdimisht përballet me probleme të tilla sa i përket statistikave të sistemit gjyqësor dhe sistemit prokurorial. Të dy këshillat duhet ta vlerësojnë rëndësinë që kanë statistikave për të ndërtuar analiza të ndryshme, qoftë nga vetë këshillat apo edhe nga shoqëria civile. Për këtë arsye, është e domosdoshme që çështjes së statistikave ti kushtohet një kujdes më i madh. Për më tepër, kjo ishte evidentuar edhe në raportet

6.2. Ngarkesa më lëndë në DKR të PTh sipas kategorive të veprave penale

Me qëllim që të pasqyrohet sa më drejt e gjithë puna e DKR-ve të Psh-së, IKD ka kërkuar qasje në statistikën e KPK-së mbi numrin e lëndëve të PSh-së sipas kategorive të veprave penale. Këto të dhëna, sipas secilës kategori të veprave penale, të përcaktuara me KPRK-së, KPK nuk i gjeneron. IKD ka pranuar të dhëna statistikore për vetëm 12 kategori të veprave penale, ndër të cilat nuk janë edhe kategoritë e veprave penale të korrupsionit, krimeve të luftës, armëve, narkotikëve etj. Këto të dhëna janë pranuar vetëm për vitin 2018 dhe jo edhe për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, ashtu siç IKD kishte kërkuar me anë të kërkesës për qasje në statistika.

Në raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit për vitin 2018, paraqiten 6 kategori të dhëna mbi kategoritë e veprave penale të terrorizmit, krimeve të luftës, korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Sa i përket veprave penale të terrorizmit, PSh gjatë vitit 2018 ka pranuar në punë 5 raste me 10 persona derisa ka zgjidhur 15 raste me 32 persona (ndaj 13 personave është ngritur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve, ndaj 4 personave është hudhur kallëzimi penal ndërsa janë pushuar hetimet ndaj 15 personave).

Për veprat penale të krimeve të luftës, PSh gjatë vitit 2018 ka trashëguar nga viti 2017 712 raste derisa ka pranuar në punë 8 raste me 19 persona dhe ka zgjidhur 16 raste me 62 persona (ndaj 2 personave është ngritur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve, ndaj 1 personi është bërë bashkimi i procedurës, për 41 persona lënda është deleguar në kompetencë ndërsa ndaj 18 personave janë pushuar hetimet).

Sa i përket veprave penale nga kapitulli i korrupsionit, Raporti Vjetor i PSh-së për vitin 2018 jep të dhënat mbi numrin e lëndëve nga regjistri “PP” dhe nga regjistri “PPN”.

Sa i përket veprave penale të korrupsionit nga regjistri “PP”, Prokuroritë Themelore kanë pranuar në punë 325 kallëzime penale ndaj 656 personave.

Nga regjistri “PPN”, PTh-të gjatë vitit 2018 kanë pranuar në punë 443 lëndë me 746 persona.

Raporti i PSh-së për vitin 2018 nuk jep të dhëna mbi numrin e lëndëve të trashëguara për këto kategori si dhe as nuk tregon numrin e lëndëve të kryera. Sa i përket regjistrin “PP”, sipas këtij raporti, prokurorët kanë kryer 122% të lëndë të pranuar, që ndryshe mund të zëbërthet se kan kryer gjithsej 396 lëndë.

e kaluara të IKD-së. Shih Shala, Gzim. “Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial”. IKD. 29 janar 2019. f.15-16 dhe 32-33. (<https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/01/Raporti-KGJK-KPK-2018-Final-29.01.2019-1-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 12 shtator 2019).

Sa i përket veprave penale të krimeve ekonomike nga regjistri “PP”, sipas këtij raporti, PSh gjatë vitit 2018 kanë pranuar në punë 398 lëndë dhe i kanë zgjidhur 435 kallëzime penale, derisa në fund të vitit 2018 kanë mbetur të pazgjidhura edhe 380 lëndë.

Ndërsa sa i përket veprave penale të krimeve ekonomike nga regjistri “PPN”, sipas këtij raporti, PSh gjatë vitit 2018 kanë pranuar në punë 252 lëndë dhe i kanë zgjidhur 192 kallëzime penale, derisa në fund të vitit 2018 kanë mbetur të pazgjidhura edhe 234 lëndë.

Lidhur me veprat penale të trafikimit me qenie njerëzore, PSh gjatë vitit 2018 ka pasur në punë gjithsej 82 raste me 210 persona ku prej tyre, kanë zgjedhur 25 raste me 72 persona, derisa në fund të vitit 2018 kanë mbetur të pazgjidhura edhe 57 lëndë, me 138 persona.

7. Performanca e individuale e Gjykatësve dhe Prokurorëve në DKR

7.1. Performanca e gjykatësve në DKR


DKR-të në Gjykatat Themelore në vend gjatë vitit 2018 ka qenë i ngarkuar me gjithsej **5431** lëndë, derisa në këto departamente kanë qenë të angazhuar gjithsej 50 gjyqtarë. DKR në Prishtinë ka 18 gjyqtarë, DKR në Gjiilan 5, DKR në Prizren 6, DKR në Mitrovicë 8, DKR në Gjakovë 4, DKR në Pejë 5 dhe DKR Ferizaj 4.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, e miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në Departamentin e Krimeve të Rënda është 3, ndërsa norma vjetore 31.

Duke marrë për bazë ngarkesën e lëndëve në këtë departament, del që një gjyqtar në këtë departament gjatë vitit 2018, ka qenë i ngarkuar me mbi **108** lëndë në punë, derisa brenda një muaji ka pranuar edhe 2.2 lëndë të reja.

Mesatarisht, gjatë vitit 2018 një gjykatës ka zgjidhur gjithsej 3 lëndë në muaj, që nëse llogaritet për një vit, një gjyqtar në këtë departament brenda një viti arrin të zgjidhë 36 lëndë, përkatësisht 5 lëndë më shumë se sa norma vjetore.

Në raport me numrin e lëndëve me të cilat një gjyqtar ka qenë i ngarkuar brenda një viti, del se mesatarisht gjyqtarët kanë zgjidhur 33% të lëndëve me të cilat kanë qenë të ngarkuar.



Grafika 4- Numri i lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2018 nga një gjykatës në Departamentin e Krimeve të Rënda.

Në anën tjetër, KGJK gjatë vitit 2018 ka bërë një hap para në kuptim të transparencës së sistemit gjyqësor, në atë mënyrë që ka publikuar raportin statistikor për punën e gjyqtarëve

për vitin 2018, ku sipas këtyre statistikave, ka diferencë të madhe të numrit të lëndëve të kryera mes gjyqtarëve në Departamentin e Krimeve të Rënda.

Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjakovë Nikollë Komani, sipas raportit statistikor të punës së gjyqtarëve, gjatë vitit 2018 rezultoi se ka kryer 18 lëndë, apo 13 lëndë më pak se norma vjetore prej 31 lëndë, ndërsa sipas normës mujore, e cila është 3 raste, ky gjyqtar gjatë një muaji ka arritur të zgjidhë 1.5 lëndë. Ndërsa gjyqtari i DKR të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Shashivar Hoti dhe gjyqtari në DKR Prizren, tani kryesues i KGJK-së Skender Çoçaj, gjatë vitit 2018 kanë kryer 25 lëndë, apo 6 më pak se norma vjetore prej 31 lëndë, apo vetëm nga 2 lëndë në muaj, edhe pse norma mujore duhet të jetë 3 lëndë të zgjidhura.



Nikollë Komani – Gjakovë
18 lëndë



Shashivar Hoti- Prishtinë
25 lëndë



Skender Çoçaj - Prizren
25 lëndë¹³

Gjykatësit e Departamentit të Krimeve të Rënda që kanë kryer lëndë nën normën vjetore.

Në anën tjetër, në DKR-të e Gjykatave Themelore, ka edhe gjyqtarë që kanë kryer lëndë më shumë se sa norma vjetore.

Shpresa Hasaj-Hyseni gjyqtare në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka kryer 82 lëndë, apo 51 lëndë më shumë se sa norma vjetore, që nëse llogaritet mesatarja për një muaj del se kjo gjyqtare ka kryer afër 7 lëndë në muaj. Pas saj me numrin më të madh të lëndëve të përfunduara gjatë vitit 2018, pason gjyqtari i DKR-së në Gjykatën Themelore në Gjiilan Islam Thaçi, i cili sipas raportit statistikor ka kryer 77 lëndë, apo 46 lëndë më shumë se sa norma vjetore, që nëse llogaritet për një muaj i bie që ky gjyqtar i kryen mbi 6 lëndë në muaj. Pas tij pason gjyqtarja e DKR-së në Gjykatën Themelore

¹³ *Sqarim:* Sa i përket Gjyqtarit Skender Çoçaj, i njëjti gjatë vitit 2018 ka qenë edhe anëtar i KGJK-së dhe Kryesues i Komisionit për Buxhet dhe Financa në KGJK. Prej 8 marsit 2019, Çoçaj është Kryesues i KGJK-së, e që sipas ligjit, i njëjti e pezullon pozitën e tij si gjyqtarë deri në përfundimin e mandatit të tij si kryesues i KGJK-së.

në Prishtinë Suzana Çerkini e cila ka kryer 69 lëndë, apo 38 lëndë më shumë se sa norma vjetore, që për një muaj i bie që kjo gjyqtare i kryen mbi 5 lëndë.¹⁴



Shpresa Hasaj-Hyseni – Prishtinë
Prishtinë

82 lëndë



Islam Thaçi – Gjilan

77 lëndë



Suzana Çerkini –

69 lëndë

Gjykatësit e Departamentit të Krimeve të Rënda që kanë kryer lëndë mbi normën vjetore.

Nëse 50 gjyqtarët e DKR-së, gjatë vitit do të kryenin mesatarisht 80 lëndë ashtu siç i kishin përfunduar disa gjyqtarë, atëherë numri i përgjithshëm i lëndëve të kryera gjatë një viti do të arrinte në 4.000 lëndë të zgjidhura në këtë departament.

Sa i përket performancës individuale të gjyqtarëve në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, IKD e ka siguruar këtë raport nga KGJK me anë të kërkesës së qasje në dokumentet publike.

Pas analizimit të këtij raporti, IKD ka gjetur se dukuria e disbalancit jashtëzakonisht shumë të theksuar në mes të numrit të lëndëve të kryera nga gjyqtarët është e shprehur edhe në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019.

Në këtë raport, 3 ndër gjyqtarët që më së paku kanë kryer lëndë në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019 janë Gjyqtari Shaqir Zika me 13 lëndë të përfunduara, Gjyqtarja Raima Elezi dhe Gjyqtari Xheladin Osmani me nga 14 lëndë të përfunduara.

Ndërsa, Gjyqtari i Departamentit të Krimeve të Rënda që ka kryer më së shumti lëndë në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019 është Gjyqtari Radoslav Marković me gjithsej 55

¹⁴*Shënim:* Këto të dhëna janë marrë nga raporti statistikor i punës së gjyqtarëve për vitin 2018 i publikuar në ueb faqe të KGJK-së. IKD në këto statistika ka përfshirë tre gjyqtarët që kanë kryer lëndën nën normën vjetore dhe tre që kanë kryer më së shumti lëndë. IKD në listën e gjykatësve që kanë kryer lëndë nën normën vjetore ka marrë për bazë gjykatësit që kanë punuar gjithsej 12 muaj të vitit, ndërsa në këtë listë nuk i ka përfshirë edhe gjykatësit që kanë punuar më pak se 12 muaj, për shkak se nëse këta të fundit do ishin përfshirë në këtë listë, do ishte shtuar numri i gjykatësve që kanë kryer lëndë nën normën vjetore. Ndërsa në listën e tre gjykatësve që kanë krye lëndë mbi normën vjetore, janë të përfshirë tre gjykatësit që kanë krye më së shumti lëndë, e jo edhe gjykatësit e tjerë që kanë kryer lëndë mbi normën vjetore.

lëndë, pasuar nga Gjyqtarja Suzana Qerkini me 48 lëndë dhe Gjyqtarja Violeta Namani me 43 lëndë.

Pra, nga këto të dhëna vërehet se ka një disbalanc jashtëzakonisht të madh. Nëse i mbledhim numrin e lëndëve të kryera të tre gjyqtarëve që kanë kryer më së paku lëndë, atëherë totali del të jetë 41 lëndë. Pra, ky total është më i ulët se sa numri i lëndëve që ka kryer secili prej tre gjyqtarëve me performancën më të mirë në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019.

Ndërsa për dallim nga viti 2018, që një gjyqtar në DKR ka pasur në punë 108 lëndë, ky numër ka rënë gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2019. Gjatë kësaj periudhe kohore, 51 gjyqtarët e DKR-ve të të gjitha Gjykatave Themelore kanë qenë të ngarkuar mesatarisht me nga 80 lëndë, ku brenda një muaji secili prej tyre kanë pranuar edhe nga 1.9 lëndë, ndërsa kanë arritur të zgjidhin 2.9 lëndë në muaj, që nëse llogaritet për gjashtëmujorin e parë 2019, rezulton se një gjykatës ka arritur të zgjidhë 17.4 lëndë.

7.2. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në DKR të Gjykatave Themelore gjatë vitit 2018

Gjatë vitit 2018, dënimi më i shpeshtë që DKR-të e Gjykatave Themelore kanë shqiptuar gjatë vitit 2018, ka qenë dënimi me burgim efektiv, ku nga gjithsej 1810 lëndë të zgjidhura, në 487 raste kanë shqiptuar këtë lloj të dënimit. Ndërsa, dënimi i dytë më i shpeshtë në këtë departament është dënimi me kusht, ku në 411 raste ka është shqiptuar këtë lloj të dënimit, ndërsa 327 janë shqiptuar dënime me gjobë. Nga gjithsej 1.810 lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2018, DKR-të e Gjykatave Themelore në 160 raste kanë shpallur aktgjykime liruese, ndërsa në 186 raste aktgjykime refuzuese.

Gjykatat	Dënim me burgim	Dënime me gjobë	Dënimet me kusht	Dënime tjera	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Parashkrimi relativ	Parashkrim absolut	Është zgjidhur në mënyrë tjetër
Prishtinë	134	96	199	0	65	45	6	19	65
Prizren	72	10	22	1	12	6	0	3	8
Mitrovicë	54	5	29	1	15	110	0	28	56
Gjilan	87	105	52	5	41	9	1	0	14
Ferizaj	52	76	55	1	5	5	0	3	8
Gjakovë	29	20	17	0	9	3	0	3	10
Pejë	59	15	37	0	13	6	0	0	9
Gjithsej	487	327	411	8	160	184	7	56	170

Tabela 7 – Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në DKR të Gjykatave Themelore gjatë vitit 2018.

Në DKR-të e Gjykatave Themelore shqetësuese vazhdon të mbetet parashkrimi i lëndëve. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2018, në sistemin gjyqësor janë parashkruar gjithsej 63 raste që bien në kompetencë të DKR-ve, ku 7 prej tyre kanë arritur parashkrimin relativ, ndërsa 56 prej tyre kanë arritur parashkrimin absolut.

8. Performanca e prokurorëve në DKR

Gjatë vitit 2018, numri i prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda ka qenë 38 prokurorë në 7 Prokuroritë Themelore, dhe një Prokuror në Prokurorinë e Apelit. Numrin më të madh të prokurorëve në këtë departament e ka Prokuroria Themelore në Prishtinë më 16 prokurorë, Peja me 5, Prizreni 4, Gjilani 4, Mitrovica 3, Ferizaj 3 dhe Gjakova 2¹⁵.

¹⁵ Sqarim: Në kuadër të numrit total të Prokurorëve të DKR-ve të Prokurorive Themelore, janë edhe 3 Prokurorë të cilët krahas kësaj detyre, kryejnë edhe detyrën e anëtarit të KPK-së: Arben Ismajli – PTh Gjilan, Haxhi Sinanaj – PTh Pejë dhe Ikramije Bojaxhiu – PTh Prishtinë. Kjo e fundit, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për KPK-në, nga 18 prilli 2019, ka pezulluar detyrën e prokurores, pasi është e angazhuar si Kryetare e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve. Sipas këtij ligji, detyrën e prokurorit në DKR të PTh në Gjilan e ka pezulluar edhe zëvendës kryesuesi i KPK-së, Arben Ismajli.

Në vitin 2018, DKR-të e Prokurorive Themelore kanë pasur në punë 4,118 kallëzime penale, prej të cilave i kanë zgjidhur 2,118, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 1,930 lëndë.

Nga 38 prokurorët e gjitha DKR-ve, secili prokuror ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 108.3 lëndë në vit.

Sipas raportit vjetor të Prokurorit të Shtetit, prokurorët e DKR-ve të Prokurorive Themelore gjatë vitit 2018 kanë zgjidhur mesatarisht nga 59.13 lëndë, përkatësisht 6.87 nën normën vjetore. Sipas këtij raporti, Departamenti për Krime të Rënda më efikas ka qenë ai i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ku prokurorët kanë zgjidhur mesatarisht nga 133.6 kallëzime penale, apo 67.6 kallëzime penale mbi normën vjetore. Mbi normën vjetore lëndë kanë zgjidhur edhe DKR e PTh në Ferizaj (96.6 kallëzime penale) dhe në Gjilan (79.75 kallëzime penale)¹⁶.

Ndërsa, prokuroritë më jo efikase, të cilat kanë punuar nën normën vjetore janë DKR i PTh-së në Prizren ku secili prokuror ka zgjidhur mesatarisht 61.75 lëndë në vit, DKR i PTh-së në Gjakovë me mesatarisht 61 kallëzime penale në vit për prokurorë dhe DKR i PTh-së në Prishtinë me mesatarisht 40.93 kallëzime penale në vit për prokurorë. Sipas këtij raporti, kampion në mos efikasitet është DKR i PTh-së në Pejë, ku gjatë vitit 2018, prokurorët kanë kryer mesatarisht 32.6 kallëzime penale. Në norma mujore, kjo nënkupton se prokurorët e DKR në PTh të Pejës kanë kryer më pak se nga 3 lëndë në muaj.

Ndonëse nga DKR-të e 7 Prokurorive Themelore, vetëm 3 prej tyre e kanë arritur normën vjetore për prokurorë, Prokurori i Shtetit në raportin e vet vjetor për vitin 2018 e paraqet këtë fakt vetëm në mënyrë përshkruese, duke mos dhënë asnjë detaj nëse vetë Prokurori i Shtetit apo KPK ka marrë ndonjë masë lidhur me këtë mos efikasitet të prokurorëve. Në anën tjetër, përpos këtij fakti, Prokurori i Shtetit dhe as KPK nuk kanë dhënë asnjë përgjigje lidhur me atë se pse ka ardhur deri tek ky fakt, ku 4 prej 7 DKR-ve të PTh-ve nuk kanë arritur normën vjetore.

IKD vlerëson se secila Prokurori Themelore që sipas këtij raporti të Prokurorit të Shtetit nuk e ka arritur minimumin e normën vjetore duhet të jap një sqarim se pse ka ardhur deri tek një situatë e tillë. KGJK gjatë vitit 2018 ka publikuar raportin vjetor mbi performancën individuale për secilin gjyqtar. Por, këtë nuk e ka bërë edhe KPK. Në këtë mënyrë, publiku, mediat dhe shoqëria civile nuk e ka parasysh nëse mesatarja e mos efikasitetit të këtyre 4 DKR-ve të PTh-ve ka ardhur si pasojë e mos efikasitetit të të gjithë prokurorëve, apo për shkak të mos efikasitetit të vetëm disa prej prokurorëve.¹⁷ Në anën tjetër, IKD vlerëson se për


¹⁶ "Raporti i punës 2018 – Prokurori i Shtetit". Prokurori i Shtetit. Shkurt 2019. f.62. (Shih linkun <http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202018%20i%20Prokurorit%20i%20Shtetit.pdf>). (Qasur së fundi më 16 gusht 2019).

¹⁷ Shënim: IKD vlerëson se aspekti i kuantitetit të kryerjes së lëndëve nga gjykatësit dhe prokurorët është vetëm një aspekt i vlerësimit të performancës së tyre, por assesi nuk mund të vlerësohet si aspekti më i rëndësishëm.

këtë çështje përgjigje duhet të jap edhe KPK-ja, në atë mënyrë që t'i sqarojë opinionit publik se pse ka ardhur deri tek kjo situatë, dhe jo thjesht ta miratojë një raport përshkrues dhe të përfundoj çështja, duke e konsideruar si një obligim të përmbushur. Në thelb, raporti vjetor i PSh-së duhet të shërbejë si udhërrëfyes në punën e Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së, për të parë fushat ku këto dy institucione duhet të ndërhyjnë, dhe jo vetëm të përshkruajnë situatat e ndryshme. Nëse përkundër evidentimit të këtij efikasiteti në këtë raport KPK mbyllë sytë, kjo do të jetë pothuajse një betonizim i mungesës së llogaridhënies së prokurorëve në kuptim të efikasitetit në punën e tyre. Prandaj, IKD në raportet e saja periodike, vazhdimisht ka kritikuar qasjen e KPK-së, e cila asnjëherë nuk ka përmbushur obligimet e veta ligjore, për tu siguruar se raportet janë përmbajtësore dhe analitike dhe jo vetëm raporte shabllon, duke mos i shërbyer qëllimit për çka janë përgatitur.

8.1. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga DKR-të e Prokurorive Themelore

Nga kallëzimet penale që kanë qenë në punë, prokurorët i kanë zgjidhur në këto mënyra: me aktakuzë të drejtpërdrejtë i kanë përfunduar 72 ose 2.08% të personave, me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor kanë përfunduar 5 ose 1.14% të personave, me hushje të kallëzimit penal janë zgjidhur 877 ose 25.44% të personave. Procedura penale është hapur ndaj 2.514 personave. Pas përfundimit të hetimeve, aktakuza janë ngritur ndaj 1.567 ose 62.33% personave, hetimet janë pushuar ndaj 564 ose 22.43% të personave, hetimi është pezulluar ndaj 148 ose 5.88% të personave, si dhe propozime për shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm ndaj 9 personave ose 0.3% të tyre.



Grafika 5 - Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë vitit 2018.

Në fund të vitit 2018 kanë mbetur të papërfunduara hetimet ndaj 481 personave, ndërsa në kompetencë janë dërguar rastet e 253 personave, rastet e të cilëve nuk konsiderohen si raste të zgjidhura.


Sipas këtyre të dhënave, rezulton se Prokurorët e Shtetit kanë mbyllur në Prokurori gjithsej 1,441 lëndë, të cilat nuk i janë nënshtruar fare asnjë lloj kontrolli gjyqësor. Kjo për arsye se KPPRK ka ndërtuar një qasje, e cila është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me dokumentet ndërkombëtare që garantojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Kontrolli gjyqësor në rastet pushimit të hetimeve dhe hudhjes së kallëzimeve penale në bazë të ligjit në Kosovë nuk ekziston fare. Prokurori njofton gjykatën vetëm sa i përket pushimit të hetimit, përderisa gjykatësi nuk ka kontroll apo kompetencë për të vlerësuar nëse vendimi i prokurorit është i bazuar në ligj, dhe nëse faktet dhe provat e grumbulluara janë të mjaftueshme për të proceduar me rastin në gjykim. Në rastet e hudhjes së kallëzimit penal, gjykata nuk pranon madje as njoftim, lidhur me mbylljen e rastit. Ndaj vendimit të prokurorit të shtetit, nuk lejohet ankesë qoftë nga ana e parashtresit të kallëzimit penal apo të dëmtuarit nga vepra penale.

Për më tepër, kodi i procedurës penale nuk lejon padinë private e as padinë subsidiare, kjo pasi kodi penal nuk parasheh asnjë vepër penale, e cila ndiqet sipas padisë private. Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë nuk mundëson ankesë nga vendimeve të prokurorit në rastet e hudhjes së kallëzimit penal apo të pushimit të hetimeve. Në këtë drejtim vendimi i prokurorit për të mbyllur rastet në këtë fazë të procedurës penale, është përfundimtar.

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta në ankesë dhe e drejta e qasjes në gjykatë, hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kushtetuta e Kosovës garanton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Gjatë kësaj periudhe, DKR-të e Gjykatave Themelore, duke vendosur sipas akteve akuzuese të prokurorëve, kanë marrë 1.976 vendime gjyqësore, ku 1548 prej tyre janë aktgjykime fajësuese.



Grafika 6 – Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve.

Sipas kësaj, rezulton se 78.34% e personave janë shpallur fajtor dhe janë dënuar me aktgjykim fajësues, 199 persona janë liruar nga akuza, ndaj 127 personave është refuzuar aktakuza, ndaj 89 personave është hudhur aktakuza, ndaj 11 personave është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm, ndërsa ndaj 2 personale është shqiptuar urdhër ndëshkimor.

Ndaj këtyre vendimeve prokurorët e Departamentit të Krimeve të Rënda kanë parashtruar 447 ankesa nga të cilat 228 janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin. Lidhur me vendimet e Gjykatës së Apelit përkitazi me ankesat e prokurorëve, Raporti i Prokurorit të Shtetit nuk ofron të dhëna.

Sa i përket mënyrës së kryerjes së lëndëve në DKR-të e PTh-ve gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, IKD ka siguruar këto të dhëna statistikore nga KPK përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike.

Sipas këtyre të dhënave, rezulton se DKR-të e PTh-ve gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019 kanë hudhur kallëzimet penale ndaj 327 personave, kanë ngritur aktakuzë të drejt për drejt, për 32 persona, për 5 persona kanë ngritur aktakuza me urdhër ndërkimor dhe për 702 persona kanë ngritur aktakuza pas zhvillimit të hetimeve, derisa ndaj 246 personave janë pushuar hetimet (4 prej tyre për shkak të Ligjit për Amnisti) dhe ndaj 100 personave janë pezulluar hetimet.

Në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, në DKR-të e PTh-ve ishin mbyllur rastet ndaj 2 personave për shkak të parashkrimit, ndaj 2 personave është propozuar shqiptimi i masave për trajtim të detyrueshëm derisa ndaj 211 personave të tjerë, lëndët janë dërguar në kompetencë.

Gjatë këtij periudhe kohore, në DKR-të e PTh-ve, në total ishin gjithsej 1212 persona nën hetime.


9. Gjetjet e IKD-së në trajtimin e rasteve në Krime të Rënda

IKD pos monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit të profilin të lartë, ka monitoruar edhe rastet të tjera që janë në kompetencë të DKR-ve të Gjykatave Themelore, duke i përfshirë edhe 18 raste të terrorizmit.

Në këtë raport, subjekt i hulumtimit dhe analizës janë rastet e Krimeve të Rënda të monitoruara gjatë vitit 2018 dhe gjashtë muorit të vitit 2019 nga hulumtuesit e IKD-së, të cilët gjatë kësaj periudhe kanë monitoruar **3,385** seanca gjyqësore, ku përfshihen **1,116** raste me **2,631** persona të akuzuar.

Prej 2,631 personave të akuzuar, 2442 i takojnë gjinisë mashkullore, derisa 180 i takojnë gjinisë femërore.

Prej **3,385** seancave të monitoruara, **2,514** seanca apo **72.71 %** të seancave janë mbajtur ndërsa **871** seanca apo 27.2% të seancave janë shtyrë për arsye të ndryshme.




Grafika 7 – Numri i seancave të monitoruara nga IKD në DKR të Gjykatave Themelore (1 janar 2018 – 30 qershor 2019)

Bazuar në monitorimin sistematik të IKD-së në Departamentin e Krimeve të Rënda në të gjitha Gjykatat Themelore, rezulton se janë shpallur **869** aktgjykime, prej të cilave **567** kanë qenë aktgjykime dënuese, **219** lirues dhe **83** refuzuese.

Aktgjykime dënuese	Aktgjykime liruese	Aktgjykime refuzuese
567	219	83

Tabela 8 - Numri i personave të dënuar me burgim efektiv, me kusht dhe me gjobë gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujori i vitit 2019.

Nga dënimet e shqiptuara nga DKR-të e Gjykatave Themelore gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, dënimi më i shpeshtë ka qenë dënimi me burgim efektiv, në plotë 300 raste, pasuar me dënimin me gjobë të shqiptuar ndaj 290 personave dhe dënimin e burgim me kusht të shqiptuar ndaj gjithsej 195 personave.



Grafika 8 – Numri i personave të dënuar sipas monitorimit të IKD-së (1 janar 2018 – 30 qershor 2019).

Sa i përket kërkesave për sekuestrim, IKD gjenë se nga 1,116 rastet e monitoruara gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, Prokurori i Shtetit kishte paraqitur kërkesë për sekuestrim në vetëm 113 raste, përkatësisht në vetëm 10.1% të rasteve.¹⁸

IKD gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit 2019 ka monitoruar gjithsej 18 raste të terrorizmit, të cilat do të trajtohen në detaje në kapitullin vijues.

¹⁸ “Platforma e Monitorimit të Gjyqësorit”. IKD. (Qasur për herë të fundit më 21 gusht 2019).

10. Trajtimi i rasteve të terrorizmit nga Republika e Kosovës

Nga rastet që deri më tani janë trajtuar në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda janë edhe rastet e terrorizmit. Që nga funksionalizimi i Departamentit Special për Lëndët në Kompetencë të PSRK-së (28 qershor 2019), këto lëndë do të trajtohen në kuadër të këtij departamenti.

Terrorizëm, veprim terrorist apo vepër e terrorizmit sipas KPRK-së është kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare.

Terrorizmi vazhdon të mbetet ankth për çdo individ dhe shoqëri në mbarë botën, si dhe një nga kërcënimet kryesore të sigurisë vendore dhe globale, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe vet mënyrën e jetesës së shoqërisë.

Viteve të fundit, bota kishte filluar të tmerrohej me pamjet që vinin sidomos nga Siria dhe Iraku, për luftërat e përgjakshme që kishin nisur atje dhe për grupet terroriste që kishin lindur në këto dy shtete aziatike. I formuar si një grup që pretendonte ta krijonte të ashtuquajturin “Shteti Islam”, veprimtarinë e tij terroriste, do ta shtrinte edhe përtej kufijve të këtyre dy shteteve, e në kuadër të kësaj do të rekrutonte njerëz në radhët e veta nga shumë vende të ndryshme të botës.

Kësaj lufte në “tokën e premtuar” nuk u kishin shpëtuar as qindra kosovarë, të cilët në mënyra të ndryshme, kishin arritur që të bëheshin pjesë e grupeve të ndryshme terroriste në Siri e Irak, si “ISIS”, “Al Nusra” e të tjerë. Kosova është renditur në mesin e shteteve me numrin më të madh të qytetarëve që iu kanë bashkuar organizatave terroriste "ISIS" e "Al-Nusra" në Siri e Irak, krahasuar me numrin e përgjithshëm të banorëve.

Departamenti Amerikan i Shtetit në shtator 2018, ka publikuar raportin vjetor për terrorizmin në botë për vitin 2017, ku një pjesë e veçantë e këtij raporti iu është kushtuar edhe Kosovës.¹⁹ Sipas këtij raporti, Kosova vazhdon t'i kundërvihet kërcënimit gjithnjë në rritje të terrorizmit në vitin 2017, ku rreth 403 qytetarë të Kosovës, kishin udhëtuar në Siri dhe Irak për t'u bashkuar me ISIS-in apo Frontin el-Nusrah, prej të cilëve rreth 74 kanë vdekur, 133 janë kthyer, 196 kanë mbetur në zonat e konfliktit, 40 fëmijë të lindur nga qytetet të Kosovës në zonat e konfliktit.

¹⁹ “Departamenti Amerikan i Shtetit: Kosova i kundërvihet terrorizmit gjithnjë në rritje”. Telegrafi. 19 shtator 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/departamenti-amerikan-shtetit-kosova-kundervihet-terrorizmit-gjithnje-ne-rritje/>). (Qasur së fundi më 19 gusht 2019).

Numri i kosovarëve që kishin udhëtuar në Siri dhe Irak	Numri i personave që kishin mbetur në zonat e konfliktit	Numri i personave që ishin kthyer	Numri i personave të vdekur
403	196	133	74

Tabela 9 – Statistikat e kosovarëve në zonat e konfliktit sipas Departamentit Amerikan të Shtetit.

Raporti në fjalë përmend se në Kosovë, kishin vazhduar gjykimet dhe hetimet për 51 të dyshuar dhe 29 raste, ku përfshiheshin disa imamë të arrestuar që nga viti 2014 nën akuza për terrorizëm.

Sipas të dhënave të publikuara nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal që merret me bashkëpunimin e vendeve të Evropës Lindore që synojnë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, del se për periudhën 2015-2017, totali i dënimit për kosovarët që kanë marrë pjesë në këto luftëra është 187 vjet, Shqipëria që ka shqiptuar 126 vjet burgim, Bosnja dhe Hercegovina 40 dhe Maqedonia 33 vjet burgim.

Në këtë raport thuhet se nga viti 2012 deri në vitin 2017, nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, drejtë Sirisë e Irakut, kanë udhëtuar mbi 1000 persona.

Viteve të fundit në Republikën e Kosovës janë mbyllur disa organizata të dyshimta lokale e joqeveritare humanitare islamike, si dhe është zvogëluar numri i kosovarëve që janë bërë pjesë e luftërave në Siri dhe Irak. Por parandalimi dhe luftimi i terrorizmit vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Një raport i Departamentit Amerikan të Shtetit ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës është përpjekur t'i parandalojë ekstremistët që të përdorin OJQ-të për të fituar terren në Kosovë. Në raport thuhet se Policia e Kosovës dhe Njësia Kundër Terrorizmit e EULEX-it janë përgjegjëset kryesore në luftën kundër terrorizmit. Por, sipas raportit, të dyja këto struktura vazhdojnë të përballen me mungesë burimesh, stërvitjesh dhe ekspertizë.

Në kuptim të kësaj situate vendore dhe ndërkombëtare të krijuar, Kuvendi i Republikës së Kosovës më 12 mars 2015 kishte miratuar Ligjin për ndalimin e bashkimi në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, ku qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare, i cili përcakton veprën penale të *“bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës”*. Ky Ligji parasheh dënime prej 6 muaj deri në 15 vjet

heqje lirie për të gjitha ata që marrin pjesë, nxisin apo ndihmojnë përfshirjen në luftërat e huaja.

Po ashtu, Sa i përket terrorizmit, KPRK parasheh këto vepra penale: “kryerja e veprës terroriste”, ku kryesi i kësaj vepre dënohet jo më pak se 5 vite e deri me burgim të përjetshëm, “ndihma në kryerjen e terrorizmit”, e cila dënohet prej 6 muaj e deri në 10 vite burgim, “lehtësimi në kryerjen e terrorizmit”, kryesi i kësaj vepre penale dënohet nga 5 e deri me 15 vite burgim, “rekrutimi për terrorizëm”, 5 deri në 15 vite, “trajnimi për terrorizëm”, 5 deri në 15 vite burgim, “shtytja për kryerjen e veprave terroriste”, kryesi i kësaj vepre penale dënohet prej 1 e deri me 5 vite burgim, “fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”, vepër e dënueshme prej 3 e deri ne 10 vite, “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, vepër e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej 10 deri në 20 vjet, “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, vepër e dënueshme prej 1 e deri në 20 vite, “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”, kryesi i kësaj vepre dënohet me gjobë ose me burgim prej 1 deri në 10 vite.

Republika e Kosovës më qellim të parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes dhe reagimit kundër terrorizmit dhe duke njohur kërcënimet dhe pasojat nga terrorizmi, që në vitin 2009 kishte hartuar dhe miratuar strategji shtetërore për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie.

Aktualisht parandalimi dhe luftimi i terrorizmit është i rregulluar edhe me Ligjin nr. 05/l -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe legjislacionin tjetër përkatës.

Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plan i Veprimit 2018–2022, i cili është dokumenti i tretë i hartuar nga Qeveria, ka për synim kundërshtimin dhe luftimin e ideologjive ekstremiste apo radikale, të çfarëdo natyre, të cilat mund të shpijnë në përdorimin e dhunës dhe bien ndesh me normat dhe parimet demokratike të shoqërisë kosovare.

Tutje, ajo synon në parandalimin e aktiviteteve terroriste, minimizimin e rrezikut nga kërcënimet terroriste, si dhe uljen e cënueshmërisë përmes qasjes gjithëpërfshirëse, jo vetëm ndër institucionale, por gjithë shoqërore, e cila do të krijoj një bazë fleksibile për reagim më efikas ndaj kërcënimeve ekzistuese dhe dinamikave tjera gjithnjë në rritje dhe shumë dimensionale.

Për shkak se në qendrat korrektuese të Kosovë ka numër të madh të qytetarëve të vendit, të cilët po e vuajnë dënimin për pjesëmarrje në luftërat e huaja, në Irak dhe Siri, por edhe për tentimin për të shkuar në luftërat e huaj, në maj të 2018 është nënshkruar një marrëveshje e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), me qëllim të deradikalizimit të burgosurve.

Për shkak të kësaj, 20 imamë të përzgjedhur nga BIK-u, pas verifikimit të tyre nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI), kanë nisur ligjërimin në burgjet e Kosovës, pasi sipas

zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, ishte vërejtur prania e radikalizmit në mesin e të burgosurve.

Mirëpo, në Kosovë gjatë vitit 2018, janë përballur me akuzat për terrorizëm nga Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës edhe imamë dhe ish-imamë.

Në prill të vitin 2019, 110 kosovarë janë kthyer nga vatrat e luftës në Siri. Ky operacion ishte kryer nga shteti i Kosovës në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Forcat Demokratike Siriane. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, kishte thënë se kthimi i tyre ishte operacion i qeverisë së Kosovës me ndihmën e Shteteve të Bashkuara, duke shtuar se ata që kishim kryer vepra penale do të përgjigjen para drejtësisë, ndërsa të tjerëve sipas tij, do t'u ofrohen mundësi për rehabilitim dhe ri-integrim. Ai kishte deklaruar se gra dhe fëmijë ishin viktimat të papërgjegjshëm të personave që për interesa të ndryshme i kishin shfrytëzuar duke ua mohuar të ardhmen pa vullnetin e tyre, duke i lënë me pasoja të mëdha e në raste të caktuara edhe viktimat. Ndërsa, drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, kishte njoftuar se në mesin e të kthyerve ishin katër luftëtarë, 32 gra dhe 74 fëmijë, përfshirë 9 fëmijë të cilët kishin humbur prindërit në luftë.

Për këtë ngjarje, Ambasada Amerikane në Kosovë kishte lëshuar një komunikatë në të kishte thënë se Shtetet e Bashkuara e përgëzojnë Kosovën për kthimin e 110 shtetasve të saj nga Siria, duke theksuar se shteti i Kosovës po vendos një standard të rëndësishëm për të gjithë anëtarët e Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in dhe bashkësinë ndërkombëtare në ndjekjen e rrugës së njëjtë.²⁰

Në prill 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, 32 të dyshuarave ua kishte caktuar masën e arrestit shtëpiak për shkak të dyshimit se të njëjtat kanë kryer veprën penale "Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës", dhe veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist". Sipas PSRK-së ekzistonte dyshimi se 18 të pandehurat që nga viti 2014 e deri me 20 prill 2019, kishin qenë në zonën e konfliktit Siri-Irak.

Ndërsa, në korrik 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte vendosur që ndaj 24 grave të kthyera nga Siria të vazhdohet masa e arrestit shtëpiak edhe për dy muaj të tjerë, ndaj 4 prej tyre u është zëvendësuar kjo masë, me paraqitje në stacion policor, ndërsa 4 gra të tjera janë liruar nga masa e arrestit shtëpiak, pasi ndaj tyre nuk kishte pasur kërkesë për vazhdimin e masës nga PSRK.

Ndryshe, sipas të dhënave nga Policia e Kosovës, edhe më tej në zonat e konfliktit, janë 30 luftëtarë, 49 gra dhe tetë fëmijë.

²⁰ "Deklaratë nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë". Ambasada e SHBA-së në Kosovë. (<https://xk.usembassy.gov/sq/deklarate-nga-ambasada-e-shba-ve-ne-prishtine-7/>). (Qasur për herë të fundit më 20 gusht 2019.

Në anën tjetër, në vitin 2017, autoritetet e Kosovës **kanë arrestuar 5** individë të tjerë nën të njëjtat akuza, prej të cilëve ishin ngritur **7 aktakuza** për terrorizëm që përfshinin **17 persona**, ndërsa gjatë vitit 2018, nga Drejtoria Kundër Terrorizmit e Policisë së Kosovës janë iniciuar **6** raste dhe janë arrestuar **8 persona te dyshuar**.

11. Gjetjet kryesore të IKD-së në trajtimin e rasteve të terrorizmit

IKD gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë 2019, ka monitoruar 18 raste të terrorizmit, prej të cilave 47 persona janë të akuzuar, ndërsa ndaj 3 personave që kanë qenë pjesë e këtyre aktakuzave, është veçuar procedura.

Nga gjithsej, 18 raste, 12 raste me 32 persona kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, 1 rast me 5 persona është në rigjykim, 2 raste me 7 persona janë në proces në shkallë të parë, ndërsa 3 raste me 3 persona janë në proces në shkallë të dytë.

Nga 18 raste të terrorizmit të monitoruara nga IKD, 12 raste kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë nga Gjykatat Themelore.

Në këto 12 raste, ku janë të përfshirë **32** persona të akuzuar, gjykatat kanë shqiptuar aktgjykime dënuese ndaj 21 personave, aktgjykime liruese ndaj 10 personave, ndërsa ndaj njërit ka shpallur aktgjykim refuzues.

Prej 21 personave ndaj të cilëve gjykatat kanë shpallur aktgjykime dënuese, 18 janë dënuar me burgim efektiv, 2 me kusht, një me gjobë.

Nga 18 personat e dënuar me burgim efektiv, Gjykatat Themelore, njërin prej tyre e kanë dënuar me 8 vite burgim, një me 5 vite e 3 muaj, një me 5 vite, një me 4 vite e gjashtë muaj, dy persona me nga 4 vite, një person me 3 vite e gjashtë muaj, një me 3 vite, dy persona me 2 vite e pesë muaj, pesë persona me nga dy vite burgim, dy persona me nga 1 vit e gjashtë muaj, dhe një person me 6 muaj burgim efektiv.

Nga 2 personat që janë dënuar me burgim me kusht, gjykatat njërin e kanë dënuar me 8 muaj burgim me kusht, ndërsa tjetrin me 6 muaj burgim me kusht.

Ndërsa njëri i akuzuar, i cili është dënuar me 2,600 euro gjobë, është dënuar si i përfshirë në një rast të terrorizmit, mirëpo i njëjti është dënuar për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”.

Nga monitorimi sistematik i IKD-së në sistemin e drejtësisë rezulton se gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, nga Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës ndaj 10 personave janë shpallur aktgjykime liruese.

Prej këtyre 10 personave të liruar, prej tyre janë imamë dhe ish-imamë, të cilat janë akuzuar nga Prokuroria, por që të njëjtat aktakuza, kjo e fundit ka dështuar t'i vërtetojë pranë Gjykatave të Republikës së Kosovës.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 23 mars 2018, në mungesë të provave e ka liruar nga akuza ish-imamin Shefqet Krasniqi, aktgjykim të cilin e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.

Pos rastit të Krasniqi, PSRK ka dështuar që të vërtetojë edhe aktakuzën ndaj katër imamëve Bedri Robaj, Idriz Bilibani, Enes Goga, Mazllam Mazllami si dhe Fuad Ramiqit. Kjo pasi, Gjykata Themelore në Prishtinë më 18 maj 2018, në mungesë të provave i kishte liruar nga akuza. Këtë aktgjykim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.

Po ashtu, IKD gjenë se në gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, Gjykata e Apelit ka ndryshuar një numër të konsiderueshëm të aktgjykimeve. Nga gjithsej 12 raste të terrorizmit të monitoruara nga IKD, të cilat kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, Gjykata e Apelit në 5 raste ka ndryshuar aktgjykimet e shkallës së parë, ndërsa në 7 raste të tjera i ka vërtetuar aktgjykimet e shkallës së parë.

Por, në një rast, kthimi i lëndës në rigjykim nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës kishte qenë shumë i shprehur.

Njëri nga të akuzuarit në rastin “Badovci”, Fehmi Musa, i cili po ngarkohet me veprën penale “dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale terroriste”, që 3 vite e 5 muaj është duke u përballur me aktakuzë, e krejt kjo për shkak se rasti i tij është kthyer disa herë në rigjykim. Ai në gjykimin e parë ishte dënuar me 4 vite burgim efektiv, dënim të cilin ia kishte vërtetuar edhe Apeli. Mirëpo, Gjykata Supreme e kishte kthyer këtë rast në rigjykim. Pas kthimit në rigjykim, Musa ishte dënuar me 3 vite burgim, të cilin dënim ia kishte vërtetuar edhe një herë Gjykata e Apelit. Por, prapë Gjykata Supreme kishte konstatuar se vendimi i shkallës së parë ishte përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe për të dytën herë e kishte kthyer rastin në rigjykim. Më 12 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë Musën e kishte dënuar prapë me 3 vite burgim efektiv.

IKD vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë janë duke dështuar në trajtimin adekuat të këtij rasti, pasi në dy gjykimet, Musa dënohet me burgim, ndërsa Apeli ia vërteton dënimin, mirëpo Supremja gjen shkelje në vendimet e të dyja gjykatave. Në rastin konkret, Gjykata Supreme rezulton se ka prishur gjithsej 4 aktgjykime në rastin e njëjtë, përkatësisht 2 aktgjykime të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe 2 aktgjykime të Gjykatës së Apelit. Në anën tjetër, aktakuza në fjalë rezulton se është trajtuar në gjithsej 8 procedura gjyqësore brenda sistemit gjyqësor (3 herë në GjTh të Prishtinës, 1 herë në GjA dhe 2 herë në GjS). Trajtimi i tillë i një rasti penal e bënë sistemin gjyqësor jo efikas, cenon sigurinë juridike të palëve në procedurë si dhe ndikon në uljen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Lidhur me situatën e tillë, IKD vlerëson se duhet të vihen në funksion mekanizmat e kontrollit të sistemit gjyqësor, ku me theks të veçantë, raste të tilla duhet të trajtohen me seriozitet maksimal nga KVP i KGJK-së.

Sa i përket personave të akuzuar, në rastet e monitoruara, IKD gjenë se janë gjithsej 4 persona, të cilët janë akuzuar në nga 2 raste të ndryshme të terrorizmit.

Gjatë monitorimit të sistematik të këtyre rasteve, IKD ka evidentuar edhe raste të mbajtjes së kundërligjshme të personave të akuzuar në paraburgim. Gjykata Themelore në Prishtinë, më 12 shkurt 2018, të akuzuarit Ardian Gjuraraj e kishte shpallur fajtor për terrorizëm dhe e kishte

dënuar me 1 vit e 5 muaj burgim, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, nga 5 shtatori 2016 deri më sot, 12 shkurt 2018. Pasi dënimi që kjo gjykatë ia ka shqiptuar Gjurajt kishte kaluar kohën sa ai ka qëndruar në paraburgim, kjo masë i është ndërprerë menjëherë atij dhe më pas ai është liruar. Në korrik 2018, Gjykata e Apelit e kishte rrëzuar aktgjykimin e Themelores, dhe Gjurajn e kishte liruar nga akuza për terrorizëm.

Sipas gjetjeve të IKD-së, edhe nëse Apeli do të vërtetonte dënimin ndaj Gjurajt, i njëjti nuk do të kishte nevojë të shkojë në vuajtje të dënimit pasi kishte qëndruar në paraburgim nga 5 shtatori 2016 deri më 12 shkurt 2018, kohë kjo, e cila e kalon madje edhe dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë dhe atë për 7 ditë më shumë. Por, në situatën tanimë të krijuar, përkatësisht pas lirimt të të pandehurit Gjuraj nga Gjykata e Apelit, kemi të bëjmë me mbajtje të paraburgimit të kundërligjshëm. IKD vlerëson se në rastin konkret rezultojnë automatikisht dy pasoja: vërtetimi se në rastin konkret kemi pasur cenim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për shkak të mbajtjes së paraburgimit nga një person, i cili ka rezultuar më vonë që të shpallet i pafajshëm si dhe të drejtën e të akuzuarit për të kërkuar dëmshpërblim nga KGJK, përkatësisht nga Komisioni për Kompensimin e Personave të Arrestuar, mbajtur në Paraburgim apo në Vuajtje të Dënimit. Në kuptim të këtij rasti, IKD e ka parasysh se në drejtësinë penale të çdo vendi të botës ndodhin situata të tilla, por në rastin e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, këto raste tanimë nuk janë të izoluara, por janë bërë pothuajse dukuri. Këtë fakt e kishte pranuar edhe vetë KGJK në takimin e mbajtur më 5 prill 2019. Anëtar i KGJK-së, gjykatësi Muhamet Rexha, ka thënë se është koha e fundit që vetë KGJK, por edhe sistemi gjyqësor në përgjithësi të sensibilizohet më shumë për çështjen e mbajtjes së personave në paraburgim pa të drejtë. Me këtë deklaram, është pajtuar edhe gjykatësja Makifete Saliuka, duke thënë se njerëzit po mbahen në paraburgim pa arsyetim të mjaftueshëm. Ish-kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi ka përsëritur atë që kishte thënë vitin e kaluar, se duhet të bëhet performanca e gjykatësve dhe të shikohet se a ka gjykatës, të cilët kanë një numër të madh të vendimeve të tilla. Lidhur me gjithë këtë diskutim, kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj ka thënë se në takimet që do t'i ketë KGJK-ja me kryetarët e Gjykatave do të trajtohet edhe kjo çështje. Ky diskutim në KGJK kishte ardhur pasi “Betimi për Drejtësi” më 16 mars 2019 kishte publikuar emisionin “*Humbja e milionave nga “gabimet” e drejtësisë*”. Në këtë emision, gjykatësi Muhamet Rexha kishte thënë se ai do ta inicioje ngritjen e një çështjeje të tillë në KGJK²¹.

Tutje, Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2018, nga regjistri i lëndëve të terrorizmit kanë të pranuar **5 raste me 10 persona**, ndërsa kanë zgjidhur **15 raste me 32 persona**.


²¹ “*Humbja e milionave nga “gabimet” e drejtësisë*”. Betimi për Drejtësi”. 16 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/humbja-e-milionave-nga-gabimet-e-drejtesise/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019).

Aktakuzë pas hetimeve		Hudhje e kallëzimit penal		Pushim i hetimeve	
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
6	13	2	4	7	15

Tabela 10 – Hetimi dhe ndjekja e kryesve të veprave penale të terrorizmit nga prokuroria gjatë vitit 2018.

Për vepra penale të terrorizmit gjatë vitit 2018, **janë ngritur 6 aktakuza** me 13 persona, janë **hudhur 2 kallëzime** penale me 4 persona, ndërsa janë **pushuar hetimet për 7 raste** me 15 persona.²²

DKR-të e Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2018, nga viti paraprak kanë trashëguar 18 lëndë të terrorizmit, ku përpos tyre 15 lëndë të reja i kanë pranuar në punë, që në total gjatë vitit 2018, të gjitha Gjykatat Themelore kanë pasur në punë 33 lëndë të terrorizmit, prej të cilave vetëm 10 prej tyre i kanë zgjidhur, ndërsa 23 kanë mbetur të pazgjidhura.



Grafika 9 – Numri i rasteve të terrorizmit në Gjykatat Themelore gjatë vitit 2018.

²²"Raporti i punës 2018". Prokurori i Shtetit. 2019. f. 17. (<http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Vjetor%20i%20Punës%202018%20i%20Prokurorit%20të%20Shtetit.pdf>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019).

GjTh Prishtinë gjatë vitit 2018, ka pasur të ngarkuara më së shumti raste të terrorizmit gjithsej 19, prej të cilave i ka zgjidhur 5, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 14 prej tyre.

GjTh Gjilan renditet e dyta me numrin më të madh të rasteve të terrorizmit, me gjithsej 7 raste, prej të cilave 2 i ka zgjidhur, ndërsa 5 i kanë mbetur të pazgjidhura.

GjTh Mitrovicë ka qenë e ngarkuar me 3 lëndë, prej të cilave gjatë vitit 2018 asnjërën prej tyre nuk ka arritur që ta zgjidhë.

GjTh Pejë ka pasur gjithsej 2 raste të terrorizmit prej të cilave të dyja i ka zgjidhur.

GjTh Prizren ka qenë e ngarkuar vetëm më një lëndë të terrorizmit, të cilën edhe e ka zgjidhur.

GjTh Ferizaj gjatë vitit 2018 ka pasur në punë 1 rast të terrorizmit të cilit nuk ka arritur ta zgjidhë, ndërsa

GjTh Gjakovë gjatë vitit 2018 nuk ka qenë e ngarkuar me asnjë rast të terrorizmit.

Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2019, nga viti paraprak kanë trashëguar 21 lëndë të terrorizmit. Karakteristikë e kësaj periudhe kohore është se DKR-të e Gjykatave Themelore nuk kanë pranuar asnjë lëndë të re të terrorizmit. Prej lëndëve që DKR-të e Gjykatave Themelore kanë pasur në punë si të trashëguara nga viti 2018, Gjykatat kanë zgjidhur gjithsej 7 raste, ndërsa kanë mbetur si të pazgjidhura edhe 14 raste të terrorizmit. Ndërsa në gjashtëmujorin e parë 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë nga gjithsej 14 lëndë të terrorizmit, ka arritur të zgjidhë vetëm 5 prej tyre, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 9.

GjTh në Gjilan dhe **GjTh në Mitrovicë** nga gjithsej 3 lëndë në punë, vetëm një e kanë zgjidhur në gjashtëmujorin e parë ndërsa iu kanë mbetur të pazgjidhura edhe 2 prej tyre.

GjTh në Ferizaj nga gjithsej 1 lëndë në punë, të njëjtën nuk e ka zgjidhur.

Ndërsa **Gjykatat Themelore në Prizren, Pejë dhe Gjakovë** në gjashtëmujorin e parë 2019, nuk kanë qenë të ngarkuara me asnjë lëndë të terrorizmit.

GjTh në Prishtinë, nga 5 lëndë të zgjidhura në gjashtëmujorin e parë, 2 i ka përfunduar me dënim me burgim, 1 me dënim me kusht dhe në 2 raste ka shpallur aktgjykime liruese.

GjTh në Gjilan njërin rast të zgjidhur ka shpallur aktgjykim dënues me burgim efektiv, GjTh në Mitrovicë njërin rast të cilin e ka zgjidhur, e ka zgjidhura në mënyra tjera.

Më së shumti në Gjykatat Themelore ka pasur raste për veprat penale “kryerje e veprës terroriste” dhe “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, nga 9 lëndë në punë, ndërsa për veprat penale “trajnimi për terrorizëm” dhe “parëndësia e kryerjes së veprës terroriste”, nuk ka pasur asnjë rast gjatë vitit 2018.

Veprat penale të terrorizmit	Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese		Lëndë të pranuar në punë		Gjithsej lëndë në punë		Lëndë të zgjidhura		Lëndë të pazgjidhura	
	2018	6 majori 2019	2018	6 majori 2019	2018	6 majori 2019	2018	6 majori 2019	2018	6 majori 2019
Vitet										
Përkufizimet për dispozitat e terrorizmit në nenet 121-145	2	2	0	0	2	2	0	0	2	2
Kryerja e veprës terroriste	6	7	3	0	9	7	2	2	7	5
Ndihma në kryerjen e terrorizmit	2	3	1	0	3	3	0	1	3	2
Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit	2	1	0	0	2	1	0	0	2	1
Rekrutimi për terrorizëm	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0
Trajnimi për terrorizëm	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtytja për kryerjen e veprave terroriste	1	0	1	0	2	0	2	0	0	0
Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist	2	5	7	0	9	5	4	4	5	1
Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës	0	2	2	0	2	2	0	0	2	2
Parëndësia e kryerjes së veprës terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik	1	1	1	0	2	1	1	0	1	1
Gjithsej	18	21	15	0	33	21	10	7	23	14

Tabela 11–Numri i lëndëve të terrorizmit për secilin vepër penale gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmuorit 2019.

Nga 10 raste të zgjidhura nga Gjykatat Themelore, në 6 raste ka pasur dënime me burgim efektiv, 1 rast dënim me gjobë dhe në 3 raste aktgjykime liruese. Ndërsa gjatë vitit 2018, Gjykatat Themelore në asnjë rast nuk kanë shpallur dënime me kusht, aktgjykime refuzuese, si dhe asnjë rast i terrorizmit nuk është parashkruar.




Tabela 12 – Mënyra e zgjedhjes së rasteve të terrorizmit në Gjykatat Themelore për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018, më së shumti aktgjykime ka shpallur GjTh Prishtinë me gjithsej **5 aktgjykime**, prej të cilave 4 janë aktgjykime me burgim efektiv, ndërsa një aktgjykim lirues. Kjo gjykatë ka shpallur një aktgjykim me burgim efektiv për veprën penale “kryerja e veprës penale terroriste”, një tjetër me burgim efektiv për veprën penale “fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”, dy me burgim efektiv për veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, ndërsa për veprën penale “shtytja për kryerjen e veprave terroriste”, ka shpallur aktgjykim lirues.

GjTh Gjilan – Gjatë vitit 2018 ka shpallur **2 aktgjykime**, njërin aktgjykim e ka shpallur me burgim efektiv për veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, ndërsa aktgjykim tjetër lirues, për “kryerja e veprës penale”.

GjTh Pejë - ka shpallur **2 aktgjykime**, njërin me burgim efektiv për veprën penale “shtytja për kryerjen e veprës terroriste”, ndërsa tjetrin lirues për veprën penale për “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”.

GjTh Prizren - ka shpallur vetëm **1 aktgjykim** me gjobë dhe atë për veprën penale “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit racor, fetar apo etnik”.

GjTh Mitrovicë - nga tri raste të ngarkuara në asnjërin rast **nuk ka shpallur aktgjykim**.

GjTh Ferizaj - Ka qenë e ngarkuar vetëm me një lëndë të terrorizmit dhe atë për veprën penale “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit racor, fetar apo etnik”, por nuk e ka kryer këtë lëndë gjatë vitit 2018.

GjTh Gjakovë - nuk kanë qenë të ngarkuara me asnjë lëndë të terrorizmit gjatë vitit 2018

Për dallim nga vitit 2018 ku Gjykatat Themelore kanë zgjidhur vetëm 10 raste të terrorizmit, vlen të theksohet se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, Gjykatat Themelore kanë arritur të zgjidhin 7 raste, prej të cilave në 3 raste kanë shpallur aktgjykim me burgim efektiv, në një rast ka shpallur dënim me kusht, në dy raste aktgjykim refuzues, ndërsa një rast e kanë zgjidhur në mënyrë tjetër. Për dallim nga viti 2018 që në një rast është shpallur dënim me gjobë, në gjashtëmujorin e parë nuk është shpallur asnjë dënim me gjobë, si dhe nuk ka pasur aktgjykime refuzues e as nuk janë parashkruar lëndë të terrorizmit.



Grafika 10 – Mënyra e zgjedhjes së rasteve të terrorizmit në Gjykatat Themelore në gjashtëmujorin 2019.

Sa i përket afateve ligjore, IKD gjenë se në shumicën dërrmuese të rasteve këto afate nuk janë respektuar nga Gjykatat. Përkundër faktit se neni 242.4 përcakton se “*Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës*”, IKD gjenë raste kur shqyrtimi fillestar ishte caktuar pas 517 ditëve nga ngritja e aktakuzës, derisa ka edhe raste të tjera kur shqyrtimi fillestar është caktuar brenda 14 ditëve. Mesatarja e kohëzgjatjes nga ngritja e aktakuzës e deri në caktimin e shqyrtimit fillestar në rastet e monitoruara nga IKD është 133 ditë.

Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës penale në rastet e aktgjykimeve të formës së prerë, IKD ka gjetur raste kur kohëzgjatja e procedurës penale nga ngritja e aktakuzës e deri në aktgjykimin e formës së prerë ka qenë 1352 ditë apo tri vite e shtatë muaj. Mesatarja e

kohëzgjatjes së procedurës penale nga ngritja e aktakuzës e deri në aktgjykimin e formës së prerë në rastet e monitoruara nga IKD është 678 Ditë.

12. Anex 1: Analizë e detajuar e rasteve të terrorizmit të aktgjykimve të formës së prerë

1. Rasti i ish-imamit Shefqet Krasniqi

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.65/17

Vepra penale: “shtytje në kryerjen e veprave terroriste”, “nxitje të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtarë, racor, fetar apo etnik”, “shmangie nga tatimi”.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Beqir Kalludra

Prokuror special: Elez Blakaj

I pandehur: Shefqet Krasniqi

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi liruës ka marrë formën e prerë, Krasniqi është përballur me aktakuzë 582 ditë, apo 1 vit e 7 muaj)

Drejtoria Kundër Terrorizmit me 3 shtator 2014 kishte paraqitur kallëzimin penal, ndërsa të njëjtën ditë Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve për këtë rast, ndërsa aktakuzën e kishte ngritur më 27 shkurt 2017.

Kësaj prokurorie, për të ngritur këtë aktakuzë, që nga dita e nxjerrjes së aktvendimit për fillim të hetimeve iu janë dashur 909 ditë, apo 2 vite e 5 muaj. Lidhur me këtë rast, Gjykata Themelore e Prishtinës më 26 korrik 2016 kishte lëshuar aktvendim sipas të cilit kishte lejuar zgjatjen e afatit të hetimeve edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.

Krasniqi akuzohej se në cilësinë e imamit të xhamisë së madhe “Mehmet Fatih”, në Prishtinë, në vazhdimësi dhe me dashje ka shpërndarë mesazhe për publikun, kryesisht në mënyrë indirekte, mesazhe të cilat kanë shtyrë të tjerët të marrin rrugën për Siri dhe Irak dhe të ndërmarrin veprime terroriste në ato vende. Nga ligjëratat e tij, sipas PSRK ishin ndikuar shumë persona që të bëhen pjesë e organizatave terroriste “ISIS” dhe “Al Nusra”, e ku përmenden Venera Ademi, Ilir Mustafa e Blerim Heta, i cili më 25 mars 2014, kishte kryer një veprim terrorist vetëvrasës, në të cilin rast kishin mbetur të vrarë 52 persona në Irak.

Në këtë aktakuzë, ai ngarkohej edhe për veprën penale “shmangie nga tatimi”, pasi pretendohet se si pronar I.N.T “Pronat”, në periudhën kohore 2011 deri më 2016, më qëllim të fshehjes apo shmangies së pjesshme ose të tërësishme të tatimit, me dashje ka dhënë të dhëna të pavërteta, duke mos i kryer obligimet që parashihen me Ligjin për Administratën Tatimore. Krasniqi pretendohet se nuk i ka kryer obligimet tatimore, në vlerë të përgjithshme prej 20.208.57 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Edhe pse aktakuza ndaj Krasniqit ishte ngritur më 27 shkurt 2017, deri më 14 dhjetor 2017 nuk ishte mbajtur shqyrtimi fillestar ndaj tij, apo 290 pas ngritjes së aktakuzës, edhe pse ishte dashur të caktohej pas 30 ditësh.²³

Ndërsa shqyrtimi i dytë në këtë rast nuk ishte caktuar fare, por mbrojtësi i të akuzuarit Krasniqi, avokati Sevdali Zejnullahu kishte parashtruar kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, e cila kërkesë ishte refuzuar nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Beqir Kalludra më 22 dhjetor 2017.²⁴

Pas refuzimit të kësaj kërkesë seanca e shqyrtimit kryesor ishte mbajtur më 22 janar 2018, ku pas pesë seancave të mbajtura dhe pas dëgjimit të disa dëshmitarëve, Gjykata Themelore në Prishtinë më 23 mars 2018 në mungesë të provave Krasniqin e kishte liruar nga akuza.²⁵

E pakënaqur me lirimin ka qenë PSRK, e cila kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, mirëpo e njëjta e ka refuzuar ankesën e PSRK-së, duke e liruar kështu përfundimisht Krasniqin nga akuzat për terrorizëm dhe shmangie nga tatimi.²⁶

²³ “Shefqet Krasniqi mohon fajësinë për nxitje në terrorizëm, mbrojtja kërkon hedhjen e aktakuzës”. Betimi për Drejtësi. 14 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shefqet-krasniqi-mohon-fajesine-per-nxitje-ne-terrorizem-mbrojtja-kerkon-hedhjen-e-aktakuzes/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

²⁴ “Gjykata refuzon kërkesën për hudhjen e aktakuzës në rastin e Shefqet Krasniqit”. Betimi për Drejtësi. 22 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-refuzon-kerkesen-per-hudhjen-e-aktakuzes-ne-rastin-e-shefqet-krasniqit/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

²⁵ “Shefqet Krasniqi lirohet nga akuzat për terrorizëm dhe shmangie nga tatimi”. Betimi për Drejtësi. 23 mars 2018.

(Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shefqet-krasniqi-lirohet-nga-akuzat-per-terrorizem-dhe-shmangie-nga-tatimi/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

²⁶ “Apeli e liron përfundimisht nga akuzat për terrorizëm dhe shmangie nga tatimi”. Shefqet Krasniqin. Betimi për Drejtësi. 1 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-liron-perfundimisht-nga-akuzat-per-terrorizem-dhe-shmangie-nga-tatimi-shefqet-krasniqin/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019).

2.Rasti i katër imamëve dhe Fuad Ramiqi

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.510/17

Vepra penale: “Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”, organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, “rekrutimi për terrorizëm”, “shtytja për kryerjen e veprave terroriste”, “thirrja për rezistencë”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Vesel Ismajli

Prokuror special: Haki Gecaj

Të pandehur: Bedri Robaj, Idriz Bilibani, Enes Goga, Mazllam Mazllami, Fuad Ramiqi.

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi liruës ka marrë formën e prerë, imamët janë përballur me aktakuzë 798 ditë, apo 2 vite e 2 muaj)

Policia e Kosovës më 16 shtator 2014 kishte ushtruar kallëzimin penal, ku në të njëjtën ditë ishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve nga PSRK-ja.

Një vit me pas, PSRK më 15 shtator 2016, kishte ngritur aktakuzë ndaj Bedri Robaj, Idriz Bilibani, Enes Goga, Mazllam Mazllami dhe Fuad Ramiqi për kryerjen e veprave penale që lidhen me terrorizmin.

Robaj akuzohej se që nga viti 2012 e deri në gusht të vitit 2014 në Prishtinë në xhaminë e improvizuar të “Termokosi”, ku ka shërbyer si imam dhe gjatë predikimeve dhe ligjëratave private ka mbështetur “xhihadin-shehidllëkun në Siri”. Ai akuzohej për shtytje të personave të pacaktuar që t’iu bashkëngjiten grupeve terroriste “Al-Nusra”.

Bilibani, akuzohej se që nga viti 2012 e deri në kohën e arrestimit në Prizren dhe në vende të tjera në Kosovë, si hoxhë gjatë mbajtjes së ligjëratave fetare në xhami-OJQ-në “El Bejan” dhe paraqitjet tjera publike të incizuara në video kishte përcjellë mesazhe shtytëse që persona të pacaktuar t’i bashkohen organizatës terroriste “Al Nusra” në Siri.

Enes Goga akuzohej se në pozitën e imamit në Pejë, në një ligjëratë fetare para besimtarëve në këtë qytet, përmes “Audionur” më 10 mars 2014 të publikuar në youtube, në të cilën kanë qasje një numër i pacaktuar i personave, publikisht kishte nxitur urrejtje ndaj grupeve fetare të besimtarëve të krishterë.

Mazllam Mazllami, akuzohej se si imam i xhamisë “Jeni Mahalla” në Prizren, gjatë predikimit të tij dhe në paraqitje publike ka nxitur dhe përkrahur publikisht urrejtje dhe mos durim ndaj grupit të komunitetit LGBTI.

Fuad Ramiqi, akuzohej se prej fillimit të muajit shtator në paraqitjet e tij publike në mjetet e informimit në televizione, gazeta dhe rrjete sociale ka bërë thirrje për rezistencë ndaj organeve të drejtësisë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur në shtator 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur më 16 maj 2017, përkatësisht pas rreth 8 muajve që nga ngritja e aktakuzës, edhe pse ishte dashur të caktohej pas 30 ditësh. Ndërsa, shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 27 qershor 2017, një ditë më vonë pas afatit ligjor.²⁷

Pas mbajtjes së mbi shtatë seancave, më 18 maj 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, në mungesë të provave i kishte liruar nga akuzat për vepra penale që lidhen me terrorizmin, katër imamët Bedri Robaj, Idriz Bilibani, Enes Goga, Mazllam Mazllami si dhe Fuad Ramiqi.²⁸ Në nëntor 2018, Gjykata e Apelit e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kundër këtij aktgjykimi.²⁹

²⁷ “Kundërshtohet aktakuza në rastin e të akuzuarve për vepra që lidhen me terrorizmin”. Betimi për Drejtësi. 27 qershor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kundershtohet-aktakuza-ne-rastin-e-te-akuzuarve-per-vepra-qe-lidhen-me-terrorizmin/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

²⁸ “Lirohen nga akuzat për terrorizëm katër imamët si dhe Fuad Ramiqi”. Betimi për Drejtësi. 18 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohen-nga-akuzat-per-terrorizem-kater-imamet-si-dhe-fuad-ramiqi/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

²⁹ “Apeli vërteton pafajësinë e katër imamëve dhe Fuad Ramiqit që akuzoheshin për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 21 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-kater-imameve-dhe-fuad-ramiqit-qe-akuzoheshin-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

3. Rasti “Izraeli”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.203/17

Vepra penale: “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse”, “përkufizimet për dispozitat e terrorizmit në nenet 121-145”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, “fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Hamdi Ibrahim

Prokuror special: Merita Bina-Rugova

Të pandehur: Visar Ibishi, Burim Istrefi, Leotrim Vojvoda, Flamur Gashi, Kenan Plakaj, Artan Ahmetaj, Lulzim Gashi, Leutrim Musliu, Besart Peci.

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi liruës ka marrë formën e prerë, nëntë të akuzuarit janë përballur me aktakuzë 462 ditë, apo 1 vit e 3 muaj)

Me 21 tetor 2016 PSRK-ja kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, ndërsa më 13 qershor 2017 kishte ngritur aktakuzën ndaj nëntë të akuzuarve për vepra të ndryshme që lidhen me terrorizmin. Nëntë të pandehurit akuzoheshin se gjatë ndeshjes së futbollit ndërmjet Shqipërisë dhe Izraelit, që ishte zhvilluar në qytetin e Shkodrës, në nëntor të vitit 2016, kanë planifikuar të kryejnë sulm terrorist kundër lojtarëve dhe tifozëve izraelitë.

Sipas aktakuzës së PSRK-së, Lavdrim Muhaxheri, përmes kontakteve të rregullta me të akuzuarin Visar Ibishi, i kishte bërë thirrje që ta kryejë sulmin terrorist kundër lojtarëve dhe tifozëve nga Izraeli, të cilët duhej të vinin në Shqipëri, në qytetin e Shkodrës, nëntorin e 2016-ës, komunikime të cilat ishin kryer, duke përdorur një aplikacion të internetit të quajtur “Telegram”.

Sipas kësaj, të akuzuarit Ibishi, Istrefi, Vojvoda dhe Gashi, në bashkëkryerje kishin kryer veprën penale të terrorizmit, ndërsa të akuzuarit Arton Ahmeti dhe Lulzim Gashi, kishin komunikuar me Muhaxherin, për të kryer këtë sulm terrorist, ndërsa Gashi akuzohej edhe për pjesëmarrje në radhët e organizatës terroriste “Al Nusra”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza ndaj tyre ishte ngritur më 13 qershor 2017, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur më 28 qershor 2017, pra brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e ngritjes së aktakuzës. Në

seancën fillestare fajësinë e kishte pranuar vetëm njëri nga nëntë të akuzuarit.³⁰ Shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 21 shtator 2017, tre muaj pas datës së shqyrtimit fillestar edhe pse ishte dashur që të mbahej jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar.³¹ Në këtë seancë gjykata ua ka refuzuar të akuzuarve kërkesat për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, për të vazhduar me shqyrtimin kryesor i cili është mbajtur me 20 dhjetor 2017, në të cilën dy të akuzuarit Plakaj dhe Peci e kanë pranuar fajësinë.³²

Me 18 maj 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë të akuzuarin Visar Ibishi për të gjitha veprat penale e ka dënuar me 10 vjet burgim si dhe me 1.800 euro gjobë, Burim Istrefin me 3 vjet burgim, Leotrim Vojvoden me 5 vjet burgim, Flamur Gashin me 5 vjet burgim, Kenan Plakajn me 1 vjet e 6 muaj burgim si dhe 1.800 euro gjobë, Artan Ahmetajn me 1 vjet e 6 muaj burgim, Lulzim Gashin me 6 vjet burgim, Leutrim Musliun me 3 vjet e 6 muaj burgim dhe Besart Pecin me 2.500 euro gjobë.³³

Të pakënaqur me dënimin e shkallës së parë, të akuzuarit më 17 shtator 2018, kanë kërkuar nga Gjykata e Apelit lirim nga akuza apo kthimin e lëndës në rigjykim, ndërsa PSRK, ka kërkuar që ndaj të akuzuarve të shqiptohen dënime më të larta.³⁴

Kjo gjykatë në tetor 2018, kishte aprovuar si të bazuara ankesat e mbrojtësve të tetë të akuzuarve në rastin e njohur si “Izraeli”, kurse ka refuzuar ankesën e të akuzuarit Kenan Plakaj dhe ankesën e PSRK-së.³⁵

Kjo gjykatë ia ka zvogëluar dënimin unik të akuzuarit Visar Ibishi, nga dhjetë (10) vjet burgim sa ishte dënuar nga shkalla e parë, në tetë vjet burgim, ndërsa nga një vit më pak nga dënimi me burgim i shqiptuar nga shkalla e parë, Apeli u ka shqiptuar të akuzuarve Burim Istrefi, Leutrim Vojvoda dhe Flamur Gashi.

³⁰ “Njëri nga të akuzuarit e pranon fajësinë për përgatitje të sulmit terrorist”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/njeri-nga-te-akuzuarit-e-pranon-fajesine-per-pergatitje-te-sulmit-terrorist/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

³¹ “Të akuzuarit për përgatitje të sulmit terrorist kërkojnë hudhjen e aktakuzës”. Betimi për Drejtësi. 21 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-per-pergatitje-te-sulmit-terrorist-kerkojne-hudhjen-e-aktakuzes/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

³² “Pranojnë fajësinë dy nga nëntë të akuzuarit për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 20 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranojne-fajesine-dy-nga-nente-te-akuzuarit-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

³³ “Dënohen me mbi 35 vjet burgim nëntë të akuzuarit për planifikim të sulmeve terroriste ndaj lojtarëve të Izraelit” Betimi për Drejtësi. 18 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-mbi-35-vjet-burgim-nente-te-akuzuarit-per-planifikim-te-sulmeve-terroriste-ndaj-lojtareve-te-izraelit-ne-shkoder/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

³⁴ “Rasti “Izraeli”, të akuzuarit kërkojnë pafajësinë në Apel, Prokuroria pret rritjen e dënimeve”. 17 shtator 2018. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-izraeli-te-akuzuarit-kerkojne-pafajesine-ne-apel-prokuroria-pret-rritjen-e-denimeve/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

³⁵ “Apeli ua zbutë dënimet të akuzuarve për terrorizëm në rastin “Izraeli”. Betimi për Drejtësi. 15 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ua-zbute-denimet-te-akuzuarve-per-terrorizem-ne-rastin-izraeli/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Istrefi i cili nga shkalla e parë ishte dënuar me tre vjet burgim, tanimë do të vuaj dënimin prej dy vjetësh, kurse të akuzuarit Vojvoda dhe Gashi, të cilët nga shkalla e parë ishin dënuar me nga pesë vjet burgim, pas vendimit të Apelit, të njëjtit do të vuajnë nga katër vjet burgim.

Nëntë muaj më pak burg do të mbaj edhe i akuzuari Lulzim Gashi, i cili nga shkalla e parë ishte dënuar me gjashtë vjet burgim, mirëpo, pas aprovimit të ankesës nga Gjykata e Apelit, i njëjti tashmë do të vuaj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej pesë vjetësh e tre muaj burgim.

Ndërsa, të akuzuarit Leotrim Musliu, Apeli ia ka zvogëluar dënimin me burgim, nga tre vjet e gjashtë muaj burgim, sa i kishte shqiptuar shkalla e parë, në dy vjet burgim, apo një vit e gjashtë muaj më pak.

Kurse, për të akuzuarit Arton Ahmeti dhe Lulzim Gashi, Apeli ka vendosur që të bëj rikualifikimin e veprës penale, ashtu që për veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 nën par.1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK, e cilëson në veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK.

Sa i përket të akuzuarit Kenan Plakaj, Apeli e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të tij, Avni Ibrahim, dhe të njëjtit ia ka vërtetuar dënimin me burgim nga kohëzgjatje prej një vit e gjashtë muaj burgim.

4. Rasti i të akuzuarit që qëndroi një vit e pesë muaj në paraburgim të kundërligjshëm

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.735/16

Vepra penale: “Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”.

Kryetari i Trupit Gjykues: Shpresa Hasaj–Hyseni

Prokuror special: Merita Bina-Rugova

I pandehur: Ardian Gjuraj

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi lirues ka marrë formën e prerë, Krasniqi është përballur me aktakuzë 534 ditë, apo 1 vit e 5 muaj)

PSRK në gusht 2015 kishte pranuar një raport sipas të cilit Gjuraj planifikonte sulme terroriste në Kosovë, ose t’iu bashkëngjitet ISIS-it në Siri. Rastin e tij e kishte paraqitur babi i tij, i cili e kishte informuar policinë gjermane se djali i tij shoqërohet me persona që i përkasin rrymave ekstremiste fetare, dhe pasi Gjuraj ishte intervistuar në Gjermani ishte deportuar në Kosovë. Por pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, rasti ndaj tij ishte mbyllur për shkak se nuk ishin arritur të mblidheshin provat konkrete.

Disa muaj më vonë, më 1 shtator 2016, Drejtoria Kundër Terrorizmit në Prishtinë, kishte dorëzuar në PSRK kallëzimin penal ndaj Gjurajt në drejtim të veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”. PSRK-ja aktvendimin për fillimin e hetimeve e kishte marrë më 1 shtator 2016.

Aktakuza ndaj Ardian Gjurajt ishte ngritur më 7 dhjetor 2016. Ai akuzohej se gjatë viteve 2014-2015, duke jetuar në Gjermani ishte bërë përkrahës i ideologjisë së organizatës terroriste-ekstremiste ISIS dhe babai i tij e kishte paraqitur në polici, ndërsa Policia e Gjermanisë më 18 prill 2015, e kishte deportuar atë në Kosovë. Sipas aktakuzës, më 11 dhjetor 2015, i akuzuari kishte udhëtuar me grupin e organizatës “Liza-R” drejt Turqisë. Në këtë shtet ai ishte ndarë nga grupi, ndërsa kishte vazhduar rrugën drejt Sirisë, ku u ishte bashkuar grupit të kosovarëve pjesëtarë të ISIS-it.

Gjuraj, më 25 shkurt 2016 ishte arrestuar nga autoritete turke, pasi kishte kaluar ilegalisht kufirin Siri-Turqi, duke u futur në territorin e shtetit turke, prokuroria pretendon se në momentin kur e kishin arrestuar autoritetet turke, Gjuraj u ishte paraqitur si shtetas i Rusisë me emrin “Ashab Arsayev”, ndërsa më 5 shtator 2016, ishte deportuar në Kosovë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur në afat ligjor më 28 dhjetor 2016, në të cilin i akuzuari Gjuraj nuk e kishte pranuar fajësinë. Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte caktuar të mbahej më 5 janar 2017, mirëpo ishte shtyrë, ndërsa më 16 janar 2017 kishte arritur të mbahej. Kurse shqyrtimi kryesor në këtë rast kishte filluar më 6 prill 2017.

Më 12 shkurt 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjurajn e kishte shpallur fajtor për terrorizëm është dënuar me 1 vit e 5 muaj burgim, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, nga 5 shtatori 2016 deri më 12 shkurt 2018.³⁶

Duke qenë se dënimi i shqiptuar me burgim, e kalon kohën sa ai ka qëndruar në paraburgim, kjo masë i është ndërprerë menjëherë atij dhe më pas ai është liruar.

Ndaj këtij vendimi, PSRK-ja ishte ankuar në Gjykatën e Apelit, ndërsa ankesë për lirim nga akuza kishte parashtruar mbrojtësi i tij, avokati Ali Beka.³⁷

Ndërsa, në korrik 2018, Gjykata e Apelit e kishte rrëzuar aktgjykimin e Themelores, dhe Gjurajn e kishte liruar nga akuza për terrorizëm.³⁸

Në aktvendimin e Apelit thuhet se dispozitivi i aktakuzës nuk i kishte përmbushur elementet që duhet të përmban një aktakuzë ashtu siç parashihet në nenin 241 të KPP, pasi që mungon koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale, por edhe rrethanat të tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale, e që do kishin përmbushur një standard minimal përtej dyshimit të bazuar mirë që dikush të mund të shpallet fajtor. Sipas vlerësimit të Apelit, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shpalljes fajtor të të akuzuarit, është bazuar në supozime dhe se bindjet fetare të të akuzuarit, udhëtimi i tij për në Turqi, arrestimi i tij në mungesë të dokumentacionit në qytetin Gaziantep, apriori nuk e bëjnë të njëjtin fajtor.

Sipas gjetjeve të IKD-së, edhe nëse Apeli do të vërtetonte dënimin ndaj Gjurajt, i njëjti nuk do të kishte nevojë të shkojë në vuajtje të dënimit pasi kishte qëndruar në paraburgim nga 5 shtatori 2016 deri më 12 shkurt 2018, kohë kjo, e cila e kalon madje edhe dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë dhe atë për 7 ditë më shumë.

³⁶ “Dënohet me burgim i akuzuari për terrorizëm, por lirohet pasi dënimin e shqiptuar e kaloi në paraburgim”. Betimi për Drejtësi. 12 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-burgim-i-akuzuari-per-terrorizem-por-lirohet-pasi-denimin-e-shqiptuar-e-kaloi-ne-paraburgim/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

³⁷ “Prokuroria Speciale kërkon dënim më të lartë për të akuzuarin për terrorizëm, mbrojtja kërkon lirimin e tij”. Betimi për Drejtësi. 24 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-kerkon-denim-me-te-larte-per-te-akuzuarin-per-terrorizem-mbrojtja-kerkon-lirimin-e-tij/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

³⁸ “Apeli rrëzon aktgjykimin e Themelores, Ardian Gjuraj lirohet nga akuza për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 4 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-rrezon-aktgjykimin-e-themelores-ardian-gjuraj-lirohet-nga-akuza-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

5. Rasti i të akuzuarit për pjesëmarrje në luftën e Sirisë që gjykata e hodhi poshtë aktakuzën në shqyrtim të dytë

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.153/18

Vepra penale: “Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë apo policinë e huaj në formacione të jashtme paraushtarake ose para policore në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Kosovës”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nushe Kuka-Mekaj

Prokuror special: Habibe Salihi

I pandehur: Rinor Dizdari

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi refuzues ka marrë formën e prerë, Dizdari është përballur me aktakuzë 136 ditë, apo 4 muaj)

Aktakuza ndaj Dizdarit ishte ngritur më 13 qershor 2018, për shkak të veprës penale “bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë apo policinë e huaj në formacione të jashtme paraushtarake ose para policore në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Kosovës”.

Sipas aktakuzës, ai më 26 maj 2017, nga shtëpia e tij në Prishtinë me vullnet dhe me vetëdije të plotë ishte nisur për në Siri me qëllim t’i bashkohet organizatave ushtarake në Siri. Ai thuhet se kishte shkuar në Shkup e prej aty kishte fluturuar në Turqi, ku prej aty kishte për të udhëtuar drejtë Sirisë. Por, pasi që kishte mbërritur në Republikën e Turqisë kishte lëvizur nëpër territorin e saj dhe me kërkesë të autoriteteve të Kosovës ishte ndalur në qytetin e Bursës, më 2 qershor 2017. Gjithnjë sipas aktakuzës, Dizdari, më pas ishte kthyer nën përcjelljen e autoriteteve të Turqisë, përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Pasi aktakuza ishte ngritur më 26 maj 2017, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 6 gusht 2018, apo pas 15 muajsh nga data e ngritjes së aktakuzës edhe pse është dashur të mbahej pas 30 ditësh. Shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 21 shtator 2018, në të cilin mbrojtësi i tij, avokati Nasuf Hasani kishte kërkuar hudhjen e aktakuzës.³⁹ Në tetor 2018, Gjykata

³⁹ “Mbrojtja kërkon hudhjen e aktakuzës, prokurorja thotë se ka prova që e dëshmojnë se i akuzuari udhëtoi drejt Sirisë”. Betimi për Drejtësi. 21 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes-prokurorja-thote-se-ka-prova-qe-e-deshmojne-se-i-akuzuari-udhetoi-drejt-sirise/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Themelore në Prishtinë, e kishte rrëzuar aktakuzën e PSRK-së, dhe e kishte pushuar procedurën ndaj Dizdarit, me arsyetimin se shkuarja në Turqi e të akuzuarit nuk përbën vepër penale, për të cilën ai ishte ngarkuar.⁴⁰

“Duke pasur parasysh se kjo vepër për të qenë e inkriminuar, kërkohen të plotësohen elementet esenciale të saj, siç është përshkruar në nenin 3, par 3, të ligjit në fjalë. Në rastin konkret vetëm është përshkruar qëllimi i tij për të shkuar në Siri, i cili ende pa arritur, është arrestuar në Turqi. Andaj pretendimi i mbrojtjes se aktakuza është ngritur në kundërshtim me nenin 241, par 1, pika 1.4, qëndron sepse dispozitivit të aktakuzës i mungon vendi, koha dhe marrja pjesë në luftëra të armatosura”, thuhet në një pjesë të aktvendimit.

Tutje, në fund të këtij aktvendimi, është theksuar se kryetarja e trupit gjykues ka vlerësuar se tentimi për të marrë pjesë në luftëra të huaja nuk inkriminohet me Ligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Kështu, pas ankesës së PSRK-së, Gjykata e Apelit më 26 tetor 2018, e kishte vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

⁴⁰ “Gjykata rrëzon aktakuzën e Prokurorisë Speciale, pushohet procedura ndaj të akuzuarit për pjesëmarrje në luftën e Sirisë”. Betimi për Drejtësi. 2 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-rrazon-aktakuzen-e-prokurorisë-speciale-pushohet-procedura-ndaj-te-akuzuarit-per-pjesemarrje-ne-luften-e-sirise/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

6. Rasti i të bashkakuzuarit në rastin “Badovci”, ndaj të cilit po zhvillohet një procedurë tjetër penale për terrorizëm

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.654/16

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”

Kryetari i Trupit Gjykses: Fillimisht Arben Hoti, pastaj ka kaluar te Shadije Gerguri, pastaj te Isuf Makolli

Prokuror special: Merita Bina-Rugova

I pandehur: Gazmend Haliti

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi lirues ka marrë formën e prerë, Haliti është përballur me aktakuzë 950 ditë, apo 2 vite e 7 muaj)

Drejtoria kundër Terrorizmit më 8 janar 2016 kishte parashtruar kallëzim penal ndaj Halitit, ndërsa më 3 mars 2016, PSRK kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve, ku pastaj me 7 nëntor 2016 e kishte ngritur aktakuzës, për shkak të veprës penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”.

Sipas aktakuzës, Haliti, me dashje, kishte marrë pjesë në veprimtarinë e grupit terrorist, në atë mënyrë që më 17 gusht 2013, ishte nisur nga aeroporti i Prishtinës dhe kishte ateruar në aeroportin “Sabiha Gokçen”, në Stamboll të Turqisë. Prej aty, pastaj, kishte kaluar në Siri, ku i ishte bashkëngjitur grupit të shqiptarëve që luftojnë në radhët e organizatës terroriste, militante, ekstremiste ISIS.

Prokuroria pretendon, se i akuzuari, atje, ka marrë pjesë aktivisht në veprimtaritë e kësaj organizate për disa muaj, me qëllim që duke luftuar, seriozisht ta frikësojë popullsinë, të destabilizojë dhe të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike dhe sociale të Sirisë, e pastaj edhe shteteve të tjera dhe në territorin e tyre të krijojnë Shtetin Islamik Iraku dhe Levant.

Në aktakuzë, më tutje thuhet, se i akuzuari Gazmend Haliti, në shkurt 2014, nga Siria, përsëri ka shkuar në Turqi, nga ku më 18 shkurt 2014, ka fluturuar deri në aeroportin “Rinas” në Tiranë dhe së bashku me një bashkëluftëtar të tij në ISIS, Betim Ibrahimajn, më 20 shkurt 2014, përmes pikës kufitare në Vërmicë, kanë hyrë në Kosovë.

Ndryshe, Gazmend Haliti ka qenë i akuzuar edhe në grupin e njohur si “Badovci”, në të cilin ai më 19 korrik të vitit të kaluar, bashkë me të akuzuarit e tjerë të këtij rasti, ishte shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe ishte dënuar me tre vjet e gjashtë muaj burgim, dënim i cili i është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Fillimisht këtë lëndë e ka gjykuar kryetari i trupit gjykues Arben Hoti, pastaj ka kaluar te gjykatësja Shadije Gërguri, e më pas kjo lëndë iu është ndarë gjykatësit Isuf Makolli, pasi i njëjti kishte kaluar në Departamentin e Krimeve të Rënda.

PSRK-ja aktakuzën ndaj Halitit e kishte ngritur më 7 nëntor 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 25 prill 2017, apo 169 ditë pas ngritjes së aktakuzës edhe pse ishte dashur të mbahej pas 30 ditësh. Ndërsa shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 31 maj 2017, brenda afatit ligjor, në të cilin mbrojtësi i të akuzuarit Haliti, avokati Asdren Hoxha kishte kërkuar hüdhen e aktakuzës, kërkesë e cila ishte refuzuar nga ana e gjykatës, e cila e kishte konfirmuar aktakuzën e PSRK-së.

Shqyrtimi gjyqësor ishte mbajtur më 12 dhjetor 2017, ndërsa seanca e 22 janarit 2018 ishte shtyrë për shkak të mungesës së dëshmitarit Fitim Dema, i cili është dëshmitari i vetëm i propozuar nga organi i akuzës, i cili ishte dënuar me dy vite e gjashtë muaj burgim, për veprën penale të organizimit dhe pjesëmarrjes në grupe terroriste.⁴¹ Ky dëshmitar kishte munguar edhe në seancën e paraparë të mbahej më 2 nëntor 2018.⁴²

Pasi rasti nga gjykatësi Arben Hoti kishte kaluar tek gjykatësja Shadije Gërguri, kjo e fundit kishte tentuar të mbajë seancën më 17 dhjetor 2018, por edhe kjo seancë ishte shtyrë për shkak të mungesës së dëshmitarit të vetëm Fitim Dema, i cili sipas Gërgurit, në bazë të njoftimit të marrë nga Stacioni Policor në Kaçanik, rezulton se dëshmitari Dema gjendet në arrati, me qëllim të shmangies nga ekzekutimi i dënimit të formës së prerë.⁴³

Pastaj rasti kishte kaluar tek gjykatësi Isuf Makolli, i cili shpalljen e aktgjykimit e kishte bërë më 12 prill 2019, ku në mungesë të provave e kishte liruar nga akuza të akuzuarin Haliti, të cilit iu ishte ndërprerë edhe masa e paraburgimit.⁴⁴ Më 14 qershor 2019, Gjykata e Apelit ia kishte refuzuar ankesës PSRK-së dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin lirues ndaj Halitit.

Sipas gjetjeve të IKD-së, kishte dështuar në zgjidhjen e këtij rasti, për shkak se aktakuzën e kishte mbështetur në një fotografi që i akuzuari Haliti e kishte bërë me personin Betim Ibrahimaj, i cili nga informatat e policisë ishte vrarë në luftën në Siri.

⁴¹ “Mungesa e dëshmitarit shtyn gjykimin kundër të akuzuarit për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 22 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungesa-e-deshmitarit-shtyn-gjykimin-kunder-te-akuzuarit-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁴³ “Shtyhet për kohë të pacaktuar gjykimi ndaj të akuzuarit për pjesëmarrje në grup terrorist”. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-per-kohe-te-pacaktuar-gjykimi-ndaj-te-akuzuarit-per-pjesemarrje-ne-grup-terrorist/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁴⁴ “Në mungesë të provave shpallet i pafajshëm i akuzuari për pjesëmarrje në grup terrorist”. Betimi për Drejtësi. 12 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-mungese-te-provave-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-pjesemarrje-ne-grup-terrorist/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Prokurori special Afrim Shefkiu kishte deklaruar se në atë fotografi kishte qenë edhe dëshmitari Fitim Dema, i cili më 21 maj 2016 kishte dhënë deklaratë në cilësi të dëshmitarit dhe kishte sqaruar që fotot ishin bërë në qytetin Azaz të Sirisë.

Nga monitorimi këtij rasti është vërejtur se dëshmitari kryesor dhe i vetëm në këtë rast Fitim Dema, nuk ishte arritur të dëgjohej asnjëherë në këtë gjykim, për shkak se kishte qenë e pamundur të sigurohej prezenca e tij. Për këtë arsye, PSRK kishte hequr dorë nga dëgjimi i këtij dëshmitari.

7. Rasti i 11 të akuzuarve për terrorizëm

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.264/15

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”, “mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve”

Kryetari i Trupit Gjykues: Suzana Çerkini

Prokuror special: Abdurrahim Islami

Të pandehur: Artan Kadriu, Besim Shabani, Egzon Latifi, Adil Bushi, Jetmir Bushi, Bekim Halili, Kujtim Bytyqi, Jeton Ajdini, Hadi Nura, Betim Ibrahimaj, Zijadin Berisha

(Nga data e ngritjes së aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë, 11 të akuzuarit janë përballur me aktakuzë 1352 ditë, apo 3 vite e 8 muaj)

PSRK-ja më 10 gusht 2014 kishte pranuar kallëzimin penal kundër të akuzuarve Artan Kadriu, Hadi Nura, Besim Shabani, Betim Berisha, Egzon Latifi, Adil Bushi, Jetmir Bushi, Bekim Halili, Kujtim Bytyqi, Jeton Ajdini, Zijadin Berisha, ku në të njëjtën ditë kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve, ndërsa aktakuzën e kishte ngritur më 7 maj 2015.

Ndryshe, Hadi Nura, Besim Shabani, Betim Ibrahimaj, Adil Bushi, Egzon Latifi, Jetmir Bushi, Artan Kadriu, Bekim Halili, Zejadin Berisha dhe Jeton Hajdini, akuzoheshin se në periudha të ndryshme kohore, përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, kanë udhëtuar për në Turqi, e më pas për në Siri, ashtu që kanë kryer stërvitjet ushtarake dhe fizike si pjesë e organizatës terroriste “ISIS”.

Sipas aktakuzës, së 7 majit 2015, Hadi Nura, Besim Shabani, Betim Ibrahimaj, Adil Bushi, Egzon Latifi, Jetmir Bushi, Bekim Halili, Zejadin Berisha dhe Jeton Hajdini kanë luftuar në Siri për një kohë, e më vonë janë kthyer në Kosovë. Me këtë, ata konsiderohet se kanë kryer veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”.

Artan Kadriu, sipas aktakuzës, në kohën prej muajit shtator të vitit 2013, deri në muajin shkurt të vitit 2014, me qëllim që t’i bashkohet grupit terrorist “ISIS”, kishte udhëtuar për Turqi. Mirëpo, i njëjti nuk kishte arritur të shkoi në Siri pasi që i ishte ndaluar hyrja në Turqi nga ana e autoriteteve turke, të cilat e kishin kthyer të akuzuarin Kadriu në Prishtinë.

Kurse, Kujtim Bytyqi, akuzohet për mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, kurse për këtë vepër penale akuzohen edhe Zejadin Berisha dhe Bekim Halili.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Fillimisht PSRK, aktvendimin për fillimin e hetimeve e kishte nxjerrë më 10 gusht 2014, kundër 57 personave për dyshimin se kanë kryer vepra penale terroriste, ndërsa në aktakuzën e ngritur më 7 maj 2015, kishte përfshirë vetëm 11 persona.

Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur e 16 korrik 2015, ku i akuzuari Artan Kadriu kishte pranuar fajësinë, mirëpo pas ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues gjykimi kishte filluar rishtas dhe i akuzuari Kadriu kishte mohuar fajësinë. Gjykimi në këtë rast kishte vazhduar nga 15 shtatori 2016, e deri më 17 korrik 2018, ku edhe ishte shpallur aktgjykimi. Në këtë rast ndaj tre të akuzuarve ishte veçuar procedura, shtatë të tjerë ishin dënuar ndërsa vetëm njëri prej tyre ishte liruar nga akuza.

Fillimisht, fajësinë për akuzat e prokurorisë i kishin pranuar të akuzuarit, Adil Bushi, Ziadin Berisha dhe Kujtim Bytyqi, ndërkaq i akuzuari Jetmir Bushi fajësinë e kishte pranuar në seancën e 24 korrikut 2017.⁴⁵

Në seancën e 17 prillit 2018, tre nga gjashtë të akuzuarit për terrorizëm, Besim Shabani, Egzon Latifi dhe Artan Kadriu, kishin vendosur që të mbrohen në heshtje ndaj akuzave me të cilat ngarkohen, ndërsa i akuzuari Bekim Halili, kishte vendosur të përgjigjej, ku në mes të tjerash kishte thënë se në Siri ka shkuar për çështje humanitare.⁴⁶ Në këtë rast kishin qenë të akuzuar edhe Hadi Nura, Betim Ibrahimaj dhe Zijadin Bytyqi, mirëpo ndaj tyre ishte veçuar procedura.

Me 17 korrik 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, i kishte shpallur fajtorë shtatë nga 11 të akuzuarit për vepra penale që lidhen me terrorizmin. Artan Kadriu ishte dënuar me 4 vjet burgim, Besim Shabani dhe Egzon Latifi ishin dënuar me nga 3 vjet burgim, Adil Bushi dhe Jetmir Bushi me nga 2 vjet e 4 muaj burgim. Kurse, Bekim Halili ishte dënuar me 2 vjet e 8 muaj burgim për terrorizëm, kurse me 6 muaj burgim për armëmbajtje pa leje, ndërsa më pas ndaj tij, gjykata ka shqiptuar dënim unik prej 3 vjetësh burgim.

Kujtim Bytyqi, për armëmbajtje pa leje është dënuar me 8 muaj burgim me kusht, me afat verifikimi prej 1 viti. Ndërsa, Jeton Ajdini është liruar nga akuza, në mungesë të provave. Sipas aktgjykimit, të akuzuarve Bekim Halili dhe Kujtim Bytyqit, i konfiskohen armët.⁴⁷

⁴⁵ “Pranon fajësinë i akuzuari për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 24 korrik 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine-i-akuzuari-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁴⁶ “I akuzuari për terrorizëm thotë se në Siri ka shkuar për çështje humanitare”. Betimi për Drejtësi. 17 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-terrorizem-thote-se-ne-siri-ka-shkuar-per-ceshtje-humanitare/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁴⁷ “Dënohen me mbi 18 vjet burg shtatë të akuzuarit për terrorizëm, njëri lirohet nga akuza”, Betimi për Drejtësi. 17 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-mbi-15-vjet-burg-shtate-te-akuzuarit-per-terrorizem-njeri-lirohet-nga-akuza/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Më 17 janar 2019, është mbajtur seanca në Gjykatën e Apelit, në të cilën janë shqyrtuar ankesat për aktgjykimin e shkallës së parë, ku PSRK-ja kishte kërkuar rritjen e dënimeve, ndërsa të akuzuarit kishin kërkuar zbutjen apo lirin nga akuza.⁴⁸

Kjo gjykatë të njëjtën ditë, me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së PSRK-së, kishte vendosur që t'ua rrit dënimet Artan Kadriut dhe Egzon Latifit, kurse, me aprovimin e ankesave të mbrojtësve, të akuzuarve Adil Bushi, Jetmir Bushi dhe Bekim Halili, u janë zvogëluar dënimet.

Të akuzuarit Kadriu, që shkalla e parë i kishte shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër viteve, Apeli ia ka rritur për gjashtë muaj, ashtu që i njëjti tash do të vuaj dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër vite e gjashtë muaj burg.

Gjashtë muaj më shumë burg se sa ishte dënuar nga shkalla e parë do t'i vuaj edhe i akuzuari Latifi, i cili nga shkalla e parë ishte dënuar me tre vite burgim, kurse Apeli ia ka rritur në tre vite e gjashtë muaj.

Në anën tjetër, të akuzuarve Adil Bushi dhe Jetmir Bushi, Apeli ua ka zvogëluar dënimet për nga katër muaj më pak. Të njëjtit ishin dënuar me nga dy vite e katër muaj burg nga Themelorja, kurse Apeli ua ka zvogëluar në dy vite secilit prej tyre.

Kurse, i akuzuari Bekim Halili i cili nga shkalla e parë ishte dënuar me tre vite burgim, pas vendimit të Apelit, do të vuaj dënimin me burgim prej dy vite e pesë muaj burgim.

Sipas vlerësimit të Apelit, aktgjykimi i ankimuar është i qartë i kuptueshëm, dhe nuk ekzistojnë kundërtënie në mes të diapozitivave të aktgjykimit dhe arsyeve të paraqitura lidhur me faktet vendimtare për veprat penale për të cilat të akuzuarit e cekur me lartë janë shpallur fajtorë, si dhe për pjesën liruese me të cilën i akuzuari Jeton Halili në mungesë të provave.

E vetmja pikë ku Apeli ka vendosur që të ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë ka të bëjë me lartësinë e dënimin të shqiptuar ndaj të akuzuarve, ku sipas gjykatës së shkallës së dytë, Themelorja nuk kishte vlerësuar siç duhet rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarit.⁴⁹

⁴⁸ “Shqyrtohen në Apel ankesat e palëve në rastin e të akuzuarve për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 17 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shqyrtohen-ne-apel-ankesat-e-paleve-ne-rastin-e-te-akuzuarve-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁴⁹ “Apeli ua rritë dënimet dy të akuzuarve për terrorizëm, tre të tjerëve ua zvogëlon dënimet”. Betimi për Drejtësi. 13 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ua-rrite-denimet-dy-te-akuzuarve-per-terrorizem-tre-te-tjereve-ua-zvogelon-denimet/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

8. Rasti ndaj të akuzuarit që u dënua me 200 orë punë në dobi të përgjithshme, e me pas Apeli ia ktheu dënimin në burgim

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.9/18

Vepra penale: “bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”

Kryetari i Trupit Gjykses: Naser Foniqi

Prokuror special: Afrim Shefkiu

I pandehur: Kreshnik Podvorica

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë, Podvorica është përballur me aktakuzë 78 ditë, apo mbi 2 muaj)

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 22 nëntor 2017, ndërsa aktakuza ishte ngritur me 16 janar 2018.

Podvorica akuzohej se gjatë vitit 2017 e në vazhdimësi, përmes rrjetit social “Facebook”, nga llogaria e tij Ebu Zejd El Kosovi, me anë të postimeve të xhirimeve audio-vizuale dhe fotografive, kishte bërë propagandim në lidhje me organizatën terroriste “ISIS”, duke i përkrahur haptazi veprimet e tyre terroriste. Ai me 4 nëntor 2017, në llogarinë e tij në rrjetin social “Facebook”, kishte shpërndarë fotografi kërcënuese në të cilën ishte paraqitur një gomë e një automjeti e përlyer me gjak në të cilën janë lënë gjurmët e përgjakshme me fjalët: “nisu drejt tyre pa mëshirë”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Seanca e shqyrtimit fillestar në këtë rast ishte mbajtur me 30 janar 2018, apo pas 15 ditësh nga dita e ngritjes së aktakuzës. Në këtë seancë Podvorica e kishte pranuar fajësinë ndërsa kishte deklaruar se postimet i kishte bërë pa pasur për qëllim të keq ndaj Republikës së Kosovës, dhe se nuk e kishte ditur se këto veprime ishin të jashtëligjshme. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore në Prishtinë, Podvoricën e kishte dënuar me gjashtë muaj burgim, por me pajtimin e tij, dënimi me burgim i është zëvendësuar me 200 orë punë në dobi të përgjithshme.⁵⁰

⁵⁰ “I akuzuari për terrorizëm dënohet me 200 orë punë në dobi të përgjithshme”. Betimi për Drejtësi. 30 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-terrorizem-denohet-me-200-ore-pune-ne-dobi-te-pergjithshme/>) . (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Ndaj këtij vendimi me 3 prill 2018, ishte ankuar në Gjykatën e Apelit, PSRK, me arsyetimin se dënimi ishte shumë i ulët.⁵¹

Ndërsa Gjykata e Apelit, në maj 2018, nga dënimi me punë në dobi të përgjithshme, Podvoricën e kishte dënuar me gjashtë muaj burgim, duke vlerësuar se shkalla e parë kishte vepruar në kundërshtim me nenin 50 të Kodit të Procedurës Penale, pasi sipas Apelit dënimet alternative siç është urdhri për punë në dobi të përgjithshme shqiptohet vetëm për vepra të lehta penale.⁵²

⁵¹ “Prokuroria Speciale kërkon dënim më të ashpër për të dënuarin për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 3 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-kerkon-denim-me-te-ashper-per-te-denuarin-per-terrorizem/>) . (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁵² “Nga dënimi me punë në dobi të përgjithshme, Apeli e dënon me burg të akuzuarin për propagandë për ISIS-in”. Betimi për Drejtësi. 7 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nga-denimi-me-pune-ne-dobi-te-pergjithshme-apeli-e-denon-me-burg-te-akuzuarin-per-propagande-per-isis-in/>) . (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

9. Rasti ndaj të akuzuarit që pranoi se bashkë me gruan e tij udhëtuan në Siri për tu bërë pjesë e organizatave terroriste

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.578/16

Vepra penale: “bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj në formacione të jashtme paraushtarake ose para policore në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Kosovës në tentativë”

Kryetari i Trupit Gjykues: Vehbi Kashtanjeva

Prokuror special: Sylë Hoxha

I pandehur: Ibrahim Fazlija

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë, Fazlija është përballur me aktakuzë 753 ditë apo mbi 2 vite)

Drejtoria Kundër Terrorizimit në Prishtinë, me 21 korrik 2016, kishte parashtruar kallëzimin penale ndaj Ibrahim Fazlisë, ndërsa PSRK, me 3 gusht 2016 kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve, ndërsa pas dy muajsh me 15 tetor kishte ngritur aktakuzën.

PSRK pretendonte se Fazlija, bashkë me bashkëshorten e tij, më 8 nëntor 2015, kishin udhëtuar drejtë Stambollit, me qëllim që t'i bashkëngjiten organizatave terroriste “ISIS” dhe “Al Nusra” në Siri, mirëpo që ishin ndaluar nga ana e autoriteteve turke dhe ishin kthyer në Kosovës për shkaqe të sigurisë publike në Turqi.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza ndaj Fazliut ishte ngritur me 15 tetor 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte caktuar më 16 mars dhe 14 prill 2018, apo pas 517 ditësh nga dita e ngritjes së aktakuzës edhe pse ishte dashur të mbahej pas 30 ditësh. Seancat e 16 marsit dhe 14 prillit 2018 kishin dështuar pasi i akuzuari ishte i pa qasshëm për gjykatën.⁵³

Ndërkaq seanca fillestare e 31 korrikut 2018, ishte mbajtur në të cilën i akuzuari e kishte pranuar fajësinë dhe në të njëjtën ditë ishte shpallur aktgjykimi. Gjykata Themelore të njëjtin e kishte dënuar me dy vite burgim efektiv.⁵⁴

⁵³ “Dështon gjykimi për pjesëmarrje në grupe terroriste pasi mungon i akuzuari”. Betimi për Drejtësi. 16 mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-per-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste-pasi-mungon-i-akuzuari/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁵⁴ “Pranon fajësinë, dënohet me dy vjet burg i akuzuari për pjesëmarrje në grupet terroriste “ISIS dhe “Al Nusra”. Betimi për Drejtësi. 31 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine->

Pas shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, mbrojtësi i tij, avokati Leon Përlaska, kishte deklaruar se ndaj këtij dënimi do të ushtrojë ankesë në gjykatën e shkallës së dytë. Me 23 tetor 2018, ishte paraparë që të mbahej seanca në Gjykatën e Apelit, ku do të shqyrtohej ankesa e mbrojtësit të tij, avokatit Leon Përlaska, kundër aktgjykimit të shkallës së parë, mirëpo për shkak të mungesës së Fazliut kjo seancë nuk kishte arritur të mbahej.⁵⁵

Apeli me 6 nëntor 2018, e kishte refuzuar ankesën e avokatit Përlaska dhe e ishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë i kishte shqiptuar dënim me burgim nën minimumin ligjor të paraparë për këtë vepër penale.

[denohet-me-dy-vjet-burg-i-akuzuari-per-pjesemarrje-ne-grupet-terroriste-isis-dhe-al-nusra/](#)). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁵⁵ “Mungon i akuzuari për terrorizëm, shtyhet seanca e Apelit ku parashihej të shqyrtohej ankesa e tij”. Betimi për Drejtësi. 23 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-i-akuzuari-per-terrorizem-shtyhet-seanca-e-apelit-ku-parashihej-te-shqyrtohej-ankesa-e-tij/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

10. Rasti i dy të akuzuarve që përkrahën ISIS-in përmes rrjeteve sociale

Gjykata Themelore në Pejë

Numri i lëndës: PKR.nr.12/18

Vepra penale: “shtytja për kryerjen e veprës penale terroriste”, “moslajmërim i veprave penale apo kryesve të tyre”

Kryetari i Trupit Gjykues: Lumturije Muhaxheri

Prokuror special: Fikrije Fejzullahu

Të pandehur: Rakip Avdyli, Kreshnik Podvorica

(Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë, dy të akuzuarit janë përballur me aktakuzë 338 ditë, apo 11 muaj)

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 1 dhjetor 2017, aktvendimi për fillimin e hetimeve ishte nxjerrë me 12 dhjetor 2017, ndërsa me 14 shkurt 2018 ishte ngritur aktakuza ndaj Avdylit dhe Podvoricës, për shkak të veprave penale “shtytja për kryerjen e veprës penale terroriste”, “moslajmërim i veprave penale apo kryesve të tyre”.

Rakip Avdyli akuzohej se nga muajit të verës së viti 2017, në vazhdimësi, ka postuar mesazhe për publikun, me qëllim që të shtyjë kryerjen e aktit terrorist, duke postuar në profilin e tij në “facebook” me emrin Rakip Avdyli, video incizime, fotografi duke shprehur haptazi përkrahjen dhe simpatinë ndaj organizatës terroriste, Shtetit Islamik-ISIS.

Kurse Podvorica, akuzohej se në periudhë të pacaktuar të vitit 2017, nuk e kishte lajmëruar veprën penale dhe kryesin e saj, pasi kishte pasur kontakte me persona që kishin marrë pjesë në Siri dhe të cilët ishin marrë me aktivitete terroriste. Kur i akuzuari Rakip Avdyli, për të cilin kishte qenë në dijeni se merret me aktivitete të tilla, kishte kërkuar nga ai që të kryej një sulm vetëvrasës në territorin e Republikës së Kosovës, duke i thënë “se i duheshin të holla për financim dhe disa vëllezër mysliman, për të organizuar një sulm istishadije (vetëvrasës) kundër shtetit, kundër qeverisë, edhe pse nuk kishte pranuar, ai nuk e kishte lajmëruar rastin në polici.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur me 15 shkurt 2018, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur me 17 prill 2018, apo 61 ditë pas ngritjes së aktakuzës edhe pse ishte dashur të mbahej pas 30 ditësh, në të cilën seancë i akuzuari Kreshnik Podvorica e kishte pranuar në tërësi fajësinë, mirëpo, ndaj tij ishte pezulluar shqiptimi i dënimit deri në përfundim të gjykimit ndaj të akuzuarit Avdyli.

Ndërsa shqyrtimi i dytë ishte mbajtur me 21 maj 2018 brenda afatit ligjor. Në seancën e 14

shtatorit 2018, i akuzuari për shtytje në kryerjen e veprave penale terroriste, Rakip Avdyli, ishte deklaruar fajtor. Në fjalën përfundimtare të 5 tetorit 2018, dy të akuzuarit ishin penduar që kishin shpërndanë imazhe terroriste në rrjete sociale, ndërsa prokuroria speciale kishte kërkuar rrethana rënduese me arsyetim se dy të akuzuarit ishin recidivist.⁵⁶

Gjykata Themelore në Pejë me 10 tetor 2018, dy të akuzuarit i kishte shpallur fajtor për terrorizëm dhe i kishte dënuar me burgim.⁵⁷ Rakip Avdyli ishte dënua me një vit e gjashtë muaj burgim, mirëpo, duke qenë se ishte në vuajtje të dënimit për të njëjtën vepër penale, gjykatësja Lumturije Muhaxheri bëri unifikimin e dënimit, dhe i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej dy vjetësh e gjashtë muaj. Kurse, ndaj të akuzuarit Kushtrim Podvorica, për mos lajmërim të veprës penale, u shqiptua dënim prej gjashtë muajsh.

Për të njëjtën vepër penale, i akuzuari Rakip Avdyli ishte shpallur fajtor dhe dënua me 10 muaj burgim nga Gjykata Themelore në Pejë, në vitin 2017, kurse, dënimi ndaj tij ishte rritur nga Gjykata e Apelit, me 18 muaj burgim.

Edhe Podvorica ka pasur një rast tjetër për terrorizëm, për të cilin ishte dënua me gjashtë muaj burgim nga Gjykata Themelore në Prishtinë në janar 2018, mirëpo, me pëlqimin e tij, dënimi ndaj Podvoricës ishte zëvendësuar në urdhër për punë në dobi të përgjithshme për periudhën prej 200 orë pune, mirëpo Apeli ia kishte kthyer dënimin në 6 muaj burgim.

Me 17 janar 2019, mbrojtësja e të akuzuarit Podvorica, avokatja Sabrije Krasniqi ka kërkuar në Gjykatën e Apelit, që dënimi me gjashtë muaj burgim me kusht ti shndërrohet në dënim me kusht.⁵⁸ Kështu, Gjykata e Apelit me 17 janar 2019, të akuzuarit Podvorica nga dënimi me gjashtë muaj burgim efektiv, ia ka zëvendësuar me 6 muaj burgim me kusht, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda dy viteve. Ndërkaq, të akuzuarit tjetër në këtë rast, Rakip Avdyli, kjo gjykatë ia kishte hequr vetëm një muaj burgim, ku nga 2 vite e gjashtë muaj, Avdyli do të mbajë 2 vite e pesë muaj.

⁵⁶ “Të akuzuarit thonë se pendohen që shpërndanë imazhe terroriste në rrjete sociale, prokuroria kërkon dënimin e tyre”. Betimi për Drejtësi. 5 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-thone-se-pendohen-qe-shperndane-imazhe-terroriste-ne-rrjete-sociale-prokuroria-kerkon-denimin-e-tyre/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁵⁷ “Dënohen me burgim të akuzuarit për shpërndarje të mesazheve terroriste në rrjete sociale”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-burgim-te-akuzuarit-per-shperndarje-te-mesazheve-terroriste-ne-rrjete-sociale/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁵⁸ “I dënuari për mos lajmërim të veprës penale të terrorizmit kërkon të dënohet me kusht nga Apeli”, Betimi për Drejtësi. 17 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-denuari-per-mos-lajmerim-te-vepres-penale-te-terrorizmit-kerkon-te-denohet-me-kusht-nga-apeli/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

11. Rasti ndaj të akuzuarit i cili me gruan dhe djalin e tij udhëtuan për në Siri

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.357/18

Vepra penale: “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Vesel Ismajli

Prokuror special: Florije Salihu-Shamolli

I pandehur: Murat Dernjani

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 25 gusht 2017, aktvendimi për fillimin e hetimeve ishte nxjerrë me 12 shtator 2017, ndërsa aktakuza ishte ngritur me 20 dhjetor 2018. Dernjani nga PSRK, akuzohej se nga muaji mars të vitit 2013, me qëllim që t’i bashkëngjitet grupit terrorist në Siri, me dëshirë, me vetëdije dhe paramendim kishte udhëtuar përmes rrugëve të ndryshme për në Turqi. Pasi kishte qëndruar një kohë në lagjen “Kadëkej” të Stambollit, ai me bashkëshorten A. D dhe djalin e tij M.D, ishin vendosur afër kufirit me Sirinë, dhe pastaj i është bashkëngjitur organizatës terroriste ISIS. Ai pretendohet se ishte pajisur me armë dhe municion, duke qëndruar në Siri deri në gusht të vitit 2017, derisa është tërhequr nga atje dhe i është dorëzuar autoriteteve turke, duke kërkuar që të kthehet në Kosovë, me çka, siç thuhet në aktakuzë, eprorët përkatës ia kanë mundësuar kthimin në Kosovë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur me 9 janar 2019, apo 21 ditë pas ngritjes së aktakuzës, në të cilën seancë Dernjani e kishte pranuar fajësinë dhe kishte deklaruar se pendohet dhe ndien keqardhje për kohën që kishte qëndruar në Siri, pasi gjatë katër vitesh qëndrimi atje, kishte humbur gruan e tij.⁵⁹

Me 14 janar 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Dernjanin e kishte dënuar me 5 vite burgim efektiv, ku në dënimin e shqiptuar atij i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë duke filluar prej 5 tetorit 2018.⁶⁰ Këtë dënim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.

⁵⁹ “I akuzuari për terrorizëm pranon fajësinë, thotë se pendohet thellë pasi humbi gruan në Siri”. Betimi për Drejtësi. 9 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-terrorizem-pranon-fajesine-thote-se-pendohet-thelle-pasi-humbi-gruan-ne-siri/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁶⁰ “Dënohet me pesë vjet burg i akuzuari që pranoi fajësinë për pjesëmarrje në grupe terroriste. Betimi për Drejtësi. 14 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-pese-vjet-burg-i-akuzuari-qe-pranoi-fajesine-per-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

12. Rasti ndaj të akuzuarit që u plagos në Siri

Gjykata Themelore në Pejë

Numri i lëndës: PKR.nr.18/2018

Vepra penale: “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Sylë Lokaj

Prokuror special: Sylë Hoxha

I akuzuari: Sokol Morina

(Nga data e ngritjes së aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë, Morina është përballur me aktakuzë 1476 ditë, apo mbi 4 vite)

Drejtoria Kundër Terrorizmit, me 8 shtator 2014, kishte ushtruar kallëzimin penale ndaj Morinës, ndërsa të njëjtën ditë PSRK kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, dhe pas hetimeve të ndërmarra një vit më vonë, me 6 shtator 2015, kishte ngritur aktakuzën.

Sipas PSRK-së, Morina në periudhën kohore korrik 2013 deri në janar 2014, me qëllim për t’iu bashkëngjitur grupit terrorist “Al Nusra”, së bashku me shokun e tij Alban Shala, kishin udhëtuar në Siri në mënyrë ilegale, duke u vendosur në një qendër stërvitore, me ç’rast Morina i kishte kryer ushtrimet fizike dhe ato me armë afër një muaji, pastaj ishte mobilizuar në grupin terrorist, ku gjatë luftimit kishte marrë plagë nga arma e zjarrit në këmbën e majtë dhe pas shërimit të përkohshëm ishte kthyer në Kosovë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Morina për këtë rast për herë të parë ishte shpallur fajtor për veprën penale “*organizimi dhe pjesëmarrje në grupe terroriste*” me 6 korrik 2017, dhe ishte dënuar me burgim me kusht prej dy vjetësh, dënim i cili nuk do të ekzekutohej nëse ai nuk kryen ndonjë vepër penale brenda tre vjetësh.

Mirëpo kundër këtij aktgjykimi, PSRK kishte parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe t’akuzuarit ti shqiptohet një dënim me burgim efektiv, pasi sipas PSRK-së, gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit ndaj të akuzuarit Morina, pasi që, për veprën penale për të cili është dënuar Morina, parashihet dënim nga 5 deri në 10 vite burgim.⁶¹

⁶¹ “Prokuroria Speciale kërkon nga Apeli dënim më të ashpër për të dënuarin për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-kerkon-nga-apeli-denim-me-te-ashper-per-te-denuarin-per-terrorizem/>)

Kështu, Gjykata e Apelit me 8 shkurt 2018, e kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim, ngase sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.⁶²

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, me 4 prill 2018, ishte mbajtur seanca e parë e rigjyimit, ku për herë të dytë Morina ishte deklaruar i pafajshëm për akuzat e ngritura nga PSRK.

Pas disa seancave të mbajtura, me 6 prill 2018, Gjykata Themelore e Pejës, për dallim nga hera e parë që e kishte dënuar të akuzuarin Morina me dy vite burgim me kusht, në herën e dytë e kishte liruar nga akuza, pasi sipas kryetarit të trupit gjykues, gjykatësit Sylë Lokaj, nuk ishte provuar se Sokol Morina kishte kryer veprën penale për çfarë akuzohej.

Të pakënaqur më këtë vendim, PSRK përsëri kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, shkeljes së ligjit penale he vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që rasti të kthehet prapë në rigjykim.

Mirëpo, Gjykata e Apelit nuk i ka marrë për bazë këtë ankesë të PSRK-së, dhe me 28 shtator 2018, e kishte vërtetuar aktgjykimin lirues ndaj Morinës.

Sipas gjetjeve të IKD-së, rezulton se ankesa e parë e PSRK-së ndaj aktgjyimit dënues prej dy vite burgim me kusht, i ka shkuar në favor të akuzuarit Morina, i cili pas kthimit të lëndës në rigjykim është liruar nga akuza, si dhe iu është vërtetuar aktgjykimin lirues.

⁶² “Apeli e kthen në rigjykim rastin e të dënuarit për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 20 mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-te-denuarit-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

13. Anex II: Trajtimi i detajuar i rasteve të terrorizmit të kthyer në rigjykim

1. Rasti i të akuzuarit për terrorizëm që është kthyer dy herë në rigjykim

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.181/18

Vepra penale: “Ndihma në kryerjen e veprës penale të terrorizmit”, pas rikualifikimit “dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Valbona Musliu-Selimaj

Prokuror special: Drita Hajdari

I pandehur: Fehmi Musa

(Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit Musa është përballur me aktakuzë 1257 ditë, apo 3 vite e 5 muaj)

Musa ka qenë i bashkakuzuar në rastin e njohur si “Badovci”, i cili në këtë rast ishte dënuar me 4 vite burgim, dënim të cilin ia kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, mirëpo rasti ndaj tij ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme me 29 maj 2018. Aktakuza ndaj Musës dhe të bashkakuzuarve të tij Besnik Latifit, Gazmend Halitit, Milazim Haxhiajt, Betim Ibrahimajt dhe Enis Latifit ishte ngritur me 4 dhjetor 2015, nga PSRK.

Musa po akuzohet se me 11 korrik 2015 kishte shkuar tek liqeni i Badovcit për ti arratisur nga vendi i ngjarjes të akuzuarit Besnik dhe Enis Latifin si dhe Milazim Haxhijajn, të cilët me ikonografin e terrorit të organizatës terroriste ISIS, kishin pasur për qëllim incizimin e një video propaganduese me qëllim leximin e betimit ndaj udhëheqësit të ISIS-it dhe të publikojnë këtë video në internet, për t’ua dëshmuar botës shtrirjen e shtetit islamik në Republikën e Kosovës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Musa për herë të parë ishte shpallur fajtor me 18 korrik 2016, dhe ishte dënuar me katër vite burgim efektiv, dënim të cilin e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit me 29 nëntor 2016.⁶³

⁶³ Shënim: Bashkë me Musën në gjykimin e parë të rastit “Badovci”, ishin dënuar edhe të akuzuarit e tjerë në këtë rast. Besnik Latifi ishte dënuar me 13 vjet burg, Gazmend Haliti me 12, Milazim Haxhiaj me 10 vjet e 3 muaj, Enis Latifi me 10 vjet. Nderkaë pas kthimit të lëndës në rigjykim, për herë të dytë, Gjykata Themelore në Prishtinë Besnik dhe Enis Latifi, si dhe të akuzuarit Haliti dhe Haxhiaj i kishte shpallur fajtorë dhe i kishte dënuar me nga tre vjet e gjashtë muaj burgim. Aktgjykimin ndaj tyre e kishte vërtetuar Gjykata e Apelit me 24 tetor 2017.

Mirëpo, mbrojtësit e të akuzuarve kishin paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme, e cila gjykatë e kishte vendosur që lënda të kthehet në rivendosje-rigjykim.

Ndërsa, për herë të dytë Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 korrik 2017, Musen e kishte dënuar me tre vite burgim.⁶⁴ Gjykata e Apelit me 24 tetor 2017, kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e PSRK-së dhe mbrojtësve të të dënuarve dhe aktgjykimin e shkallës së parë të 19 korrikut e kishte vërtetuar.⁶⁵ Kundër aktgjytimeve të kundërshtuara, mbrojtësi i të akuzuarit Fehmi Musa avokati Blerim Qela kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve të ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ti ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara ose ti anuloj dhe çështjen ta kthejë në rigjykim. Këtë kërkesë e kishte miratuar Gjykata Supreme e Kosovës me 29 maj 2018.

Sipas Supremes, vendimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për arsye se në të nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare dhe pasi që këto shkelje nuk janë eliminuar në aktgjykimin e shkallës së dytë dhe po ashtu edhe ai aktgjykim sipas Supremes, është përfshirë me shkelja të njëjta të dispozitave të procedurës penale. Sipas këtij aktgjykimi, ajo çfarë thuhet në dispozitiv të aktgjyimit të shkallës së parë nuk rezulton të jetë kontestuese rrethanat se Musa pas bisedës telefonike me të dënuarit Gazmend Halitin, kishte shkuar me automjetin e tij me të cilin kishte ushtruar veprimtarinë e taksistit deri te Liqeni i Badovcit dhe pas takimit me të i kishte transportuar të dënuarit Haliti deri në shtëpinë e tij në Hajvali, kurse të dënuarin tjetër Betim Ibrahimajn deri në Istog.

Sipas Supremes, nga këto rrethana gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë kanë dhënë konstatim se shkuarja e Musës në orët e vona të natës tregon qëllimin për t'iu ndihmuar të dënuarve tjerë për largimin nga vendi i ngjarjes. Prandaj Supremja me kthimin e lëndës në rivendosje ka kërkuar që gjykata e shkallës së parë të vërtetojë dhe të arsyetojë në mënyrë ligjore faktet vendimtare në bazë të të cilave vërtetohet se i akuzuari Musa kishte njohuri se të dënuarit tjerë kishin ndërmarrë veprime konkrete për veprat penale për të cilat ishin shpallur fajtor, si dhe të vërtetojë cilat shin veprimet inkriminuese të Musës.

Pas kthimit të lëndës në rivendosje, seanca e paraparë të mbahej me 16 janar 2019 ndaj Musës kishte dështuar për shkak të mungesës së përfaqësuesit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), si dhe avokati Blerim Qela.⁶⁶

⁶⁴ “Dënohen të akuzuarit në rastin Badovci”. Betimi për Drejtësi. 19 korrik 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-te-akuzuarit-ne-rastin-badovci/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁶⁵ “Apeli vërteton dënimin për të akuzuarit e rastit “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 5 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-per-te-akuzuarit-e-rastit-badovci/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁶⁶ “Dështon seanca ndaj të akuzuarit për terrorizëm, rasti i të cilit dy herë është kthyer në rigjykim”. Betimi për Drejtësi. 16 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-seanca-ndaj-te-akuzuarit-per-terrorizem-rasti-i-te-cilit-dy-herë-eshte-kthyer-ne-rigjykim/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Pas kthimit të rastit për të dytën herë në rigjykim, në seancën e 22 shkurt 2019, Musa për herë të tretë ishte deklaruar i pafajshëm për të njëjtin rast.⁶⁷ Në seancën e 10 prillit me kërkesë të prokurores Hajdari ishte përjashtuar publiku për shkak se në këtë seancë ishin paraparë të dëgjohen hetuesit policorë nga Drejtoria Kundër Terrorizëm.⁶⁸ Por pas dëgjimit të këtyre hetuesve seance ishte rihapur për publikun, në të cilën ishin dëgjuar dy dëshmitarë.⁶⁹ Me 7 maj 2019 ishte mbajtur seanca e radhës në të cilën i akuzuari e kishte dhënë mbrojtjen e tij, si dhe palët e kishin dhënë edhe fjalën përfundimtare. Në këtë seancë prokurorja Drita Hajdari kishte ri kualifikuar veprën penale nga ndihmë në kryerjen e veprës penale terroriste, në atë të dhënies së ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale terroriste.

Ndërsa me 13 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë Musën e kishte dënuar me tre vite burgim.⁷⁰ Ky rast gjendet në proces në Gjykatën e Apelit.

⁶⁷ “Për të tretën herë deklarohet i pafajshëm njëri nga të akuzuarit për terrorizëm në rastin “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 22 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-te-treten-here-deklarohet-i-pafajshem-njeri-nga-te-akuzuarit-per-terrorizem-ne-rastin-badovci/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁶⁸ “Përjashtohet publiku në rigjykimin e të akuzuarit për terrorizëm në rastin “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perjashtohet-publiku-ne-rigjykimin-e-te-akuzuarit-per-terrorizem-ne-rastin-badovci/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁶⁹ “Shokët e të akuzuarit për terrorizëm në rastin “Badovci” thonë se kishin qenë bashkë një ditë para se të arrestohej”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shoket-e-te-akuzuarit-per-terrorizem-ne-rastin-badovci-thone-se-kishin-qene-bashke-nje-dite-para-se-te-arrestohej/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁷⁰ “Pas kthimit në rigjykim, sërish dënohet me tre vjet burg i akuzuari në rastin “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 13 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rigjykim-serish-denohet-me-tre-vjet-burg-i-akuzuari-ne-rastin-badovci/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

2. Rasti i të akuzuarit për terrorizëm që Apeli e ktheu në rigjykim

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.161/18

Vepra penale: “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Vesel Ismaili

Prokuror special: Elez Blakaj, pastaj Valdet Gashi

I pandehur: Nexhat Ademi

(Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit Ademi është përballur me aktakuzë 819 ditë apo 2 vite e 2 muaj)

Kallëzimi penal ndaj tij ishte parashtruar me 31 maj 2016, ndërsa në të njëjtën ditë Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve, ndërsa me 14 dhjetor 2016, e kishte ngritur aktakuzën.

Ademi akuzohej se më 17 janar 2014, kishte udhëtuar nga Aeroporti i Prishtinës për në Stamboll, e pastaj nga Stambolli ka udhëtuar për në qytetin Gazientep të Turqisë, afër kufirit me Sirinë, nga aty ka arritur të kaloj në territorin e Sirisë me dashje që t'i bashkohet dhe të bëhet pjesë e organizatës “Al Nusra”. Sipas aktakuzës, i pandehuri Ademi, pasi që ka qëndruar një javë në Siri është kthyer në Kosovë.

Prokuroria pretendon se Ademi më 4 mars 2016, kishte provuar që përsëri të shkoi në Siri, duke shfrytëzuar rrugën Shkup-Stamboll, mirëpo i njëjti pasi mbërrin në Aeroportin e Stambollit, autoritetet turke e ndalojnë, e pastaj e dëbojnë për shkak të lidhjes së tij me zonën e luftës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Pasi aktakuza ishte ngritur me 14 dhjetor 2016, seanca fillestare ishte caktuar të mbahej me 3 korrik 2017, apo pas mbi 6 muajve pas ngritjes së aktakuzës, por për shkak të mungesës së të akuzuarit, seanca nuk kishte arritur të mbahej.⁷¹

Ndërsa seanca fillestare e 12 shtatorit 2017, kishte arritur të mbahej, në të cilën i akuzuari ishte deklaruar i pafajshëm, duke theksuar se e kishte bërë të kundërtën e asaj që akuzohet, duke u bërë thirrje të rinjve për të mos shkuar në Siri.⁷² Seanca e shqyrtimit të dytë ishte

⁷¹ “Nuk paraqitet në gjykatë i akuzuari për pjesëmarrje në organizatën terroriste ISIS”. Betimi për Drejtësi. 3 korrik 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nuk-paraqitet-ne-gjykate-i-akuzuari-per-pjesemarrje-ne-organizaten-terroriste-isis/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁷² “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për organizim dhe pjesëmarrje në grupe terroriste”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-organizim-dhe-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

caktuar të mbahej me 16 tetor 2017 brenda afatit ligjor, mirëpo e njëjta kishte dështuar për shkak të mungesës së të akuzuarit, ndaj të cilit ishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim.⁷³

Shqyrtimi i dytë ishte caktuar me 19 dhjetor 2017, mirëpo mbrojtësi i të akuzuarit Ademi, avokati Sabedin Cena kishte hequr dorë nga ky shqyrtim për shkak të ekonomizimit të çështjes, pasi sipas tij kishin kaluar gjashtë muaj nga seanca fillestare. Në këtë seancë Ademi kishte shfrytëzuar të drejtën ligjore për tu mbrojtur në heshtje.⁷⁴

Fjala përfundimtare ishte caktuar me 16 dhjetor 2017, mirëpo e njëjta kishte dështuar për shkak të mungesës së Ademit, ndaj të cilit ishte lëshuar urdhër arrest.⁷⁵

Në seancën e 26 janarit 2018, me kërkesë të avokatit Cena, ishte caktuar ekzaminim psikiatrik ndaj Ademit, për shkak se sipas avokatit, i njëjti vuan nga një lloj depresioni, dhe se kishte probleme shëndetësore.⁷⁶

Me 12 mars 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë Ademin e kishte shpallur fajtor për terrorizëm dhe e kishte dënuar me tre vite burgim, ndërsa iu ishte ndërprerë paraburgimit nga 9 janari 2018, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.⁷⁷

Mirëpo me 14 qershor 2018, mbrojtësi i tij, avokati Sabedin Cena kishte kërkuar nga Gjykata e Apelit lirimin e tij nga akuza me pretendimet se nuk ishte arritur të vërtetohej fajësia, dhe se aktgjykimi i shkallës së parë ishte nxjerr me shkelje të dispozitave procedurale dhe se në të nuk ishin paraqitur fare arsyet në lidhje me faktet vendimtare.⁷⁸

Këto pretendime i kishte marrë për bazë Gjykata e Apelit e cila e kishte prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim. Edhe pas rigjykimit, i

⁷³ “Dështon gjykimi për terrorizëm, për të akuzuarin lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim”. Betimi për Drejtësi. 16 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-gjykimi-per-terrorizem-per-te-akuzuarin-leshohet-urdherese-per-sjelljen-me-detyrim/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁷⁴ “Mburohet në heshtje i akuzuari për organizim dhe pjesëmarrje në grupe terroriste”. Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mburohet-ne-heshtje-i-akuzuari-per-organizim-dhe-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁷⁵ “I akuzuari për terrorizëm nuk paraqitet në gjykatë, atij pritët t’i caktohet paraburgimi”. Betimi për Drejtësi. 26 dhjetor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-terrorizem-nuk-paraqitet-ne-gjykatë-atij-pritët-ti-caktohet-paraburgimi/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁷⁶ “Caktohet ekzaminim psikiatrik për të akuzuarin për terrorizëm, ai kërkon të dërgohet në një qendër tjetër paraburgimi”. Betimi për Drejtësi. 26 janar 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/caktohet-ekzaminim-psikiatrik-per-te-akuzuarin-per-terrorizem-ai-kerkon-te-dergohet-ne-nje-qender-tjeter-paraburgimi/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁷⁷ “Dënohet me tre vjet burgim për organizim dhe pjesëmarrje në grupet terroriste në Siri”. Betimi për Drejtësi. 12 mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-tre-vjet-burgim-per-organizim-dhe-pjesemarrje-ne-grupet-terroriste-ne-siri/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁷⁸ “Mburojta e të akuzuarit për terrorizëm kërkon nga Apeli lirimin e tij nga akuza”. Betimi për Drejtësi. 14 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mburojta-e-te-akuzuarit-per-terrorizem-kerkon-nga-apeli-lirimin-e-tij-nga-akuza/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

akuzuari Ademi kishte mundur në seancën e 3 dhjetorit 2018, ndërsa në seancën e 15 janarit i akuzuari për të dytën herë e kishte mohuar fajësinë dhe ishte mbrojtur në heshtje.⁷⁹

Ndërkaq, Ademi kishte munguar edhe në seancën e 21 janarit 2019 duke mos e arsyetuar mungesën, ku për këtë arsye gjykata kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me shoqërim.⁸⁰ Ademi nuk është paraqitur as në seancën e 31 janarit 2019, ndërsa ndaj tij është caktuar paraburgimi prej një muaj.⁸¹

Me 12 mars 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Ademin e kishte shpallur fajtor për të dytën herë, mirëpo kësaj here ia kishte zbutur dukshëm dënimin, nga tre vite burgim efektiv, në dy vite burgim me kusht i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse ai brenda periudhës prej tre vitesh nuk kryen ndonjë vepër penale. Atij iu është ndërprerë edhe masa e paraburgimit.⁸² Ky rast ndodhet në proces në Gjykatën e Apelit, pasi PSRK kishte parashtruar ankesë kundër aktgjykimi të shkallës së parë.

⁷⁹ “Rigjykimi për terrorizëm, i akuzuari sërish deklarohet i pafajshëm, thotë se do të mbrohet në heshtje”. Betimi për Drejtësi. 15 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rigjykimi-per-terrorizem-i-akuzuari-serish-deklarohet-i-pafajshem-thote-se-do-te-mbrohet-ne-heshtje/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁸⁰ “Lëshohet urdhër për sjellje me shoqërim për të akuzuarin për terrorizëm që mungoi në seancë”. Betimi për Drejtësi. 21 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/leshohet-urdher-per-sjellje-me-shoqerim-per-te-akuzuarin-per-terrorizem-qe-mungoi-ne-seance/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁸¹ “I akuzuari për terrorizëm sërish nuk paraqitet në gjykatë, ndaj tij caktohet paraburgimi”. Betimi për Drejtësi. 31 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-terrorizem-serish-nuk-paraqitet-ne-gjykatë-ndaj-tij-caktohet-paraburgimi/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁸² “Pas kthimit në rigjykim, dënohet me dy vjet burgim me kusht i akuzuari për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 12 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rigjykim-denohet-me-dy-vjet-burgim-me-kusht-i-akuzuari-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

3. Rasti ndaj të akuzuarit që dy herë është liruar nga akuza

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.157/18

Vepra penale: “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Beqir Kalludra

Prokuror special: Atdhe Dema

I akuzuari: Leunis Frangu

(Nga data e ngritjes së aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit, Frangu është përballur me aktakuzë 1049, apo 2 vite e 10 muaj)

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 20 maj 2015, ndërsa aktakuza në këtë rast ishte ngritur me 25 shkurt 2016.

Sipas PSRK-së, Frangu pas marrëveshjes paraprake me Blerim Sylën, më 3 nëntor 2014 përmes aeroportit të Prishtinës kishin shkuar në Turqi, ku nga Stambolli thuhet se kishin shkuar së pari në qytetin turk Hatay, e nga atje në një qytet tjetër të Turqisë afër kufirit të Sirisë, me emrin Rehyanli.

Ata pretendohet se kishin kaluar kufirin nga qyteti i përmendur dhe kishin hyrë në Siri ku iu ishin bashkëngjitur organizatës terroriste “ISIS”, ndërsa pas qëndrimit një kohë të gjatë në Siri përmes kufirit në Han të Elezit ishin kthyer në Kosovë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Gjykata Themelore në Prishtinë, Frangun për herë të parë e kishte liruar nga akuza me 27 shkurt 2018, për shkak se sipas kësaj gjykate nuk ishte provuar se i akuzuari e kishte kryer veprën penale dhe se veprimtaria e të akuzuarit nuk kishte pasur të bëjë me grupe terroriste.

Sipas aktgjykimit të parë, gjykata nuk ka mundur të përcaktojë as emrin e as veprimtarinë e grupit apo formacioni ushtarak dhe se nuk mund të konstatohet fakti se i akuzuari Franku kishte marrë pjesë në ndonjë grup terrorist në Siri.

Kundër këtij aktgjykimi, kishte bërë ankesë PSRK, pasi kishte konsideruar se shkalla e parë kishte bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal.

Kështu, Gjykata e Apelit e kishte aprovuar ankesën e PSRK-së pasi kishte konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, nuk ka dhënë fakte vendimtare kur ka marrë një aktgjykim lirues, dhe kishte konstatuar se aktgjykimi ishte në kundërshtim me vetveten pasi sipas saj, shkalla e parë nuk e kishte kontestuese se i akuzuari ka qenë në Siri, por lirimin e të akuzuarit e kishte bazuar në atë se nuk dihej se cilës organizatë terroriste i kishte takuar Frangu.

Mirëpo, as ky konstatim i Apelit nuk kishte ndikuar tek gjykata e shkallës së parë, e cila edhe pas kthimit të lëndës në rigjykim, me 8 janar 2019, për herë të dytë e kishte liruar nga akuza të akuzuarin Frangu.⁸³

Sipas kryetarit të trupit gjykues, gjykatësi Beqir Kalludra, nuk ishte kontestuese që i akuzuari Frangu, kishte shkuar në Siri, por sipas tij, nuk ishte vërtetuar elementi censor i veprës, që kishte qenë pjesë e ndonjë grupi terrorist, dhe sipas tij, prokuroria nuk kishte sjellë prova të mjaftueshme që i akuzuari të shpallet fajtor. Ai po ashtu, kishte deklaruar se në kohën kur pretendohet se i akuzuari kishte kryer veprën penale nuk kishte qenë në fuqi ligji, i cili tashmë sanksion edhe shkuarjen në Siri.

Ky rast gjendet në proces në Gjykatën e Apelit.

⁸³ “Për herë të dytë shpallet i pafajshëm i akuzuari për pjesëmarrje në grupe terroriste”. Betimi për Drejtësi, 8 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-here-te-dyte-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

4. Rasti ndaj pesë të akuzuarve që kishin planifikuar sulme terroriste në Kosovë dhe Maqedoni

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.252/15

Vepra penale: “përgatitja e veprave terroriste të kryera në bashkëkryerje”, “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”, “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materialeve plasëse”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “kryerja e veprës terroriste”, “lehtësimi në kryerjen e terrorizmit”, “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”, “moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale”, “moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre”, “sulmi”

Kryetari i Trupit Gjykses: Naser Foniqi

Prokuror special: Afrim Shefkiu

I pandehur: Valon Shala, Ardian Mehmeti, Nuredin Sylejmani, Genc Selimi, Musli Hyseni

Aktvendimi për fillimin e hetimeve është nxjerrë me 6 nëntor 2013, ndërsa PSRK-ja aktakuzën ndaj Musli Hysenit e kishte ngritur me 4 dhjetor 2014, ndërsa ndaj Valon Shalës, Ardian Mehmetit, Nuredin Sylejmani dhe Genc Selimit e kishte ngritur me 23 janar 2015.

Sipas aktakuzës, nga muaji korrik e deri me 5 nëntor 2013, në Gjilan dhe vende tjera, kishin marrë pjesë në grupin terrorist të udhëhequr nga i akuzuari Ardian Mehmeti, me qëllim të shkakimit të akteve terroriste në Kosovë e Maqedoni, ndaj objekteve të sigurisë, ndaj Burgut të Idrizovës, me qëllim të lirit nga burgu të Shukri Aliut, si dhe sulmit ndaj Stacionit Policor në Prishtinë. Ata po dyshohet se ishin pajisur me armë të zjarra dhe mjete të improvizuara eksplozive, por me intervenimin e policisë me 5 nëntor 2013 ishin arrestuar.

Po ashtu, të akuzuarit po dyshohen se me 5 nëntor 2013 duke vepruar si grup, kishin blerë 14 pushkë automatike dhe një pushkë M-76 me snajper nga dëshmitari me nofkën “Premtimi”, ku me implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, ishin arrestuar.

Trajtimi i rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Kjo lëndë fillimisht ishte tek gjykatësit e EULEX-it, e më pas kishte kaluar te vendorët të cilët e kishin mbajtur shqyrtimin fillestar dhe të dytë në të cilin kryetarja e trupit gjykses Nora Bllaca e kishte hudhur aktakuzën ndaj të akuzuarve për veprat penale të terrorizmit, por Gjykata e Apelit kishte anuluar këtë vendim dhe kishte vendosur që lidhur me këtë çështje të vazhdohet me shqyrtim gjyqsor.

Pasi ky rast iu ishte ndarë gjykatësit Naser Foniqi, ai nga shqyrtimi gjyqësor e deri tek shpallja e aktgjykimit kishte mbajtur gjithsej 22 seanca.

Foniqi seancën e shqyrtimit kryesor e kishte caktuar me 15 shtator 2017, mirëpo kjo seancë ka dështuar për shkak se Prokurori i EULEX-it, Dreë Engel, kishte kërkuar që ky rast t'iu kthehet gjyqtarëve të këtij misioni.⁸⁴ Në seancën e 9 nëntorit 2017 pesë të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen.⁸⁵

Pas mbajtjes së 22 seancave, shpallja e aktgjykimit në këtë rast ishte vendosur të bëhej me 5 dhjetor 2018, por gjykata e kishte rihapur shqyrtimin duke kërkuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), që të identifikojë grupin terrorist, veprimet e të akuzuarve lidhur me përgatitjen e veprave terroriste dhe materiet eksplozive që dyshohet të jenë improvizuar nga të akuzuarit.⁸⁶

Në seancën e 14 janarit 2019, Prokurori i PSRK-së Afrim Shefkiu kishte bërë precizimin dhe plotësimin e aktakuzës, ndërsa në seancën e 17 janarit pesë të akuzuarit në fjalën e tyre përfundimtare kishin mohuar planifikimin e sulmeve terroriste.⁸⁷

Me 22 janar 2019, pesë të akuzuarit ishin liruar nga akuzat për vepra penale të terrorizmit, derisa janë dënuar me mbi 23 vjet burgim si dhe me gjobë, për vepra penale që lidhen me armët. Ardian Mehmeti, është dënuar me shtatë vjet burgim, e 2800 euro gjobë, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve”, dhe “importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, ndërsa ndaj tij, është refuzuar akuza për organizim ose pjesëmarrje në grupe terroriste, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve, pasi që prokurori special, Afrim Shefkiu, është tërhequr nga akuza.

Mehmeti është liruar edhe nga akuza për kryerjen e veprës terroriste, pasi nuk është provuar se ai ka kryer një vepër të tillë penale. I akuzuari Nuredin Sylejmani, është dënuar më gjashtë vjet burgim e 1800 euro gjobë, për veprat penale të armëmbajtjes pa leje dhe për sulm ndaj shtetaseve amerikane, ndërsa është liruar nga akuza për lehtësim në kryerjen e veprave terroriste, pasi që sipas gjykatës nuk është arritur të provohet se është kryer ajo vepër penale.

⁸⁴ “Prokurori i EULEX-it kërkon që në gjykimin për terrorizëm të kthehen gjyqtarët e këtij misioni”. Betimi për Drejtësi. 15 shtator 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-i-eulex-it-kerkon-qe-ne-gjykimin-per-terrorizem-te-kthehen-gjyqtaret-e-ketij-misioni/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁸⁵ “Sërish deklarohen të pafajshëm pesë të akuzuarit për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 9 nëntor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-deklarohen-te-pafajshem-pese-te-akuzuarit-per-terrorizem/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁸⁶ “Rihapet gjykimi ndaj të akuzuarve për terrorizëm, gjykatësi kërkon identifikimin e grupit terrorist”. Betimi për Drejtësi. 5 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rihapet-gjykimi-ndaj-te-akuzuarve-per-terrorizem-gjykatesi-kerkon-identifikimin-e-grupit-terrorist/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁸⁷ “Të akuzuarit mohojnë se kishin planifikuar sulme terroriste në Kosovë dhe Maqedoni”. Betimi për Drejtësi. 17 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-mohojne-se-kishin-planifikuar-sulme-terroriste-ne-kosove-dhe-maqedoni/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Valon Shala është dënuar me pesë vjet burg e 1800 euro gjobë, për armëmbajtje pa leje, ndërkaq Genc Selimi është dënuar më katër vjet e gjashtë muaj burg dhe 3600 euro gjobë, “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnike”.

Musli Hyseni, është dënuar me një vit burgim e 600 euro gjobë për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” dhe “moslajmërim i veprave penale dhe kryerësve të tyre”, ndërsa është liruar nga akuza për mos lajmërim të veprave penale.⁸⁸

Dënim ose rigjykim për pesë të akuzuarit kishte kërkuar PSRK-ja në seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të mbajtur me 21 maj 2019, pasi sipas tyre, gjykata e shkallës së parë duhet ti dënojë të akuzuarit edhe për vepra penale të terrorizmit.⁸⁹

Gjykata e Apelit në korrik 2019, e kishte kthyer rastin në rigjykim pasi kishte aprovuar ankesën e PSRK-së kundër aktgjyimit të shkallës së parë për shkak të lirit të pesë të akuzuarve për vepra penale terroriste, ndërkaq pjesa tjetër e aktgjyimit kishte mbetur e pandryshuar.

Sipas kësaj gjykate, ekzistojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga gjykata e shkallës së parë, pasi e njëjta nuk kishte paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyeje i konsideron të pavërtetuara, kur të akuzuarit i kishte liruar nga akuza për veprat penale lidhur me planifikimin e sulmeve terroriste në Kosovë dhe Maqedoni.

Po ashtu, Apeli kishte vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme në bazë të të cilave do të eliminoj dyshimin se të akuzuarit ishin grup kriminal, madje arsyetimi i saj është në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.⁹⁰

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë ende nuk e ka caktuar datën e mbajtjes së seancës.

⁸⁸ “Shpallen të pafajshëm të akuzuarit për planifikim të sulmeve terroriste, dënohen për akuzat lidhur me armët”. Betimi për Drejtësi. 22 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-planifikim-te-sulmeve-terroriste-denohen-per-akuzat-lidhur-me-armet/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁸⁹ “Prokuroria Speciale kërkon dënim ose rigjykim për të akuzuarit që ishin liruar nga akuza për planifikim të sulmeve terroriste”. Betimi për Drejtësi. 21 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-kerkon-denim-ose-rigjykim-per-te-akuzuarit-qe-ishin-liruar-nga-akuza-per-planifikim-te-sulmeve-terroriste/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁹⁰ “Kthehet në rigjykim rasti i të akuzuarve për planifikim të sulmeve terroriste në Kosovë dhe Maqedoni”. Betimi për Drejtësi. 22 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kthehet-ne-rigjykim-rasti-i-te-akuzuarve-per-planifikim-te-sulmeve-terroriste-ne-kosove-dhe-maqedoni/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

14. Anex III: Trajtimi i detajuar i rasteve të terrorizmit të përfunduara në shkallë të parë, të cilat gjenden për herë të parë në proces gjyqësor

1. Rasti i pesë të akuzuarve për planifikim të sulmeve vetëvrasëse dhe vepra të tjera terroriste

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.258/18

Vepra penale: “lehtësimi në kryerjen e terrorizmit” “përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, “kryerja e veprës terroriste”, “rekrutimi për terrorizëm”, “moslajmërim i veprave penale apo kryerësve të tyre”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Mustaf Tahiri

Prokuror special: Afrim Shefkiu

Të pandehur: Bujar Behrami, Gramos Shabani, Albert Ademaj, Leotrim Musliu, Edona Haliti, Rasim Kastrati

PSRK aktvendimi për fillimin e hetimeve e kishte nxjerrë me 8 dhjetor 2017, ndërsa me 4 tetor 2018 e kishte ngritur aktakuzën ndaj gjashtë të akuzuarve për vepra të ndryshme penale që lidhen me terrorizmin.

Sipas aktakuzës, të akuzuarit Bujar Behrami e Resim Kastrati, gjatë periudhës kohore nga muaji dhjetor 2017 e deri me datën 29 qershor 2018, kanë përgatitur sulme terroriste në Kosovë.

Sipas prokurorisë, i akuzuari Bujar Behrami ka tentuar ta krijojë grupin me emër “Ndihmëtarët e shtetit Islam në tokën e shqiptonjave”, për të vepruar në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri. Veçmas janë përgatitë për sulme terroriste në diskotekat “Insomnia” dhe “Kamboxha” në Graçanicë, si dhe ndaj kishës ortodokse afër kafenesë “Moskva”, në pjesën veriore të Mitrovicës, si dhe vende të tjera të frekuentuara me qytetarë.

Në aktakuzë thuhet se Resim Kastrati është angazhuar në drejtim të furnizimit me armë të zjarra dhe materiale plasëse, si dhe gjetjen e personave për vendosjen e jelekëve me eksploziv.

I akuzuari Bujar Behrami, sipas pretendimit të prokurorisë, gjatë muajit prill – maj të vitit 2018, me qëllim të kryerjes së akteve terroriste në Kosovë, e gjatë komunikimit me personin e quajtur Mursel Murseli, i njëjti nga Gjermania ka dërguar mjete financiare për të dyshuarin Resim Kastrati, me qëllim të blerjes së materialeve eksplozive dhe armëve të zjarra.

Në aktakuzë thuhet se me datë 20 prill 2018, 24 prill 2018 dhe 14 maj 2018, përmes institucioneve për transferimin e parave “Money Gram” dhe “Eëstern Union”, tërthorazi ka dërguar shumën e të hollave prej 2629.45 euro, 3117.01 euro dhe 3255.00 euro (gjithsej 9001.46 euro), në emër të personit të quajtur Petrit Gashi (dëshmitar anonim) i shpallur nga Gjykata, e që edhe të njëjtat transaksione me implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit janë konfirmuar nga vet i dyshuari Behrami.

Gramos Shabani po akuzohet se gjatë muajit maj e deri më 2 qershor 2018, me dashje direkte ka planifikuar përgatitjen e akteve terroriste në Belgjikë dhe në Francë, meqë është edhe shtetas belg, si dhe kishte planifikuar sulm vetëvrasës me eksploziv në vende të frekuentuara me qytetarë.

Po ashtu, ai po dyshohet se me dashje direkte i ka bërë thirrje bashkëshortes së tij Edona Haliti në drejtim të përgatitjes së akteve terroriste në Kosovë, duke e udhëzuar që të bëjë sulm vetëvrasës me materie eksplozive me automjet, ndaj pjesëtarëve të KFOR – it në Kosovë dhe në vendet e tjera të frekuentuara me qytetarë, e duke e planifikuar edhe furnizimin me armë të zjarra dhe materiale eksplozive, me qëllim të kryerjes së aktit terrorist.

E akuzuara Edona Haliti, sipas aktakuzës, gjatë muajit maj e deri më 02 qershor 2018, duke vepruar sipas udhëzimeve të të akuzuarit Gramos Shabani, është përfshirë në veprime inkriminuese të përgatitjes së akteve terroriste në Kosovë, duke planifikuar të bëjë sulm vetëvrasës me materie eksplozive në automjet ndaj pjesëtarëve të KFOR – it në Kosovë, si dhe në vende të tjera të frekuentuara me qytetarë, duke u furnizuar me armë të zjarra dhe materie plasëse me qëllim të kryerjes së aktit terrorist.

Dy të akuzuarit tjerë Albert Ademaj dhe Leotrim Musliu, prokuroria i akuzon se nga muaji dhjetor 2017, e deri më 29 qershor 2018, në Prishtinë dhe vende të tjera në Kosovë, edhe pse kanë qenë në njohuri dhe të informuar se Bujar Behrami dhe Resim Kastrati janë duke përgatitë akte terroriste në Kosovë, nuk i kanë lajmëruar në polici për veprimet inkriminuese.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur me 1 nëntor 2018 brenda afatit ligjor, pasi aktakuza ishte ngritur me 4 tetor 2018. Në këtë seancë të akuzuarit Bujar Behrami, Gramos Shabani, Albert Ademaj, Leotrim Musliu dhe Edona Haliti, janë deklaruar të pafajshëm, ndërsa i akuzuari tjetër lidhur me këtë rast, Resim Kastrati, nuk u deklarua, meqë kishte vendosur të mbrohet në heshtje.⁹¹ Mbrojtësit e të akuzuarve në afat ligjor kishin parashtruar kërkesat për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, mirëpo të njëjtat kërkesa jashtë seancës ishin refuzuar nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Mustaf Tahiri.

⁹¹ “Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për planifikim të sulmeve vetëvrasëse dhe vepra të tjera terroriste”. Betimi për Drejtësi. 1 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-planifikim-te-sulmeve-vetevrasese-dhe-vepra-te-tjera-terroriste/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

Pas konfirmimit të aktakuzës, seanca e parë e shqyrtimit kryesor është mbajtur me 14 shkurt 2019, në të cilën seancë të akuzuarit edhe njëherë janë deklaruar të pafajshëm, si dhe është dëgjuar hetuesi policor në Drejtorinë Kundër Terrorizëm, Adnan Omeri, i cili e kishte hetuar rastin e gjashtë të akuzuarve për terrorizëm.⁹²

Seanca e radhës është mbajtur me 7 mars 2019, në të cilën seancë është dëgjuar dëshmitari Samir Hajdari i cili ka deklaruar se i akuzuari për përgatitje të sulmeve terroriste Resim Kastrati, e kishte përkrahur luftën në Siri dhe Irak dhe i kishte arsyetuar të rinjtë që kishin rënë në rrugë të Allahut. Pas konstatimit të përfundimit të kësaj seance, i akuzuari Kastrati ka deklaruar se gjatë vizitave në qendrën e paraburgimit si në Dyz dhe Hajvali, bashkëshortes së tij e cila ishte e mbuluar me “ferexhe”, nuk i lejohet vizita, por gjykatësi Tahiri e njoftoi se rregullat e vizitave në qendrat e paraburgimit përcaktohen me rregulloret përkatëse dhe si të tilla duhej të zbatoheshin.

Në seancën e mbajtur me 11 prill 2019, i akuzuari Kastrati kishte kërkuar nga trupi gjykues që avokati i tij të mos quhej i mbrojturi i tij, pasi sipas të akuzuarit mbrojtësi i tij i vetëm ishte Allahu.⁹³ Seanca e 12 prillit 2019 kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së anëtares së trupit gjykues, gjykatëses Nushe Kuka-Mekaj.

Në seancën e mbajtur me 23 prill 2019, janë dëgjuar video incizimet nga monitorimi i masave të fshehta të bisedave në vende publike dhe private. Në këtë seancë mbrojtja e ka kundërshtuar video incizimin ku dëgjohej biseda e të akuzuarit Gramos Shabani i cili e kishte udhëzuar bashkëshorten e tij, të akuzuarën Edona Haliti që të kryejë sulm vetëvrasës ndaj KFOR-it.⁹⁴ Ky rast është ende në proces.

⁹² “Hetuesi policor tregon si e kishte hetuar rastin kundër të akuzuarve për planifikim të sulmeve terroriste në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hetuesi-policor-tregon-si-e-kishte-hetuar-rastin-kunder-te-akuzuarve-per-planifikim-te-sulmeve-terroriste-ne-kosove/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁹³ “I akuzuari për terrorizëm: Refuzoj që avokati im të quhet mbrojtësi im, për shkak se mbrojtësi im i vetëm është Allahu”. Betimi për Drejtësi. 11 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-terrorizem-refuzoj-qe-avokati-im-te-quhet-mbrojtesi-im-per-shkak-se-mbrojtesi-im-i-vetem-eshte-allahu/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁹⁴ “Në gjykimin për terrorizëm dëgjohen audio-incizimet, mbrojtja nuk e konsideron provë bisedën ku i akuzuari e udhëzon bashkëshorten e tij për sulm vetëvrasës ndaj KFOR-it”. Betimi për Drejtësi. 23 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-gjykimin-per-terrorizem-degjohen-audio-incizimet-mbrojtja-nuk-e-konsideron-prove-biseden-ku-i-akuzuari-e-udhezon-bashkeshorten-e-tij-per-sulm-vetevrases-ndaj-kfor-it/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

2. Rasti ndaj të akuzuarit që përkrahu ISIS-in dhe postoi foto kërcënuese ndaj ish-kryeministrit, Ramush Haradinaj

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.23/19

Vepra penale: “Shtytja për kryerjen e veprave terroriste”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Hamdi Ibrahim, pastaj Shadije Gerguri

Prokuror special: Afrim Shefkiu

I pandehur: Bledar Elshani

Kallëzimi penal kundër Elshanit ishte ngritur nga Drejtoria Kundër Terrorizmit e Policisë së Kosovës, ndërsa PSRK-ja aktvendimin për fillimin e hetimeve e ka nxjerrë me 12 janar 2019, ndërsa me 5 prill 2019, e kishte ngritur aktakuzën.

Sipas aktakuzës, Elshani, nga muaji gusht i vitit 2018 e deri në muajin janar të vitit 2019, si administrator i një kanali në rrjetet sociale, me anë të fotografive dhe video – incizimeve kishte bërë propagandim në lidhje me organizatën terroriste “ISIS”, duke përkrahur haptazi veprimet e tyre terroriste siç janë sulmet e fundit në botë në krijimin e “Shtetit Islamik”. Ai më 10 janar 2019, kishte postuar foto me përmbajtje kërcënuese ndaj ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, me mbishkrim “Do t’ju vijë fundi o taguta shqiptar Bi’Idhnilah”, i bërë nga një person i maskuar e ku në prapavijë shihet flamuri i organizatës terroriste “ISIS”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Fillimisht ky rast iu ishte ndarë gjykatësit Hamdi Ibrahim, i cili pas 14 ditësh nga ngritja e aktakuzës me 18 prill 2019, e kishte caktuar shqyrtimi fillestar, mirëpo kjo seance kishte dështuar të mbahet për shkak se ky rast kishte kaluar në Departamentin Special.⁹⁵ Pas themelimit të Departamentit Special, rasti iu është ndarë gjykatës Shadije Gerguri e cila kishte caktuar seancën fillestare me 10 korrik 2019, në të cilën seancë Elshani ishte deklaruar pafajshëm, ndërsa avokati i tij, Isak Hoxha kishte deklaruar se ekzistonte mundësia që të bënin marrëveshje me prokurorinë për pranimin e fajësisë.⁹⁶ Ndërsa seanca e shqyrtimit të dytë nuk është caktuar ende.

⁹⁵ “Rasti ndaj të akuzuarit se kërcënoi kryeministrin Haradinaj do të kalojë në Departamentin Special”. Betimi për Drejtësi. 18 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-ndaj-te-akuzuarit-se-kercenoi-kryeministrin-haradinaj-do-te-kaloje-ne-departamentin-special/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

⁹⁶ “I akuzuari mohon ta ketë përkrahur ISIS-in dhe të ketë postuar foto kërcënuese ndaj kryeministrit, Ramush Haradinaj”. Betimi për Drejtësi. 10 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-mohon-ta-kete-perkrahur-isis-in-dhe-te-kete-postuar-foto-kercenuese-ndaj-kryeministrit-ramush-haradinaj/>). (Qasur së fundi më 21 gusht 2019)

15. Rekomandime

- KGJK dhe KPK të bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të ngarkesës së DKR-ve me lëndë, në mënyrë që të kenë mundësi të ndërmarrin hapa për stabilizimin e këtyre departamenteve, veçanërisht sa i përket lëndëve të cilat barten vit pas viti.
- KGJK dhe KPK të ri analizojnë rregulloret mbi normat orientuese, në mënyrë që të krijohen indikatorë të saktë mbi matjen e efikasitetit të secilit gjyqtar dhe prokurorë.
- KGJK dhe KPK të harmonizojnë bazat e të dhënave të tyre në mënyrë që këto institucione të kenë të dhëna unike dhe të informohet publiku në baza mujore për progresin dhe sfidat në e DKR-ve të Gjykatave dhe Prokurorive.
- KGJK dhe KPK të marrin masa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët nuk respektojnë afatet ligjore në trajtimin e rasteve në krimet e rënda. Në këtë drejtim, KGJK dhe KPK duhet ta kenë të qartë se raportet e saja periodike shërbejnë për informim të publikut dhe për t'i mundësuar këtyre institucioneve ndërmarrjen e masave konkrete për të sanuar pasojat, dhe jo vetëm për evidentimin statistikor të fakteve.
- KGJK të mbajë përgjegjësi gjyqtarët, aktgjykimet e të cilave kthehen disa herë në rigjykim. Kjo të ndodhë edhe për gjyqtarët e Gjykatave Themelore, aktgjykimet e të cilave prishen nga Gjykata e Apelit, por edhe ndaj Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, aktgjykimet e të cilave prishen nga Gjykata Supreme.
- KGJK të adresojë dukurinë e parashkrimit të rasteve në DKR-të e Gjykatave Themelore
- KGJK të reflektojë praktikisht përballë rasteve të mbajtës në paraburgim dhe vuajtje të dënimit në mënyrë të kundërligjshme.
- Prokuroritë dhe Gjykatat të respektojnë afatet ligjore, veçanërisht në rastet të cilat janë me prioritet.
- Ministria e Drejtësisë gjatë procesit të plotësimit ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale të adresoj të drejtën e mjetit juridik dhe qasjes në gjykatë në rastet e hudojes së kallëzimeve penale dhe vendimet lidhur me pushimin e hetimeve nga ana e parashtruesve të kallëzimeve penale, viktimave të krimit dhe palëve të dëmtuara.